REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

RAPORT

MBI

ZBATIMIN E BUXHETIT VJETOR,

DHE

SITUATËN MAKROEKONOMIKE E FISKALE,

GJATË VITIT 2025

Tiranë, Maj 2026

P Ë R M B A J T J A

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR.....6

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE.....7

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike.....7

2.1.1 Sektori real 7

2.1.2 Sektori monetar 8

2.1.3 Sektori i jashtëm 9

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit.....9

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK.....12

4. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE.....13

4.1 Politika fiskale në vitin 2025 dhe efektet në buxhet e në ekonomi.....13

4.1.1 Efektet nga zbatimi i kalendarit të akcizës (2022–2026) 13

4.1.2 Efektet nga rritja e fondit të pagave për administratën publike 13

4.2 Efektet e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, për vitin 2025.....13

4.3 Të ardhurat e përgjithshme.....15

4.3.1 Të ardhurat nga ndihmat 17

4.3.2 Të ardhurat tatimore 17

4.3.3 Të ardhurat nga pushteti vendor 17

4.3.4 Të ardhurat nga fondet speciale 18

4.3.5 Të ardhurat jotatimore 18

4.3.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat 19

5. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME.....27

5.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike.....27

5.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale.....32

5.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2025.....33

5.4 Rishpërndarja e fondeve buxhetore me VKM.....36

5.5 Rezervat dhe Kontigjencat.....37

5.6 Programi i Rindërtimit.....37

6. BUXHETI VENDOR.....39
6.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore.....40
6.2 Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore.....43
7. RISQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE.....45
7.1 Ndërmarrjet shtetërore.....46
7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik 47
7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve 50
7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme.....51
7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore 52
7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) 54
7.3 Pagesat për Kontratat Koncesionare/PPP.....55
7.4 Detyrime të tjera Kontigjente.....56
7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)..... 56
7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit 57
8. SHTOJCAT.....59
8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale.....59
8.2 Shtojca 2 - Efektet e paketës fiskale 2025.....63
8.3 Shtojca 3 - Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës.....63
8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale 65
8.3.2 Arsimi 67
8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural 68
8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia 70
8.3.5 Kultura dhe Turizmi 72
8.3.6 Mjedisi 74
8.3.7 Drejtësia 76
8.3.8 Financat 77
8.3.9 Mbrojtja 79
8.3.10 Ekonomia dhe Inovacioni 81
8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike 83
8.3.12 Politika e Jashtme 84
8.3.13 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë 85

TABELA DHE GRAFIKË

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto 10
Tabela 2 Norma e papunësisë 10
Tabela 3 Bilanci tregtar 10
Tabela 4 Norma e inflacionit 11
Tabela 5 Bilanci fiskal 11
Tabela 6 Borxhi publik 11
Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë LEK) 16
Tabela 8 Të ardhurat nga Adiministrata Tatimore dhe Administrata Doganat (në milionë LEK) 21
Tabela 9 Të ardhurat progresive Administrata Doganore Janar – Dhjetor 2025 22
Tabela 10 Kursi i këmbimit të lekut me euron dhe dollarin 22
Tabela 11 Sasitë e karburantit dhe cigareve, të hedhura për konsum, 2025/2024 (në mijë LEK) 23
Tabela 12 Të ardhurat në akcizë nga mallrat kryesore të për vitin 2024/2025 sipas 60 grup produkteve 24
Tabela 13 Të ardhurat progresive Administrata Tatimore Janar – Dhjetor 2025 25
Tabela 14 Shpenzimet sipas funksionit, me dhe pa shpërndarjen e të pa klasifikuarave (në milionë LEK) 33
Tabela 15 Rishpërndarje fondesh buxhetore me VKM (në 000/LEK) 36
Tabela 16 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës 44
Tabela 17 Matrica e riskut 46
Tabela 18 Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milionë LEK) 48
Tabela 19 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB, MF dhe DPT 49
Tabela 20 Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë LEK) 49
Tabela 21 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë LEK) 49
Tabela 22 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK) 50
Tabela 23 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë LEK) 50
Tabela 24 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në miliardë LEK) 51
Tabela 25 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive 54
Tabela 26 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK) 55
Tabela 27 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ (në EUR) 57
Tabela 28 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR) 58
Tabela 29 Treguesit kryesorë të performancës 2024, sipas ministrive të linjës 63
Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2025 për ministritë dhe institucionet qendrore (në 000/LEK) 64
Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (në mijë LEK) 65
Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Arsimit (në mijë LEK) 67
Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë LEK) 68
Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë LEK) 70
Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit 72
Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Mjedisit 74
Tabela 37 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Drejtësisë 76
Tabela 38 Realizimi i buxhetit 2025 për Institucionet e Drejtësisë 85
Tabela 39 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Financave 77
Tabela 40 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Mbrojtjes 79
Tabela 41 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit 81
Tabela 42 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Brendshme 83
Tabela 43 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme 84

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike dhe të ardhurat totale ndaj PBB-së (në miliardë LEK) 7
Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK) ndaj PBB në vlerë e %. 15
Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave gjatë vitit 2026 16
Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme në % ndaj totalit sipas kategorive kryesore 16
Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë LEK) 17
Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %) 17
Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë LEK) 18
Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %) 18
Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë LEK) në % të realizimit 19
Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë LEK) dhe në % të PBB 19
Grafiku 11 Të ardhurat nga zërat tatimorë në raport me të ardhurat totale nga tatimet dhe doganat për vitin 2025 19
Grafiku 12 Shpenzimet e përgjithshme korente dhe kapitale (miliardë LEK) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %) 27
Grafiku 13 Shpenzimet korente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (milionë LEK) 27
Grafiku 14 Struktura e shpenzimeve korente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite 27
Grafiku 15 Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (milionë LEK) 28
Grafiku 16 Struktura e shpenzimeve korente (milionë LEK) 28
Grafiku 17 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK) 29
Grafiku 18 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK) 29
Grafiku 19 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë LEK) 29
Grafiku 20 Shpenzimet për subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK) 30
Grafiku 21 Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë LEK) 30
Grafiku 22 Shpenzimet për ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë LEK) 31
Grafiku 23 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK) 32
Grafiku 24 Transferta e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite 40
Grafiku 25 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milionë LEK) 41
Grafiku 26 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit 41
Grafiku 27 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB 41
Grafiku 28 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite 42
Grafiku 29 Shpenzimet e buxhetit vendor ndaj PBB, në vite 43
Grafiku 30 Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK) 43
Grafiku 31 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë LEK) 44
Grafiku 32 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve 46
Grafiku 33 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK) 47
Grafiku 34 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në përqind) 47
Grafiku 35 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në milionë LEK. 52
Grafiku 36 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera 52
Grafiku 37 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë 53
Grafiku 38 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesorë 54

1 REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Ekonomia e vendit ka treguar një qëndrueshmëri dhe elasticitetit të konsiderueshëm pavarësisht sfidave globale dhe presioneve inflacioniste që kanë goditur vendin gjatë viteve të fundit. Politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur një rikthim të fortë ekonomik, dhe si rezultat fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit kanë mbetur solide. Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto të larta financimi, ekonomia ka ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Performanca ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë pozitive dhe relativisht e lartë, duke shfaqur një trajektore premtuese dhe pritet të vazhdojë ecurinë pozitive edhe në periudhën afatmesme.

Në vitin 2023, norma e rritjes ekonomike arriti në 4.0 përqind, duke treguar një performancë të fortë. Trendi pozitiv i rritjes ka qëndruar i pandryshuar edhe gjatë vitit 2024, sërish në normën vjetore 4.0 përqind, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Sipas vlerësimeve më të fundit të INSTAT, për vitin 2025 ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive në nivelin prej 3.8 përqind, duke qëndruar shumë pranë projeksioneve të llogaritura më parë në programin ekonomik dhe fiskal për vitin 2025 në nivelin prej 3.9 përqind të PBB-së. Kjo rritje u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat po ashtu edhe investimet si dhe veçanërisht nga performanca mjaft pozitive e sektorit të turizmit. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto vlerësohet të ketë pasur efekt negativ (-0.8 pikë përqindje), ndikuar nga rritja më e shpejtë e importeve të mallrave dhe shërbimeve dhe rënia e eksporteve të mallrave. Megjithatë, kjo pririe është pjesërisht zbutur nga performanca pozitive e eksporteve të shërbimeve, të cilat vijuan të kontribuojnë pozitivisht në aktivitetin ekonomik.


Zhvillimet në tregun e punës gjatë vitit 2025 kanë qenë pozitive dhe në rikuperim të vijueshëm. Shkalla e papunësisë shënoi nivelin më të ulët historik, duke vazhduar trendin rënës të viteve të fundit, duke zbritur në 8.4 përqind në vitin 2025, nga 8.6 përqind në vitin 2024 (për moshën 15 vjeç e lart). Nga pikëpamja e ofertës, rritja e punësimit mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së qëndrueshme të shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallës së punësimit, duke arritur përkatësisht 76.3 përqind në vitin 2025 (krahasuar me 75.7 përqind në vitin 2024) dhe 69.3 përqind (krahasuar në 68.5 përqind në vitin 2024), për grupmoshën 15-64 vjeç. Evidencat tregojnë se ka një interes të përgjithshëm në rritje për pjesëmarrje në tregun e punës, të nxitur nga trendi rritës i pagave, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Paga mesatare bruto mujore u rrit me 8.7 përqind në terma vjetorë, duke reflektuar dinamika relativisht më të forta të pagave në sektorin publik (9.4 përqind), si dhe rritje të qëndrueshme të pagave në sektorin privat (8.5 përqind).

Gjatë vitit 2025, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore në vlerën 1.13 miliardë euro, nga 264 milionë që ishte në vitin 2024. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2025, BP shënoi vlerën -6 milionë euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2024 që shënoi vlerën 293 milionë euro. Në vitin 2025, llogaria korente regjistroi një defiçit prej -179 milionë euro krahasuar me vitin më parë, ku shënonte një defiçit prej -609 milionë euro. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e katërt të 2025, llogaria korente u ngushtua në -254 milionë euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2024 që rezultoi -377 milionë euro.

Përsa i përket të dhënave të tregtisë së jashtme, për vitin 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 346.1 miliardë LEK duke u ulur me 6.9%, ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 887.3 miliardë LEK duke rënë me 0.8%, krahasuar me 2024. Defiçiti tregtar arriti vlerën 541.1 miliardë LEK, duke u rritur me 3.6%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024. Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 52% të gjithë tregtisë. Në periudhën janar-dhjetor 2025, eksportet drejt vendeve të BE zunë 65.8% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE zunë 47.3% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (23.2%), Kina (12.2%), Turqia (7.6%), dhe Greqia (7.4%).

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2025 ishin 754.6 miliardë LEK (28.5% e PBB) ose rreth 6.2% më shumë se viti 2024. Në terma nominal, shpenzimet e përgjithshme publike gjatë 2025 ishin 801.7 miliardë LEK (30.2% e PBB) ose rreth 10% më shumë se viti 2024. Defiçiti fiskal arriti në 1.8% të PBB, nga një mesatare prej afro 1.9% në tre vitet e mëparshme, ndërsa borxhi publik arriti nivelin prej 52.9% të PBB, në rënie me pothuaj 1.3 pp nga 2024.

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike dhe të ardhurat totale ndaj PBB-së (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Gjatë vitit 2025, huamarrja në terma bruto arriti në 454.0 miliardë LEK, nga e cila 78.2% (ose 355.2 miliardë LEK) u financua nga burime të brendshme dhe 21.8% (ose 98.8 miliardë LEK) nga burime të huaja. Në tregun e brendshëm, qeveria ka emetuar letra me vlerë në vlerën 355.2 miliardë LEK, nga të cilat 186.2 miliardë LEK korrespondojnë me instrumente afatshkurtra dhe 169.1 miliardë LEK korrespondojnë me instrumente afatgjata. Financimi neto në fund të vitit 2025 rezultoi në nivelin 49.4 miliardë LEK dhe u realizua terësisht nëpërmjet instrumenteve afatgjata si edhe u shoqërua me maturim të titujve afatshkurtër.

Borxhi publik neto për vitin 2025 ishte 1,342.8 miliardë LEK ose 50.7% e PBB, në rënie nga 51.9% e PBB për vitin 2024. Stoku bruto i borxhit, që përfshin edhe likuiditetin për financimin e borxhit ndaj PBB, arriti nivelin 52.9% e PBB me një rënie me pothuaj 1.3 pp nga viti 2024, duke rezultuar më i ulët se sa pritshmëritë fillestare.

2 PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

2.1.1 Sektori real

Ekonomia e vendit shënoi një rritje reale në nivelin 3.8% gjatë vitit 2025, e udhëhequr kryesisht nga sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit, ndërsa industria dhe bujqësia shënuan kontribut lehtësisht negativ. Sipas optikës së shpenzimeve, rritja është ndikuar kryesisht nga kërkesa e brendshme, e mbështetur në veçanti nga investimet dhe konsumi privat. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto ka dhënë një kontribut lehtësisht negativ, kryesisht si pasojë e rritjes së importit të mallrave. Nga ana tjetër, eksportet e përgjithshme janë zgjeruar, të ndikuara nga rritja e eksportit të shërbimeve, ndërkohë që eksportet e mallrave shënuan rënie.

Sipas optikës sektoriale, kontributet kryesore në rritje kanë ardhur nga “Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia” me rritje prej 14.29% dhe kontribut pozitiv prej 1.8 pp, ndjekur nga sektori i “Ndërtimit” me rritje prej 4.59% dhe kontribut prej 0.61 pp, si dhe nga “Aktivitetet e Pasurive të Paluajtshme” me rritje prej 8.26% dhe kontribut prej 0.46 pp. Ndërsa, sipas optikës së shpenzimeve, konsumi privat u rrit me 2.77% duke kontribuar me 1.97 pp, ndërsa investimet totale shënuan një rritje prej 5.02%, me një kontribut të konsiderueshëm në rritjen ekonomike prej +1.35 pp.

Shifrat faktike 2025 për rritjen nominale të rritjes ekonomike kanë sjellë rishikime pozitive të treguesve kryesorë të borxhit dhe të defiçitit, kur për vitin 2025 treguesi i borxhit shënoi nivelin 52.9% të PBB, ndërsa treguesi i defiçitit buxhetor shënoi nivelin 1.8%. Performanca pozitive e aktivitetit ekonomik është reflektuar edhe në tregun e punës. Norma e papunësisë për grupmoshën mbi 15 vjeç është ulur në 8.3% në tremujorin e fundit, ndërsa shkalla e punësimit është rritur në 68.9% për popullsinë 15-64 vjeç. Gjithashtu, edhe paga mesatare mujore ka shënuar rritje me 8.6% në krahasim me një vit më parë, duke rezultuar në 84,100 LEK në fund të 2025.

2.1.2 Sektori monetar

Gjatë vitit 2025, ekonomia shqiptare u karakterizua nga nivele të ulëta inflacioni, duke shënuar normën mesatare prej 2.2%, duke mos pasur ndryshim krahasuar me një vit më parë. Inflacioni qëndroi nën objektivin prej 3% të Bankës së Shqipërisë, ndikuar nga çmimet e ulëta globale të mallrave, forcimi i Lekut dhe reduktimi i presioneve inflacioniste në ekonominë e brendshme. Ndërkohë, një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur edhe politika monetare, duke kontribuar në një balancim më të mirë të kërkesës dhe ofertës në ekonomi dhe duke mbajtur të ankoruara pritjet për inflacionin. Gjithashtu, përgjatë fundit të vitit, përkatësisht në Dhjetor 2025, luhatjet e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës në tregun ndërkombëtar kanë ndikuar drejtpërdrejt në ecurinë e inflacionit në vend, ndërsa kategoritë e tjera kanë shfaqur luhatje të vogla e të balancuara nëpër muaj:

- *"Ushqime dhe pije joalkoolike" me rritje vjetore të çmimit prej +1.6%, duke kontribuar me +0.56 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.96 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje", me rritje vjetore të çmimit prej +2.1%, duke kontribuar me +0.16 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Pije alkoolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.11 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Hotele, kafene dhe restorante" me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.15 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Veshje dhe këpucë" me rritje vjetore të çmimit prej +0.4%, duke kontribuar me +0.02 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*
- *"Mallra dhe shërbime të ndryshme" me rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.10 p.p në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.*

Përgjatë vitit 2025, kursi i këmbimit (LEK/EUR) shënoi mesatarisht nivelin 97.83, ndërsa kursi ndaj dollarit (LEK/Dollar) arriti në 86.80. Viti 2025, krahasuar me vitin e kaluar, ka dëshmuar një ritëm më të zbutur të mbiçmimit të monedhës shqiptare kundrejt valutave kryesore, ndikuar edhe nga ndërhyrjet e shtuara të Bankës së Shqipërisë për blerje valute.

Në dhjetor të vitit 2025, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 12.9% krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024. Stoku i kredive në LEK shënoi një rritje prej 14.7%, ndërsa ai në valutë rritje prej 10.4%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Stoku i kredive akorduar korporatave jo-financiare (private dhe publike) për muajin dhjetor 2025 shënoi një rritje me 9.6%. Kredia vetëm për bizneset private jo-financiare u rrit me 9.9%, duke kontribuar pozitivisht me 5.6 p.p në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar korporatave publike jo-financiare për muajin dhjetor të vitit 2025 ka shënuar rritje me 0.2% krahasuar me dhjetor 2024, duke mos kontribuar në ndryshimin e stokut total të kredisë.

Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin dhjetor të vitit 2025, ka shënuar rritje prej 19.2% krahasuar me dhjetorin e vitit 2024, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 7.5 p.p. Në dhjetor 2025 rezulton se rreth 58.9% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në LEK, ndërsa pjesa tjetër prej 41.1% përbëhet nga kreditë në valutë. Niveli i kredive me probleme ndaj totalit të kredive, në fund të muajit dhjetor 2025, arriti në 3.8%.

2.1.3 Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar-dhjetor 2025 shënuan rënie vjetore prej -6.9% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për dhjetor 2025 shënuan rritje prej 5.6% në krahasim me dhjetor 2024. Në dhjetor 2025, eksportet e mallrave arritën vlerën 26.8 miliardë LEK, duke u rritur me 5.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe shënoi një rënie prej 4.3% në terma mujor. Rritja vjetore e eksporteve prej 5.6%, këtë muaj është ndikuar nga grupi: "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me kontribut pozitiv prej 3.0 pikë përqindje dhe me një rritje vjetore prej 15.3%.

Importet e mallrave për periudhën janar-dhjetor 2025 shënuan një rënie prej -0.8% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për muajin dhjetor 2025 importet shënuan rritje vjetore prej 1.3% në krahasim me muajin dhjetor 2024. Në dhjetor 2025 importet e mallrave arritën vlerën 79.8 miliardë LEK, duke u rritur me 1.3% në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 12.6%, në krahasim me nëntor 2025. Rritja vjetore e importeve prej 1.3%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupi: "materiale ndërtimi dhe metale " me kontribut pozitiv prej 1.2 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 10.5%.

Për vitin 2025, deficiti tregtar arriti vlerën 541.14 miliardë LEK, duke u përkeqësuar me 3.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024. Deficiti tregtar i dhjetorit 2025 është 53.0 miliardë LEK, duke rënë me 0.8%, krahasuar me dhjetor 2024 dhe duke u rritur me 23.7%, në krahasim me nëntor 2025. Shkëmbimet tregtare, për vitin 2025, me vendet e BE-së zënë 57.0% të gjithë tregtisë. Gjatë këtij viti, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72.5% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51.0% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26.8 %), Kina (10.5%), Greqia (7.6%) e Turqia (7.3%).

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Aktiviteti ekonomik u ngadalësua në Ballkanin Perëndimor në vitin 2025. Rritja vjetore e prodhimit të rajonit ra në 2.6%, nga 3.6% një vit më parë, kryesisht për shkak të një ngadalësimi të theksuar në Serbi, ekonomia më e madhe në rajon. Rritja e PBB-së në Kosovë shënoi ngadalësimin e dytë më të fortë, ndërsa Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria panë vetëm norma pak më të ulëta rritjeje krahasuar me vitin e kaluar. Maqedonia e Veriut ishte i vetmi vend ku rritja ekonomike u përshpejtua. Normat e rritjes së PBB-së varionin nga 2% në Serbi deri në 3.8% në Shqipëri.

Rritja ekonomike u nxit përgjithësisht nga kërkesa e brendshme. Konsumi privat mbeti një kontribues kyç në rritjen e prodhimit në vitin 2025, megjithëse rritja e tij vjetore u ngadalësua pothuajse në të gjitha ekonomitë e rajonit. Konsumi i familjeve u mbështet kryesisht nga rritja e fortë e pagave. Rritja e investimeve gjithashtu u ngadalësua në shumicën e ekonomive të rajonit, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinë, ndërsa u përshpejtua në Kosovë dhe Mal të Zi falë rritjes së shpenzimeve publike kapitale. Dinamikat e tregtisë u karakterizuan përgjithësisht nga rritje më e fortë e importeve sesa e eksporteve, duke rezultuar në kontribute negative të tregtisë ndërkombëtare në rritjen e prodhimit në shumicën e ekonomive.

Treguesit e tregut të punës gjatë vitit 2025 reflektuan dinamika të ndryshme ndërmjet komponentëve kryesorë. Punësimi mesatar i rajonit ra për herë të parë që nga viti 2020, me 0.6%, ndërsa pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit në disa ekonomi.

Deficiti mesatar i ponderuar i llogarisë korente të rajonit u rrit lehtë, në 4.9% të PBB-së në vitin 2025. Kjo u nxit kryesisht nga zgjerimi i deficiteve tregtare të mallrave dhe ulja e suficiteve të të ardhurave dytësore dhe të shërbimeve si përqindje ndaj PBB-së. Rezervat valutore u rritën në disa ekonomi të rajonit në fillim të vitit 2026, ndërsa raportet e mbulimit të importeve mbetën të qëndrueshme.

Inflacioni mesatar vjetor në Ballkanin Perëndimor u rrit lehtë në 3.7% në vitin 2025, nga 3.4% një vit më parë, kryesisht i nxitur nga çmimet e ushqimeve dhe rritja e pagave. Norma e inflacionit varionte nga 2.2% në Shqipëri në 6.1% në Kosovë. Të gjitha bankat qendrore me autonomi monetare ruajtën qëndrimin e tyre të politikës.

Banka Kombëtare e Serbisë mbajti normën e saj bazë të pandryshuar në 5.75%, pasi e kishte ulur në tre hapa në gjysmën e dytë të vitit 2024. Banka e Shqipërisë e ka mbajtur atë në 2.5% që nga ulja e fundit me 25 pikëbazë në korrik 2025, ndërsa banka qendrore e Maqedonisë së Veriut vendosi në mars ta mbajë normën kryesore 4%.

Në vitin 2025, shpenzimet buxhetore u rritën më shpejt se të ardhurat dhe bilancet fiskale u përkeqësuan në shumicën e ekonomive të Ballkanit Perëndimor krahasuar me një vit më parë. Në shumicën e ekonomive (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Kosova), bilancet fiskale u mbështetën nga shpenzimet kapitale që mbetën pas planeve, shpesh me diferencë të konsiderueshme.

Në Shqipëri, PBB për tremujorin e katërt të vitit 2025 vlerësohet me rritje prej 3.80%, kundrejt tremujorit të katërt 2024. Ndërkohë, për vitin 2025 Shqipëria është vlerësuar me një rritje prej 3.79% krahasuar me vitin 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit privat, konsumit publik, investimeve dhe eksporteve, të cilat tejkaluan rritjen e importeve.

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto *(rritja vjetore ne %, në terma reale)*	**2024**	**2025**
Maqedonia e Veriut	3.0	3.4
Mali i ZI	3.2	2.7
Serbia	3.9	2.0
Shqipëria	**4.0**	**3.8**
Bosnja dhe Hercegovina	2.6	2.1
Kosova	4.6	3.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

Gjatë vitit 2025, norma e papunësisë (15-64 vjeç) u ul në të gjithë rajonin, përveç Serbisë, ku u rrit në mënyrë të lehtë nga një nivel rekord i ulët një vit më parë. Normat e papunësisë ishin në nivele historikisht të ulëta, por mbeteshin dukshëm mbi mesataren e BE-së, duke variuar nga 8.7% në Serbi deri në 12.2% në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ndërkohë, në Shqipëri norma e papunësisë pësoi një përmirësim të lehtë në 9.3% për vitin 2025.

Tabela 2 Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë *(mesatare vjetore, në %)*	**2024**	**2025**
Maqedonia e Veriut	12.5	11.7
Mali i ZI	11.6	10.9
Serbia	8.6	8.7
Shqipëria	**9.4**	**9.3**
Bosnja dhe Hercegovina	12.6	12.2
Kosova	10.8	n.a

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

Deficiti mesatar i ponderuar i llogarisë korente, në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri, u ul si përqindje ndaj PBB-së krahasuar me vitin e kaluar. Flukset neto të investimeve të huaja direkte si përqindje ndaj PBB-së u ulën në shumicën e ekonomive të rajonit në vitin 2025, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në shumicën e rasteve, ato mbuluan një pjesë më të vogël të deficitit të llogarisë korente krahasuar me një vit më parë, veçanërisht në dy vendet e përmendura më sipër.

Tabela 3 Bilanci tregtar

Defiçiti i llogarisë korente *(në % të PBB)*	**2024**	**2025**
Maqedonia e Veriut	-2.2	-4.3
Mali i ZI	-17.1	-20.5
Serbia	-4.7	-4.9
Shqipëria	**-2.4**	**-0.7**
Bosnja dhe Hercegovina	-3.4	-3.1
Kosova	-8.4	-8.2

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

Në përputhje me trendet globale, inflacioni vazhdoi një trajektore rritëse për vendet e rajonit gjatë vitit 2025. Në tremujorin e parë të vitit 2026, inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit u ngadalësua në Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, ndërsa u rrit në Kosovë dhe Shqipëri. Në vitin 2025, inflacioni mesatar për vendet e Ballkanit Perëndimor u rrit ndjeshëm në 3.7%, nga 2.8% në vitin 2024.

Tabela 4 Norma e inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit/Inflacioni *(ndryshimi vjetor në %)*	2024	2025
Maqedonia e Veriut	3.5	4.1
Mali i ZI	3.3	3.9
Serbia	4.6	3.9
Shqipëria	**2.2**	**2.2**
Bosnja dhe Hercegovina	1.7	4.0
Kosova	1.6	3.9

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

Tre nga gjashtë vendet e rajonit kanë rritur deficitet fiskale për vitin 2025. Ndërsa performanca e të ardhurave ishte e fortë në shumicën e vendeve, shpenzimet më të larta kanë ndikuar në rritjen e deficiteve fiskale. Si rezultat, deficiti mesatar fiskal i rajonit është rritur me 0.4 pp. të PBB-së, duke arritur në 2.7% të PBB-së në vitin 2025. Ndërkohë, deficiti fiskal për Shqipërinë u zgjerua nga 0.7% e PBB-së në vitin 2024 në 1.8% në vitin 2025, por mbeti nën objektivin prej 2.4%, kryesisht për shkak të mosrealizimit të plotë të shpenzimeve kapitale.

Tabela 5 Bilanci fiskal

Balanca e përgjithshme e qeverisë/Defiçiti fiskal *(në % të PBB)*	2024	2025
Maqedonia e Veriut	-4.4	-4.0
Mali i ZI	-3.3	-4.3
Serbia	-2.0	-2.4
Shqipëria	**-0.7**	**-1.8**
Bosnja dhe Hercegovina	-3.0	n.a
Kosova	-0.3	-0.8

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul ose mbeti përgjithësisht i pandryshuar në shumicën e ekonomive të rajonit në vitin 2025. Rënia e barrës së borxhit ishte më e theksuar në Serbi (me 2.3 pp) e ndjekur nga Maqedonia e Veriut (me 2 pp). Raporti i borxhit publik u rrit dhe ishte më i larti në Mal të Zi, në nivelin 63.5% të PBB-së, i ndjekur nga Maqedonia e Veriut përkatësisht me 59.4 të PBB-së. Në Shqipëri borxhi publik vazhdoi të ulet, duke arritur në 53.0% të PBB-së në vitin 2025, i mbështetur nga konsolidimi fiskal dhe mbiçmimi i kursit të këmbimit.

Tabela 6 Borxhi publik

Borxhi publik total *(në % të PBB)*	2024	2025
Maqedonia e Veriut	53.0	51.6
Mali i ZI	61.3	63.5
Serbia	46.7	44.4
Shqipëria	**54.2**	**53.0**
Bosnja dhe Hercegovina	25.5	25.6
Kosova	16.8	16.4

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN), Q1-2026

3 MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë vitit 2025 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2025 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Në fund të muajit Dhjetor 2025, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,401.5 miliardë LEK ose 52.9% e PBB, duke shënuar ulje krahasuar me fundin e vitit 2024 (1.3 pp ulje).

Viti 2025 ka qenë pozitiv përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë vitit 2025 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2025 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2025. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 454.0 miliardë LEK, nga të cilat 78.2% (ose 355.2 miliardë LEK) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 21.8% (ose 98.8 miliardë LEK) nëpërmjet burimeve të huaja. Ministria e Financave emetoi tituj shtetërorë në vlerën 355.2 miliardë LEK në tregun e brendshëm, nga të cilët 186.2 miliardë LEK Bono Thesari dhe 169.1 miliardë LEK Obligacione. Huamarrja e jashtme bruto u realizua në nivelin 98.8 miliardë LEK. Në muajin shkurt 2025, Republika e Shqipërisë emetoi eurobondin e saj të shtatë, në vlerën 650 milionë Euro, me maturim dhjetëvjecar, me kupon 4.75%, yield 5.0% dhe me një ofertë përfundimtare (final book) prej mbi 2.5 miliardë euro.

Gjatë vitit 2025, është punuar për përditësimin dhe hartimin e Strategjisë së re 2026-2030. Në muajin Dhjetor 2025, u miratua Strategjia e përditësuar nëpërmjet VKM Nr. 743, datë 12.12.2025 “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2026-2030, e cila prioritet do vijojë të ketë rritjen e jetëgjatësisë së borxhit, kryesisht atij të brendshëm, si dhe uljen e mëtejshme e riskut ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Janë vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit do vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim të mëtejshëm në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2025 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë kësaj periudhe është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it. Në drejtim të krijimit të madhësive benchmark është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

Informacion më të detajuar dhe gjithëpërfshirës për këtë qëllim, do të gjeni në “***Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2025***” që i bashkëlidhet këtij relacioni.

4 POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

4.1 Politika fiskale në vitin 2025 dhe efektet në buxhet e në ekonomi

Gjatë vitit fiskal 2025 nuk u hartua ose miratua asnjë paketë e re fiskale që do të gjeneronte të ardhura shtesë buxhetore. Efektet e të ardhurave të regjistruara gjatë vitit 2025 rrjedhin ekskluzivisht nga masat fiskale të miratuara më parë dhe nga zbatimi i vazhdueshëm i kalendarëve të përcaktuar të legjislacionit tatimor.

4.1.1 Efektet nga zbatimi i kalendarit të akcizës (2022–2026)

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Akcizat, kalendari shumëvjeçar për rritjen graduale vjetore të normave të akcizës për produktet e duhanit vazhdoi të zbatohet gjatë gjithë vitit 2025. Zbatimi i rregullimit të normës së planifikuar për këtë vit gjeneroi:

- *857 milionë LEK të ardhura shtesë nga akciza;*
- *171 milionë LEK të ardhura shtesë nga TVSH-ja (20%) u aplikuan në bazën e rritur të akcizës.*

Ndikimi total i të ardhurave të kësaj mase për vitin 2025 vlerësohet në afërsisht 1 miliardë LEK.

4.1.2 Efektet nga rritja e fondit të pagave për administratën publike

Që nga 1 korriku 2024 ka hyrë në fuqi faza e dytë e reformës buxhetore të pagave për administratën shtetërore. Rritja që rezultoi në fondin e pagave në sektorin publik, prodhoi efekte të matshme në të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Për vitin f2025, ndikimi i parashikuar në të ardhura për shtatë muajt e parë, arriti në 6.3 miliardë LEK , nga të cilat:

- *4.3 miliardë LEK rrjedhin nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.*
- *2 miliardë LEK rrjedhin nga tatimi mbi të ardhurat personale;*

4.2 Efektet e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, për vitin 2025

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave u miratua me VKM Nr.847 datë 26.12.2024 "*Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të Veprimit 2024–2027*".

Për vitin 2025, Strategjia parashikoi një rritje të të ardhurave prej 16 miliardë LEK, ose 0.62% të PBB, nga të cilat afro 0.8 miliardë LEK u parashikuan nga Shtylla 1 "*Politika tatimore*", rreth 13.8 miliardë LEK nga Shtylla 2 "*Administrimi i mallrave tatimore*" dhe rreth 1.4 miliardë LEK nga Shtylla 3 "*Administrimi i mallrave doganore*". Bazuar në të dhënat për vitin 2025, objektivi i rritjes së të ardhurave është arritur dhe tejkaluar.

Të ardhurat shtesë për vitin 2025 arritën në 19.6 miliardë LEK, ose rreth 0.76% të PBB, që është rreth 3.7 miliardë LEK ose 0.14 % e PBB më shumë se objektivi i Strategjisë për vitin 2025.

Realizimi i Objektivit të të Ardhurave

- *Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) për vitin 2025 kishte parashikuar një rritje të të ardhurave prej +15,963 milionë LEK ose 0.62% e PPB.*
- *Faktikisht, rritja e realizuar është +19.64 miliardë LEK ose 0.76% e PPB, duke e tejkaluar objektivin me +3.68 miliardë LEK (0.14% e PPB).*
- *Të ardhurat nga tatime-doganat (pa përfshirë kontributet) arritën 496.2 miliardë LEK (+8.6% ndaj 2024).*
- *Të ardhurat nga kontributet u realizuan në shumën 178.2 miliardë LEK, +17.2 miliardë LEK (ose +10.7%) krahasuar me vitin 2024.*

Performanca e të Ardhurave sipas Shtyllave të Strategjisë

- *Shtylla 1 (Rishikimi i Politikës Tatimore): 857 milionë LEK (57 milionë mbi objektivin).*
- *Shtylla 2 (Mirëadministrimi Tatimor): 17,429 milionë LEK (3,6 miliardë mbi objektivin).*
- *Shtylla 3 (Mirëadministrimi Doganor): 1,353 milionë LEK (55 milionë nën objektiv).*

Zbatimi i Masave dhe Aktiviteteve

- 40 tregues performance dhe mbi 70 masa u monitoruan për vitin 2025.
- U hartua "Raporti i Vlerësimit të Përjashtimeve Tatimore", i cili mbulon TVSH, tatimin mbi të ardhurat, tatimin mbi fitimin dhe akcizën.
- U hartuan dhe u zbatuan planet sektoriale për ndërtimin dhe turizmin.
- U realizua pjesërisht analiza e tregtisë elektronike dhe u miratuan ndryshimet ligjore për bizneset online.
- U realizuan 168 hetime tatimore (duke tejkaluar objektivin e synuar 150 hetime, 133 nga të cilat dërguar në prokurori).
- Gjatë vitit 2025 janë audituar 100 individë të pasur dhe 101 individë të tjerë, duke përdorur të dhëna nga palët e treta.
- Ulja e kufirit të transaksioneve Cash mes bizneseve, vendosja e një kufiri për transaksionet Cash mes bizneseve e konsumatorëve dhe përcaktimi i një kalendari për vendosjen e POS-eve nga të gjithë bizneset deri në fund të vitit 2026.
- Rritje e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO) në 18, nga 16 që ishte në 2024.
- Ecuri pozitive e dy projekteve strategjike të IT-së për administratën doganore:
    1. *NSW – ka përfunduar fazën procedurale në Janar dhe pritet të jetë funksional në vitin 2027*
    2. *NCTS – është testuar dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2026.*

Evidentimi i treguesve kryesorë të performancës

- *TVSH e brendshme neto u rrit me +8.9 miliardë LEK ose 0.35% e PBB, duke tejkaluar objektivin që ishte 0.21% e PBB, duke siguruar kështu +3.4miliardë LEK mbi vlerën e synuar në strategji.*
- *Numri i tatimpaguesve me përgjegjësi TVSH-je për të gjithë sektorët arriti në 39,096 TP, me një rritje +6.6% në krahasim me 2024, duke tejkaluar objektivin prej rreth 4%.*
- *Është rritur numri i tatimpaguesve me përgjegjësi TVSH-je në sektorin e turizmit me +25.6% në krahasim me 2024, duke tejkaluar objektivin i cili parashikonte rritje me 20%.*
- *Kontributet e sigurimeve me +4.7 miliardë LEK mbirealizim ndaj vlerës së synuar në strategji.*
- *Të ardhurat nga tatimi mbi pagën dhe kontributet u rritën me +6.5 miliardë LEK në krahasim me 2024, ose 0.26% e PBB duke tejkaluar objektivin i cili ishte 0.05%.*
- *27 mijë kontribues të rinj në Shtator 2025, krahasuar me Shtator 2024 në skemën e kontributeve (3.6% e totalit të të punësuarve, objektivi i synuar 1.6% e totalit).*
- *U ndryshua fasha e pagës për 83,046 vende pune, nga 760,845 të punësuar mesatarisht në vitin 2025 ose për 10.9 % të totalit të të punësuarve.*

Përmirësimet e evidentuara**:**

- *Rritje e deklarimit të pagës reale dhe ulje e punës së padeklaruar.*
- *Digjitalizim i deklaratave tatimore (paraplotësim automatik TVSH dhe DIVA).*
- *Përdorim i zgjeruar i analizës së riskut dhe bashkëpunim me institucionet (DPSHTRR, AIDA, Inspektorati i Punës, bankat).*
- *Përmirësim i kapaciteteve doganore dhe rritje e kapjeve të mallrave të falsifikuara.*

Integrimi Evropian

- Strategjia përputhet me Agjendën e Integrimit dhe ka ndjekur rekomandimet e BE për transparencë dhe efikasitet fiskal. Për kushtet e caktuara në këtë dokument për vitin 2025, ka filluar puna që në vitin 2024 dhe masat e aktivitetet janë në rrugën e duhur, pasi:
  - *Raporti i përjashtimeve tatimore u hartua brenda afatit.*
  - *Administrata tatimore rriti përdorimin e të dhënave nga palë të treta.*
  - *Paraplotësim automatik i deklaratave të TVSH në mesin e vitit 2025.*
  - *Disa masa për 2026-2027 (taksa e pasurisë, NCTS, NSW) kanë filluar në 2024–2025 dhe janë në progres.*

Viti 2025 u vlerësua në përgjithësi i kënaqshëm për mbledhjen e të ardhurave dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara.

4.3 Të ardhurat e përgjithshme


Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën dymbëdhjetëmujore të vitit 2025 arritën në 754.6 miliardë LEK, duke shënuar një realizim prej 98% ndaj planit vjetor të rishikuar An.11 datë 19.12.2025. Në raport me planin fillestar të vitit 2025 (757 miliardë LEK), të ardhurat rezultuan -0.3% më të ulëta, ndërsa krahasuar me vitin 2024 shënuan një rritje prej 6.2%, ose rreth 44 miliardë LEK më shumë. Rritja vjetore e të ardhurave të buxhetit të shtetit në vitin 2025 reflekton vijimësinë e zhvillimeve pozitive ekonomike në vend, veçanërisht në sektorin e turizmit dhe në aktivitetet ekonomike që janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me të.

Reforma për rritjen e pagave në administratën publike, e zbatuar nga 1 korriku 2024, ka kontribuar në rritjen e ndjeshme të pagave edhe në sektorin privat, me një zgjerim prej 26.2% krahasuar me vitin 2024. Ky zhvillim, së bashku me masat për deklarimin real të pagave, forcimin e administrimit tatimor dhe reduktimin e punës së padeklaruar, ka sjellë përmirësim të bazës tatimore të të ardhurave nga puna.

Në të njëjtën kohë, zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe në Planin e Veprimit për vitin 2025 ka mbështetur rritjen e të ardhurave përmes forcimit të administrimit tatimor dhe doganor, rritjes së nivelit të përmbushjes nga tatimpaguesit dhe përmirësimit të efikasitetit të mbledhjes.


Të ardhurat nga fondet speciale, specifikisht kontributet janë zëri më performues, jo vetëm në karahasim me planin por dhe kundrejt 2024, me rreth 17.4 miliardë më shumë se 2024 dhe 1.4 miliardë LEK më shumë se plani i rishikuar.

Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK) ndaj PBB në vlerë e %.



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave gjatë vitit 2026



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Kategoritë në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë: I.Të ardhura nga ndihmat, II. Të ardhurat tatimore dhe III. Të ardhurat jotatimore të cilat zënë përkatësisht; 1%, 94.9% dhe 4.1% të të ardhurave të përgjithshme publike për vitin 2025. Kontributin më të madh në realizimin e të ardhurave totale e kanë dhënë të ardhurat tatimore, ku zërat me performancë të mirë në raport me planin fillestar të muajit janar 2025, në këtë kategori të ardhurash janë: II.1.4, Tatimi mbi të ardhurat personale (11.8 miliardë LEK ose 16.7% më shumë se plani fillestar) dhe II.3, Të ardhura nga fondet speciale (9.3 miliardë LEK ose 5.4% më shumë se plani fillestar).

Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë LEK)

	2021	2022	2023	2024	2024 (në % ndaj vitit paraardhës)	2025 (plan fillestar)	2025 (plan I rishikuar 19.12)	2025 (fakt)	2025 (në % ndaj planit fillestar)	2025 (në % ndaj planit të rishikuar)	2025 (në % ndaj vitit (paraardhës)
Të ardhura nga ndihmat	13.1	9.5	22.4	7.8	**34.8%**	19.0	20.3	7.4	**38.9%**	**36.4%**	**94.7%**
Të ardhura tatimore	475.6	541.3	598.7	659.1	**110.1%**	712.2	718.1	716.3	**100.6%**	**99.7%**	**108.7%**
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	161.5	191.4	192.3	214.0	**111.3%**	236.8	226.7	227.3	**96.0%**	**100.3%**	**106.2%**
Tatimi mbi Fitimin	35.6	47.7	64.6	57.0	**88.3%**	65.7	60.4	58.5	**89.0%**	**97.0%**	**102.7%**
Akcizat	51.6	53.5	58.4	63.4	**108.6%**	67.6	71.0	69.6	**102.9%**	**98.1%**	**109.7%**
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	39.3	45.0	57.9	66.2	**114.3%**	70.7	84.2	82.5	**116.7%**	**98.0%**	**124.7%**
Taksa Nacionale dhe te tjera	42.5	44.8	40.2	47.4	**118.0%**	49.6	47.1	48.8	**98.3%**	**103.6%**	**102.9%**
Taksa Doganore	7.5	8.4	9.1	9.0	**98.2%**	11.1	10.3	9.5	**85.6%**	**92.4%**	**105.7%**
Të ardhura nga Pushteti Vendor	26.7	27.6	31.7	40.3	**127.3%**	40.8	40.8	40.9	**100.3%**	**100.3%**	**101.4%**
Të ardhura nga fondet speciale	110.9	122.8	144.5	161.8	**112.0%**	169.9	177.7	179.1	**105.4%**	**100.8%**	**110.7%**
Të ardhura jotatimore	22.3	21.9	22.6	43.7	**193.5%**	25.8	31.7	30.9	**119.9%**	**97.5%**	**70.8%**
TOTALI I TË ARDHURAVE	**511.0**	**572.8**	**643.7**	**710.6**	**110.4%**	**757.0**	**770.1**	**754.6**	**99.7%**	**98.0%**	**106.2%**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme në % ndaj totalit sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave (2026)

4.3.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë 7.4 miliardë LEK, nga 7.8 miliardë LEK të një viti më parë, me një rënie në masën -5.3% ose -0.4 miliardë LEK dhe me realizim ndaj planit të rishikuar në masën 36.4%.


4.3.2 Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor si dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12 mujore arritën në vlerën 716.3 miliardë LEK, me një realizim ndaj planit vjetor të rishikuar në masën 99.7% ose -1.8 miliardë LEK më pak, krahasuar me një vit më parë 57.2 miliardë LEK ose 8.7 % më shumë.

4.3.3 Të ardhurat nga pushteti vendor

Për vitin 2025, NJVQV në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 40 911 milionë LEK, shifër kjo që është 580 milionë LEK më shumë ose rreth 1.4% më e lartë se vlera e të ardhurave tatimore vendore të mbledhura gjatë 2024. Të ardhurat vendore për vitin 2025 janë realizuar në raportin 100.3% krahasuar me parashikimet makroekonomike duke dëshmuar për ecurinë pozitive të ekonomisë vendore. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat e realizmit të këtyre burimeve dhe ritmi i ndryshimit të tyre gjatë viteve.


Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Referuar përbërjes së tyre sipas zërave kryesorë (referuar tabelës së treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar), që janë Taksat Lokale dhe Taksa mbi Pasurinë, grafikisht të ardhurat e veta të pushtetit vendor për vitin 2025 të ndara në përqindje paraqiten si më poshtë:

Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %)[1]




Burimi: Ministria e Financave (2026)

[1] ***Shënim***: *Taksa mbi biznesin e vogël, pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2025, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 36 milionë LEK, që përbëjnë vetëm 0.09% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.*

4.3.4 Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 179.1 miliardë LEK, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 100.8% ose 1.4 miliardë LEK më shumë. Të ardhurat nga fondet speciale shënuan rritje në krahasim me parashikimin e të ardhurave në buxhetin fillestar të vitit 2025 prej 5.4 % ose 9.3 miliardë LEK më shumë dhe 17.4 miliardë LEK apo 10.7% më shumë se një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: *Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për Kompensimin në vlerë të Pronarëve, përkatësisht në vlerën 154.7 miliardë LEK, 23.5 miliardë LEK dhe 0.9 miliardë LEK*.

Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2026)

4.3.5 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore rezultojnë në vlerën 30.9 miliardë LEK krahasuar me 43.7 miliardë të një viti më parë, me një ulje vjetore nga viti 2024 prej 29.2% ose -12.8 miliardë LEK më pak dhe me një realizim ndaj planit të rishikuar në masën 97.5% ose -0.8 miliardë LEK më pak. Ndër zërat kryesor që përbëjnë të ardhurat jotatimore për vitin 2025 janë: të ardhurat nga institucionet buxhetore, të ardhurat nga dividenti, të ardhura nga tarifat e shërbimeve dhe të ardhura të tjera, të cilat kanë mbledhur përkatësisht 15.5 miliardë LEK, 46 milionë LEK, 3.5 miliardë LEK dhe 11.9 miliardë LEK.

Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë LEK) në % të realizimit




Burimi: Ministria e Financave (2026)

4.3.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat


Të ardhurat nga "Tatimet dhe Dogana" janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme për vitin 2025 të cilat kanë kontribuar në buxhetin e shtetit me rreth 18.7% të PBB. Krahasuar me vitin 2024, ky zë shënon një performancë pozitive prej 39.2 miliardë LEK ose 8.6% më shumë. Në krahasim me planin e rishikuar të aktit normativ nr.10, realizimi është 99.3% ose -3.4 miliardë LEK më pak.

Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë LEK) dhe në % të PBB



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 11 Të ardhurat nga zërat tatimorë në raport me të ardhurat totale nga tatimet dhe doganat për vitin 2025



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshijnë Tatimin mbi vlerën e shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhurat personale; Akcizat; Taksat Doganore dhe Taksa të tjera kombëtare. DPT administron edhe mbledhjen e rreth 96% të totalit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të ardhurat e administruara nga DPT e DPD për vitin 2025, janë realizuar në vlerën 668.3 miliardë LEK, 9.1% ose 55.7 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe realizim në masën 99.6% të planit vjetor të rishikuar sipas AN.10/2025.

Rezultati pozitiv krahasuar me 2024, është një tregues i qartë i konsolidimit të ekonomisë shqiptare. Për vitin 2025 konstatohet se të ardhurat nga *TVSH neto e brendshme* janë më të larta në krahasim me 2024 në shumën 8.9mld LEK dhe në krahasim me planin e rishikuar në shumën 2.7mld LEK më shumë, ku ndikim ka patur:

- *TVSH bruto e arkëtuar në vitin 2025, është rreth 1.3 miliardë LEK më shumë se plani ose +1.4%. Krahasuar me vitin 2024 janë rreth 11.8 miliardë LEK më shumë ose 14.4%.*
- *Gjatë vitit 2025 janë dhënë 25.3 miliardë LEK rimbursime ose -1.4 miliardë LEK më pak se planifikimi dhe 2.9 miliardë LEK më shumë se viti 2024.*

Të ardhurat nga *tatimi mbi të ardhurat personale* vijojnë me rritje nga viti i kaluar si rezultat i:

- *Ecurisë pozitive të rritjes tatimit mbi të ardhurat nga sektori publik (+17.8%) dhe privat (+26.2%) në krahasim me vitin 2024, si rezultat i fushatës anti-informalitet për deklarimin real të pagës në sektorin privat dhe eleminimin e punës në të zezë si dhe masat e marra në zbatim të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të veprimit për vitin 2025;*
- *Rritje e të ardhurave nga tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave me rreth 415 milionë LEK ose +23.3% më shumë, për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024.*
- *Tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme me rritje prej 36% ose rreth 2 miliardë LEK më shumë në krahasim me vitin 2024, pavarësisht se gjatë 2025 është diskutuar projektligji i rivlerësimit;*
- *Rritja e të ardhurave nga interesat bankarë me 12.9% si dhe rritja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat nga qeratë me 8.5%. Të ardhurat nga qeratë janë indikator edhe në SAA dhe për vitin 2025 nuk janë realizuar sipas pritshmërive.*

Vazhdon ecuria e mirë e mbledhjes së *të ardhurave nga kontributet* si rezultat jo vetëm i efekteve të rritjes së fondit të pagave në sektorin shtetëror në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar nga e cila merret 27.9%, por edhe rritja e fondit të pagave në sektorin privat.

Taksa nacionale rezulton me mbi realizim krahasuar me planin por edhe me rritje nga periudha paraardhëse kryesisht për zërat kryesorë si: taksa e qarkullimit me rritje 13.4%, taksa për automjetet e përdorura të transportit me rritje 9.5% si dhe taksa për ambalazhet plastike me rritje 9.6%. Për vitin 2025 ishin parashikuar 2mld LEK të ardhura shtesë nga hyrja në fuqi e paketës nënligjore për lojrat e fatit, të cilat nuk u materializuan.

Të ardhurat nga TVSH në import janë -1.3 % krahasuar me planin vjetor të rishikuar, ndërkohë që krahasuar me të njëjtë periudhë të vitit 2024, të ardhurat nga ky zë janë rritur me rreth +4.4 miliardë LEK ose +2.8 %. Sipas të dhënave të raportuara nga Administrata Doganore një ndikim të rëndësishëm në këtë rezultat kanë pasur edhe humbjet e shkaktuara nga kursi i këmbimit, nga rënia e dollarit me rreth -6% dhe rënia e euros me -3%, me efekt total vjetor rreth minus 9.5 miliardë LEK. Për vitin 2025, importi i taksuar në peshë është rritur me 10%, ndërsa në vlerë është rritur me 2%. Eksporti definitiv në peshë ka pësuar një rënie me rreth -1%, ose në vlerë me -8%.

Të ardhurat nga akciza janë rritur me rreth +6.2 miliardë LEK ose rreth +9.7% më shumë se viti 2024. Rritja e të ardhurave nga viti 2024, ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së sasisë së karburanteve të hedhura për konsum me rreth +78 mijë ton më shumë, cigareve me +210 ton, kafes me +416 ton.

Taksa doganore janë rreth -780 milionë LEK më pak krahasuar me planin e rishikuar, ndikuar nga fenomeni i ndryshimit të origjinës së importit të cigareve me efekt rreth -95 milionë LEK, rënies së sasisë së importuar të sheqerit me efekt në taksën doganore me rreth -30 milionë LEK, ujit dhe lëngjeve të tjera me efekt rreth -15 milionë LEK.

Renta minerare krahasuar me vitin 2024, ka rezultuar me rreth -880 milionë LEK ose -32.2 %, me një mosrealizim të planit të periudhës me rreth -135mln LEK. Renta minerare e naftës bruto ka pësuar një rënie prej -602mln LEK ndërsa renta e minerareve të tjera një rënie prej -319 milionë LEKsh, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndikuar si nga rënia e çmimeve ndërkombëtare dhe sasisë së eksportuar jashtë vendit.

Tabela 8 Të ardhurat nga Adiministrata Tatimore dhe Administrata Doganat (në milionë LEK)

Lloji i taksave	Fakt 2024	Fakt 2025	Plan Fillestar 2025	Diferenca 2025/2024	Ndryshimi në % 2025/2024	Diferenca Fakt/Plan fillestar 2025	Ndryshimi në % Fakt/Plan fillestar 2025	2025 (plani i rishikuar AN10 tetor)	Diferenca fakt 2025/ Plan i rishikuar 2025	Ndryshimi Fakt/ Plan i rishikuar 2025 në %
TVSH TOTAL	**213,999**	**227,261**	**236,784**	**13,262**	**6.2%**	**-9,522**	**-4.0%**	**226,687**	**575**	**0.3%**
Tvsh në import	154,376	158,742	170,282	4,366	2.8%	-11,539	-6.8%	160,832	-2,090	-1.3%
Tvsh brenda vendit	59,623	68,519	66,502	8,897	14.9%	2,017	3.0%	65,854	2,665	4.0%
Rimbursim TVSH	22,374	25,299	26,135	2,925	13.1%	-836	-3.2%	26,677	-1,378	-5.2%
Tatimi mbi fitimin	**56,995**	**58,547**	**65,749**	**1,552**	**2.7%**	**-7,202**	**-11.0%**	**60,387**	**-1,840**	**-3.0%**
Akciza	**63,437**	**69,599**	**67,620**	**6,162**	**9.7%**	**1,979**	**2.9%**	**70,961**	**-1,362**	**-1.9%**
Tatimi mbi të ardhurat personale	**66,163**	**82,532**	**70,705**	**16,369**	**24.7%**	**11,827**	**16.7%**	**84,212**	**-1,680**	**-2.0%**
Taksa Nacional dhe te tjera	**47,418**	**48,799**	**49,637**	**1,381**	**2.9%**	**-838**	**-1.7%**	**47,107**	**1,692**	**3.6%**
Taksat nacionale Dpt	44,685	46,945	46,909	2,260	5.1%	36	0.1%	45,118	1,827	4.0%
Renta Minerare	2,734	1,854	2,728	-879	-32.2%	-874	-32.0%	1,989	-135	-6.8%
Taksë Doganore	**8,973**	**9,486**	**11,078**	**514**	**5.7%**	**-1,592**	**-14.4%**	**10,267**	**-780**	**-7.6%**
TOTALI TATIME + DOGANA	**456,984**	**496,225**	**501,572**	**39,240**	**8.6%**	**-5,348**	**-1.1%**	**499,621**	**-3,396**	**-0.7%**
Kontributet e mbledhura (DPT)	**155,612**	**172,039**	**164,057**	**16,427**	**10.6%**	**7,982**	**4.9%**	**171,403**	**636**	**0.4%**
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet DPT)	**612,596**	**668,264**	**665,630**	**55,668**	**9.1%**	**2,634**	**0.4%**	**671,024**	**-2,760**	**-0.4%**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

ADMINISTRATA DOGANORE

Të ardhurat nga administrata doganore për vitin 2025 (*të ardhurat nga tvsh-ja në import, akciza, taksa doganore dhe renta minerare*) u arkëtuan në vlerën rreth 239.7mld LEK, rreth +10.2 miliardë LEK ose +4.4 % më shumë se viti 2024, si dhe -4.4 miliardë LEK ose -1.8% më pak se plani i rishikuar të ardhurave doganore për 2025.

Tabela 9 Të ardhurat progresive Administrata Doganore Janar – Dhjetor 2025

Të ardhurat doganore	Progresive Janar - Dhjetor			Dif Fakt Progresive 2025-2024		Dif Progresiv-Fakt-Plan	
	Fakt 2024	Fakt 2025	Plan 2025 An 10	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
Tvsh në import	154,376	158,742	160,832	4,366	2.8%	-2,090	-1.3%
Akciza	63,437	69,599	70,961	6,162	9.7%	-1,362	-1.9%
Renta Minerare	2,734	1,854	1,989	-879	-32.2%	-135	-6.8%
Taksë doganore	8,973	9,486	10,267	514	5.7%	-780	-7.6%
TOTALI	**229,520**	**239,682**	**244,049**	**10,162**	**4.4%**	**-4,367**	**-1.8%**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Dognave

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, akciza ka pasur rritjen më të madhe të të ardhurave me rreth +6.2 miliardë LEK e ndjekur nga tvsh-ja në import me rreth +4.4 miliardë LEK dhe taksa doganore me +514 milionë LEK, ndërkohë që renta minerare ka pësuar një rënie të të ardhurave me rreth -780 milionë LEKsh.
Krahasuar me planin e rishikuar të gjithë zërat e të ardhurave doganore kanë rezultuar me mosrealizim të shumës vjetore të planifikuar. Të ardhurat e munguara nga tvsh-ja në import janë rreth -2.1 miliardë LEK dhe nga akciza rreth -1.4 miliardë LEK më pak se plani i periudhës. Po ashtu taksat doganore shënuan një mosrealizim prej -780 milionë LEKsh dhe renta minerare rezultoi -135 milionë LEK më pak se niveli i parashikuar vjetor. Më poshtë jepet realizimi i të ardhurave doganore gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 dhe me planin e rishikuar sipas An 10/2025.

Një ndër faktorët kryesorë negativë që kanë ndikuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 ishte rënia e kursit të këmbimit të monedhës shqiptare me dollarin amerikan dhe monedhën europiane, që solli një humbje të të ardhurave prej -9.5 miliardë LEK gjatë vitit 2025.

Efekti i kursit të këmbimit:

Tabela më poshtë paraqet diferencat në kursin e këmbimit të EUR dhe USD sipas muajve, sipas së cilës të dy monedhat janë zhvlerësuar kundrejt lekut gjatë vitit 2025, duke sjellë ndikim të konsiderueshëm për administratën doganore.

Tabela 10 Kursi i këmbimit të lekut me euron dhe dollarin

Muajt	2025		2024	
	U$D	€URO	U$D	€URO
Janar	94.26	98.15	93.94	103.88
Shkurt	96.14	99.8	95.95	103.9
Mars	95.41	99.23	95.92	103.99
Prill	88.97	99.29	95.37	102.87
Maj	86.78	98.71	93.77	100.64
Qershor	86.86	98.39	93.01	100.86
Korrik	83.67	98.08	93.7	100.31
Gusht	85.41	97.47	92.58	100.22
Shtator	83.85	97.88	89.62	99.65
Tetor	82.41	96.82	88.25	98.77
Nëntor	83.89	96.85	90.45	98.29
Dhjetor	83.48	96.7	93.45	98.35
Mesatarja	**87.59**	**98.11**	**93**	**100.98**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Dognave

Të ardhurat nga TVSH në import për vitin 2025 rezultojnë 158.7 miliardë LEK, rreth +4.4 miliardë LEK ose +2.8% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, ndërkohë krahasuar me planin e periudhës të ardhurat nga ky zë rezultojnë rreth -2.1 miliardë LEK ose -1.3 % më të ulëta.

Nga 60 grup produktet doganore me *efekt pozitiv* në të ardhurat e TVSH-së krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 janë:

- *Energjia elektrike, me efekt në të ardhura +2.1 miliardë LEK, ose +80%. Kjo përqindje tepër e lartë vjen si pasojë e faktit se deri në fund të vitit 2024, të ardhurat nga tvsh-ja në import nga energjia elektrike kanë qënë me minus, për shkak të rënies së çmimeve ndërkombëtare. Ndërkohë për Janar-Dhjetor 2025, janë rritur jo vetëm çmimet por edhe sasia e energjisë elektrike ka pasur një rritje me rreth +52 %.*
- *Cigaret, me efekt në të ardhura +646 milionë LEK, ose+ 9%, ndikuar nga rritja e sasisë së importuar me rreth 222 ton ose +7%.*
- *Karburantet e importit me efekt në të ardhura nga TVSH me rreth +680 milionë LEK ose +3%, ndikuar nga rritja e sasisë së importuar me rreth +81,077 ton ose +12%.*

Ndër produktet me *efekt negativ* në TVSH kanë qenë:

- *Automjetet e përdorura me efekt -792 milionë LEK, ose -8%, si rezultat i rënies së sasisë së importuar me rreth -43%, ose -36,573 copë më pak.*
- *Automjetet e reja me efekt negativ -244 milionë LEK, ose -11% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2024, ndikuar gjithashtu nga rënia e sasisë së importuar me rreth -8 %.*

Të ardhurat nga akciza për vitin 2025 janë arkëtuar në vlerën 69.6 miliardë LEK, rreth +6.2 miliardë LEK ose +9.7% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2024, por me rreth -1.4 miliardë LEK më pak të arkëtuara krahasuar me planin vjetor të rishikuar të akcizës për vitin 2025.

Ndikim pozitiv të rëndësishëm në të ardhurat nga akciza kanë pasur produktet:

- *Karburantet në import, me një rritje të sasisë së hedhur për konsum me rreth +78 mijë ton (+11%) më shumë se periudha Janar- Dhjetor e vitit 2024, me efekt në të ardhura me rreth +3.5 miliardë LEK më shumë ose +12%.*
- *Cigaret e hedhura për konsum gjithashtu kanë pësuar rritje me +7% ose +210 ton më shumë.Të ardhurat nga akciza për këtë kategori janë me rritje rreth +2 miliardë LEK ose +9% si rezultat edhe i zbatimit të kalendarit të rritjes së akcizës.*

Në tabelën më poshtë paraqiten sasitë mujore të hedhura për konsum, për dy nga artikujt kryesorë të akcizës:

Tabela 11 Sasitë e karburantit dhe cigareve, të hedhura për konsum, 2025/2024 (në mijë LEK)

Muajt	Karburante në ton		Diferenca 2025/2024		Cigare në ton		Diferenca 2025/2024	
	2024	2025	Në vlerë	Në %	2024	2025	Në vlerë	Në %
Janar	47,317	55,387	8,070	17%	225	233	8	4%
Shkurt	46,830	55,001	8,171	17%	205	217	12	6%
Mars	48,702	54,883	6,181	13%	240	258	18	7.5%
Prill	55,271	63,782	8,511	15 %	201	238	37	18%
Maj	58,645	61,085	2,440	4%	260	140	120	46%
Qershor	56,975	67,276	10,301	18%	309	304	-5	-2%
Korrik	67,361	73,555	6,194	9%	280	337	57	20%
Gusht	76,155	76,424	269	0.35	344	367	23	6.7
Shtator	56,035	65,033	8,998	16	278	311	33	12
Tetor	55,592	67,420	11,828	21.3	274	297	23	8.4
Nëntor	54,496	53,647	-849	-1.5	302	289	-13	-4.3
Dhjetor	59,986	68,096	8,110	13.5	282	273	-9	-3
Total	**683,364**	**761,589**	**78,225**	**11%**	**3,200**	**3,410**	**210**	**7%**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Tabela 12 Të ardhurat në akcizë nga mallrat kryesore të për vitin 2024/2025 sipas 60 grup produkteve

në mijë LEK

Nr	Artikulli	2024	2025	Diferenca	
				Vlerë	në %
1	Cigare	23,650,124	25,705,663	2,055,538	9%
2	Duhan Importi	881,621	509,682	- 371,939	-42%
3	Duhan Prodhim Vendi	212,095	266,541	54,446	26%
	Cigare Duhan Total	**24,743,840**	**26,481,886**	**1,738,045**	**7%**
4	Birrë Importi	1,980,530	1,874,359	- 106,171	-5%
5	Birrë Prodhim Vendi	1,176,811	1,261,904	85,093	7%
	Birre Total	**3,157,341**	**3,136,263**	**- 21,078**	**-1%**
6	Pije Alkolike Import	597,764	643,690	45,926	8%
7	Pije Alkolike Prodhim Vendi	85,112	94,514	9,402	11%
	Pije Alkolike Total	**682,876**	**738,204**	**55,329**	**8%**
8	Verë Import	352,397	374,887	22,491	6%
9	Verë Prodhim Vendi	51,062	55,093	4,031	8%
	Vere Total	**403,459**	**429,981**	**26,522**	**7%**
10	Kafe	466,143	490,194	24,051	5%
11	Karburante Import	29,958,454	33,435,401	3,476,947	12%
12	Karburante Prodhim Vendi	801,398	814,959	13,562	2%
	Karburante Total	**30,759,852**	**34,250,360**	**3,490,508**	**11%**
13	Gaz i Lëngët	2,042,865	2,107,010	64,145	3%
14	Goma të reja	237,491	282,021	44,530	19%
15	Vaj Lubrifikant	385,415	446,398	60,983	16%

Referuar tabelave mësipër, vihet re një rritje e sasisë së karburanteve dhe cigareve të hedhura për konsum, të cilët janë edhe kontribuesit kryesorë në të ardhurat nga akciza.

Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën rreth 1.9 miliardë LEK, -879 milionë LEK ose rreth -32.2% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe realizim në masën 93.2% kundrejt planit për vitin 2025.

- Të ardhurat nga renta minerare e naftës bruto janë rreth 1.4 miliardë LEK. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto kanë pësuar rënie me rreth -602mln LEK si rezultat i:
  - *rënies së çmimit nga 3.99 LEK/njësi në 3.33 LEK për njësi me efekt -271 milionë LEK si dhe*
  - *rënies së sasisë së eksportuar (me -17%, ose -83,097 ton), me efekt -331 milionë LEK.*
- Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e tjera janë realizuar në vlerën rreth 469 milionë LEK, me rënie rreth -319 milionë LEK ose -40 % nga 12 mujori i vitit 2024. Ky efekt ka ardhur i ndikuar nga
  - *rënia e çmimit për njësi nga 0.42 LEK/njësi në 0.27 LEK/njësi, me efekt -272 milionë LEK si dhe nga rënia e sasisë së eksportuar me -111 mijë ton ose -6%, me efekt në të ardhura -47 milionë LEK.*

Të ardhurat nga taksat doganore janë realizuar në vlerën 9.5 miliardë LEK, +514 milionë LEK ose +5.7% më shumë se viti 2024, si dhe realizim rreth 92.4% kundrejt planit.

ADMINISTRATA TATIMORE

Të ardhurat e Administratës Tatimore (të ardhurat nga TVSH neto në vend, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale, taksat nacionale dhe kontributet e mbledhura nga DPT) për vitin 2025 u realizuan në masën 428.6 miliardë LEK, +45.5 miliardë LEK ose 11.9% më shumë se viti 2024, si dhe 1.6 miliardë LEK, ose 0.4% më shumë se plani i rishikuar për vitin 2025.

Tabela 13 Të ardhurat progresive Administrata Tatimore Janar – Dhjetor 2025

në milionë LEK

Totali i të ardhurave	Progresive Janar - Dhjetor			Dif Fakt Progresive 2025-2024		Dif Progresiv-Fakt-Plan	
	Fakt 2024	Fakt 2025	Plan AN 10/2025	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
Tvsh brenda vendit Neto	59,623	68,519	65,854	8,897	14.9%	2,665	4.0%
Tvsh e arketuar	81,996	93,818	92,531	11,822	14.4%	1,287	1.4%
Rimbursimet	22,374	25,299	26,677	2,925	13.1%	-1,378	-5.2%
Tatimi mbi fitimin	56,995	58,547	60,387	1,552	2.7%	-1,840	-3.0%
Tatimi mbi të ardhurat personale	66,163	82,532	84,212	16,369	24.7%	-1,680	-2.0%
Taksat nacionale	44,685	46,945	45,118	2,260	5.1%	1,827	4.0%
TOTALI TATIME	**227,465**	**256,543**	**255,572**	**29,078**	**12.8%**	**971**	**0.4%**
Kontributet e mbledhura (DPT)	155,612	172,039	171,403	16,427	10.6%	636	0.4%
TOTALI TATIME (përfshirë kontributet DPT)	**383,077**	**428,582**	**426,975**	**45,506**	**11.9%**	**1,607**	**0.4%**

Të ardhurat nga TVSH e arkëtuar (neto) u realizua në masën 68.5 miliardë LEK, 8.9 miliardë LEK ose 14.9% më shumë se viti 2024, dhe me realizim 104% të planit të rishikuar për vitin 2025. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të Tvsh-së brenda vendit krahasuar me vitin 2024 janë:

- *TVSH e rritur si rezultat i mirëadminstrimit tatimor dhe zbatimit të masave të SAA për vitin 2025*
- *Rritja e të ardhurave në të në të gjithë sektorët e ekonomisë.*

Referuar të dhënave të Administratës Tatimore nga fiskalizimi, qarkullimi pa Tvsh (*pa autongarkesën dhe pa borxhin e keq*) për periudhen Janar-Dhjetor 2024 ka qënë 3,840 milardë LEK dhe Janar-Dhjetor 2025 është 4,081 miliardë LEK, pra 241.5 miliardë LEK më shumë. Të gjithë sektorët bazë të ekonomisë kanë rritje në qarkullim në krahasim me vitin 2024, e evidentuar kjo nga rritja e TVSH bruto së deklaruar, e cila sipas të gjithë sektorëve rezulton me rritje në krahasim me 2024:

- *Në sektorin e ndërtimit, TVSH bruto për vitin 2025 është 16.1 miliardë LEK, me një rritje prej 20% ose 2.7 miliardë LEK më shumë;*
- *Në sektorin e prodhimit, TVSH bruto për vitin 2025 është 16.8 miliardë LEK, me një rritje prej 7% ose 1.1 miliardë LEK më shumë;*
- *Në sektorin e shërbimeve, TVSH bruto për vitin 2025 është 28.2 miliardë LEK, me një rritje prej 17% ose 4 miliardë LEK më shumë;*
- *Në sektorin e transportit, TVSH bruto për vitin 2025 është 2.7 miliardë LEK, me një rritje prej 27% ose 577 milionë LEK më shumë;*
- *Në sektorin e tregtisë, TVSH bruto për vitin 2025 është 30.2 miliardë LEK, me një rritje prej 13% ose 3.5 miliardë LEK më shumë.*

Rimbursimet për vitin 2025 janë 25.3 miliardë LEK, 2.9 miliardë LEK ose 13.1% më shumë se viti 2024, si dhe -1.4 miliardë LEK ose -5.2% më pak se plani i rimbursimit të TVSH-së për vitin 2025.

Të ardhurat e mbledhura nga tatimi mbi fitimin për vitin 2025 u realizuan në masën 58.5 miliardë LEK, 1.6 miliardë LEK ose 2.7% më shumë se viti 2024, si dhe -1.8 miliarë LEK ose -3% më pak se plani për vitin 2025 për tatimin mbi fitimin. Nga *analiza e tatimit mbi fitimin sipas sektorëve* rezulton se me përjashtim të sektorit të prodhimit, të gjithë sektorët e tjerë janë me rritje krahasuar me vitin 2024, si vijon:

- *Sektori i Tregtisë me rritje 15% më shumë se viti 2024 ose 2.1 miliardë LEK;*
- *Sektori i Ndërtimit me rritje 14% më shumë se viti 2024 ose 1 miliardë LEK;*
- *Sektori i Shërbimit me rritje 5% më shumë se viti 2024 ose 823 milionë LEK;*
- *Sektori i Transportit me rritje 12% më shumë se viti 2024 ose 275 milionë LEK;*

- *Sektori i Prodhimit me ulje prej -18% më pak se viti 2024 ose -3 miliardë LEK. Duke analizuar nënkategoritë që përfshihen në sektorin e prodhimit, rezulton se të 29 nënsektortë janë me rënie në krahasim me 2024 me -4.7 milirdë LEK, ndërsa tre prej tyre kanë rënie që ndikojnë tek totali me -3.46 miliardë LEK dhe konketisht:*
    - Prodhimi i energjisë elektrike -2.9 miliardë LEK me pak se viti 2024,
    - Transmetimi i energjisë elektrike me -330 milionë LEK më pak se viti 2024, dhe
    - Prodhimi i çimentos me ulje nga viti 2024 me rreth -243 milionë LEK.

Analizuar *sipas parapagimit të kësteve të tatimit mbi fitimin*, rezulton se 4 sektorë të ekonomisë kanë paguar rreth 4.22 miliardë LEK më shumë se në vitin 2024, mirëpo janë rreth- 3 miliardë LEK nga sektori i prodhimit, të cilat ndikojnë që totali i pagesave të jetë vetëm 1.22 miliardë më shumë se 2024.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale për vitin 2025 janë në vlerën 82.5 miliardë LEK, 16.4 miliardë LEK ose 24.7% më shumë se viti 2024, si dhe -1.7 miliardë LEK ose -2% më pak se plani për vitin 2025. Ndikimin kryesor në këtë kategori për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 e kanë zërat kryesorë si:

- *Të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori privat, u realizuan në shumën 31mld LEK, me rritje +26.2% ose 6.4mld LEK më shumë, në sajë të masave të marra nga Administrata Tatimore në sektorë me risk të tillë si turizmi, ndërtimi, etj.*
- *Të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori publik, u realizuan në shumën 18.4mld LEK, me rritje +17.8% ose 2.8mld LEK më shumë, që reflekton reformën e dytë të pagave nga 1 korrik 2024 e në vijim.;*
- *Të ardhurat nga interesat bankarë arritën në 3.8mld LEK, me rritje +12.9% ose 436mln LEK më shumë.*
- *Të ardhurat nga tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme, u realizuan në shumën 7.5mld LEK, me rritje +36% ose 2mld LEK më shumë;*
- *Gjithashtu, krahasuar me vitin 2024, konstatohet rritje me 23.3% e të ardhurave nga tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore.*
- *Të ardhurat nga tatimi mbi qeratë, u realizuan në shumën 5.8 miliardë LEK, me rritje +8.5% ose 454 milionë LEK më shumë në krahasim me vitin 2024,;*

Ndikim në këtë përformancë ka rritja e numrit të kontribuesve në skemë me rreth + 27,420 kontribues më shumë se 9-mujori 2024 (*muaji shtator ofron një pasqyrë më të qartë dhe më të qëndrueshme të numrit të punonjësve, duke qenë se përkon me mbylljen e periudhës sezonit turistik*) dhe deklarimi në rritje i pagës reale për gjithë sektorët, me fokus të veçantë sektori i turizmit dhe ndërtimit, në saj të masave antiinformalitet të ndërmarrë nga administrata tatimore gjatë 2025.

Taksat nacionale për vitin 2025 u realizuan në masën 46.9 miliardë LEK, me +2.3 miliardë LEK ose 5.1% më shumë se viti 2024, si dhe +1.8 miliardë LEK ose 4% më shumë se plani për vitin 2025.


Të ardhurat e mbledhura nga kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për vitin 2025 u realizuan në masën 172 miliardë LEK ose në masën 100.4% të planit. Krahasuar me vitin 2024 janë mbledhur 16.4 miliardë LEK ose 10.6% më shumë. Administrata tatimore mbledh 96% të totalit të të ardhurave nga kontributet, rritja e të cilave u mbështet në:

- *Rritjen e pagave të administratës publike, e shoqëruar kjo dhe me rritjen e fondit të pagave edhe për sektorin privat.*
- *Masat e marra në Stategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të veprimit për vitin 2025, në kuadër të mirëadministrimit tatimor.*
- *Sipas listëpagesave të periudhës, deklaruar në Administratën Tatimore të vitit 2025, rezultojnë rreth 750,747 tatimpagues në listëpagesë, + 27,420 kontribues ose 3.6% më shumë se 9-mujori 2024 (muaji shtator ofron një pasqyrë më të qartë dhe më të qëndrueshme të numrit të punonjësve, duke qenë se përkon me mbylljen e periudhës sezonit turistik).*
- *Për vitin 2025 janë rreth 20,919 biznese të reja të hapura ose 3,009 biznese më shumë se viti 2024.*
- *Numri i biznese aktiv në fund të vitit 2025 është 142,769 biznese, +8,447 biznese aktiv më shumë se viti 2024 ose 6% më shumë.*

5 SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2025, arritën në rreth 801.7 miliardë LEK me një realizim në masën 97.2% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 96.4% të planit vjetor të ndryshuar me Aktin Normativ nr. 11/2025. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 10% më të larta ose rreth 73.1 miliardë LEK më shumë.

Grafiku 12 Shpenzimet e përgjithshme korente dhe kapitale (miliardë LEK) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2026)

5.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike


Struktura e shpenzimeve gjatë vitit 2025 paraqet disa ndryshime në krahasim me planin fillestar, kryesisht si rrjedhojë e rishikimeve të ligjit të buxhetit, të cilat rezultuan në rritjen e shpenzimeve buxhetore prej përkatësisht, rreth 1 miliardë LEK (AN 3/2025) dhe rreth 5.7 miliardë LEK (AN 10/2025) si dhe në rishpërndarjen e 30 miliardë LEK (AN 11/2025) të kursimeve të evidentuara në nivel 11M, mes zërave të shpenzimeve buxhetore korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike në nivel vjetor.

Grafiku 13 Shpenzimet korente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 14 Struktura e shpenzimeve korente, kapitale dhe raporti me PBB ndër vite



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Shpenzimet korente për vitin 2025 rezultuan në rreth 653.5 miliardë LEK ose 99.6% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 97.6% të planit të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe 96.7% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet korente për vitin 2025 rezultuan 7.8% më të larta ose rreth 47.2 miliardë LEK më shumë. Kategoritë kryesore që kanë ndikuar në realizimin e shpenzimeve korente ishin kryesisht:

- ✓ *Shpenzimet për fondet speciale me 102.4% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar (99.1% të planit të ndryshuar me AN nr. 11/2025 dhe të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash).*
- ✓ *Shpenzimet e personelit me 98.3% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar (99.1% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr. 11/2025 dhe 99% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash).*

Shpenzimet korente për vitin 2025 rezultuan në nivelin rreth 24.7% të PBB nominale vjetore, kundrejt një mesatare prej rreth 24.3% të këtij raporti në vitet pararendëse. Krahasuar me 2024, ato rezultuan 7.8% më të larta ose rreth 47.2 miliardë LEK më shumë. Zërat kryesorë që ndikuan në rritjen e tyre për vitin 2025 janë:


- ✓ *Shpenzimet për fondet speciale, të cilat krahasuar me vitin 2024, rezultuan 7.3% më të larta ose rreth 18.5 miliardë LEK më shumë, kushtëzuar kjo nga fondet e akorduara shtesë për indeksimin e pensioneve dhe shpërblimin e pensionistëve në masën 10.8 miliardë LEK.*
- ✓ *Shpenzimet e personelit, të cilat krahasuar me 2024 rezultuan 11.5% më të larta ose rreth 13 miliardë LEK më shumë, kushtëzuar kryesisht nga tavani më i lartë si rredhojë e nivelit më të lartë të pagave, si dhe nga shtesa prej rreth 548 milionë LEK nga përdorimet e Fondit Rezervë në zbatim të VKM-ve përkatëse;*
- ✓ *Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje, të cilat krahasuar me vitin 2024 janë 4.3% më të larta ose rreth 3.5 miliardë LEK më shumë, kushtëzuar kryesisht nga efekti financiar i përdorimit të Fondit Rezervë sipas VKM përkatëse në masën 3.8 miliardë LEK, si dhe nga përdorimi i fondit të veçantë në masën 282 milionë LEK për dhënien e ndihmave e mbështetjeve financiare;*
- ✓ *Shpenzimet për buxhetin vendor, të cilat krahasuar me vitin 2024 janë 18% më të larta ose rreth 13.4 miliardë LEK më shumë.*

Grafiku 15 Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Grafiku 16 Struktura e shpenzimeve korente (milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet e Personelit për vitin 2025, përfaqësuan 19.2% të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 125.7 miliardë LEK, përbën 98.3% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 99.1% të planit të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe 99% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me 2024, ky zë është 11.5% më i lartë ose rreth 13 miliardë LEK më shumë.


Grafiku 17 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Interesa për vitin 2025 kanë arritur nivelin 54.7 miliardë LEK, duke përfaqësuar 8.4% të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 79.8% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 88.6% e planit vjetor sipas AN nr.11/2025 dhe po aq e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024, ky zë ka rezultuar 0.4% më i lartë ose rreth 233 milionë LEK më shumë.


Grafiku 18 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje për vitin 2025 kanë shënuar një realizim në masën rreth 83.7 miliardë LEK ose 110.6% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 97.3% të planit vjetor sipas AN nr.11/2025 dhe 92.8% e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024, ky zë ka rezultuar 4.3% më i lartë ose rreth 3.5 miliardë LEK më shumë.


Grafiku 19 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Subvencione, për vitin 2025 arritën nivelin rreth 2.4 miliardë LEK, me një realizim në masën 121.3% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 132.5% e planit vjetor sipas AN nr.11/2025 dhe 99.6% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Ndërkohë që, krahasuar me vitin 2024 shpenzimet për subvencione rezultojnë 31.8% më të larta ose 570 milionë LEK më shumë, kushtëzuar kjo nga akordimi i fondeve shtesë prej 392 milionë nga fondi rezervë me VKM, me qëllim përballimin e shpenzimeve të Organizimit të Forumit të Investimeve midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor që u zhvillua në Tiranë në datë 13-14 Tetor 2025.

Grafiku 20 Shpenzimet për subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Fondet Speciale për vitin 2025 rezultuan në nivelin rreth 270.3 miliardë LEK, me një realizim prej 102.4% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 99.1% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe po aq e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Përkatësisht*:*


- ✓ *Shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 204.1 miliardë LEK, duke rezultuar 106.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 105.2% e planit vjetor sipas AN nr.11/2025 dhe 99.6% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.*
- ✓ *Shpenzimet për Sigurime Shëndetësore u realizuan në masën rreth 64 miliardë LEK, duke rezultuar 101.3% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 98.5% e planit vjetor sipas AN nr.11/2025 dhe po aq e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.*
- ✓ *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve u realizuan në masën rreth 2.3 miliardë LEK duke rezultuar 76.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, dhe po aq sipas planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.*

Fondi për Indeksimin e Pensioneve i planifikuar në nivelin 1.14 miliardë LEK, është përdorur në masën 100% të tij në zbatim të VKM nr.590/2025 "*Për indeksimin e pensioneve*", si më poshtë:

- *Akorduar për MEI në masën prej 1 111 milionë LEK*
- *Akorduar për MM në masën prej 29 milionë LEK*

Fondi për Bonusin e Pensionistëve, i parashikuar në buxhetin fillestar 2025 në masën 3 750 milionë LEK dhe i shtuar me AN nr.10/2025 në masën 9.7 miliardë LEK, është akorduar zbatim të VKM nr.711/2025 "*Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2025*".

Grafiku 21 Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Shpenzimet për Papunësinë për vitin 2025 janë realizuar në masën 692 milionë LEK ose 86.6% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 90.5% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe 97.9% e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rënie në masën 16.7% ose 139 milionë LEK më pak, në varësi të kërkesave të paraqitura.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për vitin 2025 u realizuan në masën rreth 25.5 miliardë LEK, duke rezultuar 107.5% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 102.2% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe 99.2% e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rënie në masën rreth 5.1% ose 1.4miliardë LEK më pak, kushtëzuar kjo nga rishpërndarja e fondeve të planifikuara në këtë zë drejt programeve të tjera të MSHMS, në varësi të nevojave të periudhës.

Shpenzimet për Kompensimin e Ish-të Përndjekurve Politikë për vitin 2025 u realizuan në masën 1.4 miliardë LEK, duke rezultuar 100% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe po aq sipas planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe e planit vjetor me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024 ,shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje prej 32.2% ose 341 milionë LEK më shumë, kushtëzuar nga ecuria e kënaqshme e përpunimit të dosjeve dhe ekzekutimit të pagesave gjatë 2025.

Shpenzimet për Bonusin e Lindjeve për vitin 2025 u realizuan në masën rreth 1.5 miliardë LEK, duke rezultuar 65.9% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe atij të ndryshuar me AN nr.11/2025, si dhe 100% e planit përfundimtar me ndryshime e shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rënie në masën 32.6% ose 718 milionë LEK më pak, në varësi të kërkesave të paraqitura.

Grafiku 22 Shpenzimet për ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet kapitale për vitin 2025 (*përfshirë Fondin e Rindërtimit*) rezultuan në rreth 131.6 miliardë LEK ose 81% e planit vjetor fillestar dhe 83.8% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Krahasuar me 2024, ky zë është 13.4% më i lartë ose rreth 15.6 miliardë LEK më shumë. Investimet me financim të brendshëm u realizuan në masën 107.3 miliardë LEK kundrejt planit prej 114.2 miliardë lekë ose rreth 17.8 miliardë LEK më shumë se 2024. Investimet me financim të huaj u realizuan në masën 20.3 miliardë LEK ose 46.6% e planit vjetor fillestar (*56.2% e planit sipas AN nr.11/2025*) ose rreth 2.9 miliardë LEK më shumë se 2024.

- *Investimet me financim të brendshëm (përfshirë investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë, transferimet kapitale dhe fondi i rindërtimit) u realizuan në masën rreth 111.3 miliardë LEK, duke rezultuar 93.7% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 92.6% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Krahasuar me 2024, ky zë rezulton 12.9% më i lartë ose rreth 12.7 miliardë LEK më shumë, kryesisht si rrjedhojë e shpenzimeve kapitale të realizuara në fushën e infrastrukturës rrugore, ajrore, energjitike dhe në programe zhvillimore sa i përket zonave me potencial turistik.*
  - *Nga këto, shpenzimet faktike për Rindërtimin rezultuan në 3.2 miliardë LEK ose 63.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.11/2025. Krahasuar me 2024, ato rezultuan 61.8% më të ulëta ose rreth 5.1 miliardë LEK më pak, si pasojë e përfundimit të një pjese të konsiderueshme të investimeve në vitet e mëparshme dhe kalimit të procesit në fazën përfundimtare.*
- *Investimet me financim të huaj shënuan realizim faktik në masën 20.3 miliardë LEK, duke rezultuar 46.6% e planit vjetor fillestar ose 56.2% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Krahasuar me 2024, ky zë rezulton 16.5% më i lartë ose rreth 2.9 miliardë LEK më shumë, kryesisht si rrjedhojë e investimeve publike në fushën e transportit hekurudhor dhe në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.*

Grafiku 23 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fusha të rëndësishme të ekonomisë. Prioritetet e buxhetit 2025 për shpenzimet kapitale ishin kryesisht në fushën e: infrastrukturës, ujësjellës-kanalizimeve, transporti rrugor, shëndetësisë, mbrojtjes, etj. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm. Në përgjithësi ecuria e realizimit të shpenzimeve kapitale ka vijuar pa problematika thelbësore që ndikojnë qëndrueshmërinë financiare të buxhetit. Problematikë për vitin 2025 ishte realizimi i projekteve me financim të huaj, kryesisht projekte të financuara me grant. Për pasojë, Qeveria, nëpërmjet tre akteve normative, ndërmori rishikimin në ulje të tavaneve buxhetore të Financimit të Huaj për institucionet përkatëse.

Me buxhetin e vitit 2025, janë **financuar dhe mbyllur** rreth 280 projekte të rëndësishme me financim të brendshëm, me vlerë të plotë projektesh me rreth 51.4mld LEK, ndër të cilat vlen të përmendet se:

- ✓ *Janë mbyllur 21 projekte investimi të transportit rrugor me vlerë totale rreth 23.1 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 81 projekte investimi për ujësjellësa dhe kanalizime me vlerë totale rreth 16.1 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 73 projekte të rëndësishme për rikonstruksione/ndërtime shkollash, universitetesh dhe ambientesh, për përmirësimin e sistemeve të informacionit për Arsimin e Lartë, me vlerë totale 4mld LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 14 projekte investimi për sisteme armatimi, ndërtim depo për pajisjet e kërkim shpëtimit, për përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, municion për anijet, për software për bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësi Natyrore me vlerë totale 2.7 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 8 projekte për rikonstruksione të ambienteve në disa spitale dhe poliklinika, qendra shëndetësore, furnizim dhe vendosje pajisjesh spitalore etj me vlerë totale projektesh prej 2.3mld LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 28 projekte investimi për përmirësimin e kanaleve ujitëse në disa zona, ndërtimi i argjinaturave të lumenjve dhe mbrojtja prej tyre, etj me vlerë totale rreth 1.4 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 4 projekte për përshtatje mjedisesh pune në drejtoritë vendore të Policisë, janë blerë paisje, me vlerë totale projektesh prej 0.6 miliardë LEK.*
- ✓ *Në fushën e politikës së jashtme, janë mbyllur 2 projekte me vlerë totale rreth 0.57 miliardë LEK.*
- ✓ *Në fushën e strehimit social kanë përfunduar 17 projekte në bashkitë: Delvinë, Librazhd, Vau i Dejës, Selenicë, Dimal, Roskovec, Vlorë, Memaliaj, Gramsh, Mat, Dropul, Fier, Kolonjë, Sarandë, Rrogozhinë, Pogradec, Shkodër me vlerë totale projektesh prej 0.11 miliardë LEK*
- ✓ *Etj.*

5.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale

Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet faktike buxhetore është 'Mbrojtja sociale', me 30 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2025, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve si edhe programet në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë (*ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar*). Ndërkohë, Shëndetësia dhe Arsimi përbëjnë 10 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2025; Çështjet Ekonomike përbëjnë përkatësisht 14 përqind; Strehimi përbën 7 përqind; Shpenzimet e përgjithshme publike, përbëjnë 17 përqind të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2025.

Tabela 14 Shpenzimet sipas funksionit, me dhe pa shpërndarjen e të pa klasifikuarave (në milionë LEK)

Nr	Emertimi	Plani fillestar 2025 miratuar me Ligjin e Buxhetit	Plani fillestar në % ndaj totalit	Plani fillestar i korrigjuar (pas shpërndarjes së shpenzimeve	Plani fillestar i korrigjuar në % ndaj totalit	Fakti 2025	Fakti në % ndaj totalit	Fakti 2025 (në % të planit fillestar të korrigjuar)
01	Shërbimet e Përgjithshme Publike	57,673	7%	154,679	19%	134,363	17%	87%
02	Mbrojtja	37,167	5%	37,474	5%	27,011	3%	72%
03	Rendi dhe Siguria Publike	50,304	6%	54,676	7%	51,760	6%	95%
04	Çështjet Ekonomike	78,820	10%	102,386	12%	112,153	14%	110%
05	Mbrojtja e Mjedisit	1,238	0%	7,801	1%	8,643	1%	111%
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	36,432	4%	54,759	7%	53,018	7%	97%
07	Shëndetësia	75,863	9%	76,165	9%	76,637	10%	101%
08	Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare	6,394	1%	11,842	1%	13,215	2%	112%
09	Arsimi	66,667	8%	85,153	10%	83,949	10%	99%
10	Mbrojtja Sociale	228,335	28%	240,153	29%	240,946	30%	100%
	Te paklasifikuara *	186,195	23%					
	TOTALI	**825,088**	**100%**	**825,088**	**100%**	**801,695**	**100%**	**97%**

** Ne zerin "Shpenzime te tjera te paklasifikuara", miratuar me Ligjin e Buxhetit Fillestar jane përfshirë: (i) pagesat për shërbimin e borxhit, (ii) kontigjenca për politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezervë, (iv) shpenzimet e pushtetit vendor dhe (v) fondi i rindërtimit.*

Plani fillestar i vitit 2025 kishte parashikuar po këto nivele, pak a shumë të ngjashme, të peshave relative të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional, kundrejt një viti më parë. Në shmangien e vërejtur kundrejt rezultatit faktik 2025, ka ndikuar ndryshimi i planit gjatë vitit 2025 me Aktet Normative. Në çdo rast, rezultati faktik i korrigjuar tregon nivele të kënaqshme të realizimit të planit sipas funksioneve për vitin 2025.

5.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2025

Gjatë vitit 2025, buxheti i shtetit u ndryshua me 4 Akte Normative dhe specifikisht:

1) **Akti Normativ Nr.3 datë 29.04.2025** *"Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025":*

Aspekti i nevojës dhe urgjencës së këtij akti normativ lidhej me nevojën e reflektimit në ligjin e buxhetit vjetor të vitit 2025 të alokimit në programin e MEKI "*Mbështetje për Inovacionin dhe Teknologjinë*" të fondit në masën 1 miliardë LEK (10 milionë USD) për financimin e pjesëmarrjes së Qeverisë shqiptare në startup-in "*Machine Thinking Lab*". Ky startup është një nga projektet më inovative në nivel global në fushën e AI (inteligjencës artificiale), me potencial të madh për avancim teknologjik dhe të ardhura ekonomike për vendin, duke ofruar përfitime strategjike për Shqipërinë. Ky efekt financiar u mbulua nga rritja në të njëjtën masë prej 1 miliardë LEK i të ardhurave jotatimore në zërin "*Të ardhura nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara*".

2) Akti Normativ Nr.6 datë 11.06.2025 "*Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025, i ndryshuar*":

Qeveria pas vlerësimit të ecurisë së treguesve fiskalë përgjatë periudhës 5 mujore të vitit 2025, ndërmori procesin e rishikimit të dytë të buxhetit për vitin 2025, që pati për qëllim reflektimin në buxhetin vjetor të disa rishikimeve në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, me synim përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2025. Ky Akt Normativ parashikoi një volum të përgjithshëm të fondeve që alokohen/rialokohen, prej rreth 11.8 miliardë LEK, të cilat konsistuan në:

- *Rialokim të kursimeve të evidentuara gjatë 5M 2025, në shpenzime korente e kapitale, dhe akomodimin e tyre drejt një sërë kërkesave shtesë prioritare, në të njëjtën vlerë.*
- *Reflektimin e disa sistemimeve dhe rishpërndarjeve të brendshme të fondeve mes programeve e llogarive ekonomike, me efekt neutral buxhetor, ku vendin kryesor e zunë projektet IT të transferuara tek AKSHI.*
- *Miratimin e një skeme të re Garancie Sovrane për sektorin e Bujqësisë, për një vlerë rreth 3miliardë LEK. Nga analiza fiskale rezultoi se kjo politikë respektoi kufizimet e rregullave fiskale në fuqi, pa cënuar disiplinën buxhetore*
- *Defiçiti buxhetor, pas ndryshimeve të mësipërme në të ardhura dhe shpenzime, mbeti i pandryshuar në nivelin 68 052 milionë LEK, si rrjedhim edhe borxhi publik nuk ndryshon.*

Sipas këtij Akti Normativ:

- Të ardhurat e përgjithshme nuk ndryshuan.
- Totali i shpenzimeve të përgjithshme nuk ndryshoi, pasi u mbulua me kursimet e evidentuara. Ndër alokimet shtesë më kryesore, veçojmë:
  - *AKSK – Rreth 3.3miliardë LEK shtesë për produkte teknologjike IA për sigurinë kibernetike.*
  - *FSHZH – Rreth 1.5miliardë LEK shtesë për projekte të reja zhvillimi.*
  - *MAS – Rreth 318milionë LEK shtesë për programin e Sportit.*
  - *MD – Rreth 142milionë LEK shtesë për detyrimin e rikonstruksionit të godinës së Inst.Mjekësisë Ligjore.*
  - *MF – Rreth 103milionë LEK shtesë për pagesat e kuotave ndaj IBRD, IFC dhe AIF.*
  - *MSHMS – Rreth 64mln LEK shtesë për blerjen e pajisjeve mjekësore për strukturat spitalore në vend.*
  - *Ministria e Brendshme – Rreth 67milionë LEK për nevoja page të Gjendjes Civile dhe 14.2milionë LEK për 22 punonjës shtesë të AAPSK.*
  - *DSHQ – Rreth 92milionë LEK shtesë për rikonstruksionin e Vilës Qeveritare në Dajt.*
  - *Inspektoriati Qendror - Rreth 70mln LEK për 77 punonjës shtesë sipas strukturës në proçes miratimi.*

Ndërkohë, rishpërndarje fondesh me efekt neutral patën këto institucione:

- *Ministria e Mbrojtjes – Në masën 1.27 miliardë LEK, nga zërat e shpenzimeve kapitale drejt atyre korente, kryesisht për mbulimin e detyrimeve për paga e sigurime.*
- *Ministria e Arsimit dhe Sportit – Në masën 1.05 miliardë LEK mes programeve të veta buxhetore, kryesisht për finacimin e shpenzimeve të personelit të arsimit bazë.*
- *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Në masën 830 milionë LEK mes programeve buxhetore, kryesisht për nevoja të FSDKSH dhe financim projektesh.*

3) Akti Normativ nr. 10 datë 8.10.2025 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025, të ndryshuar*".

Në vijim të zgjedhjeve të përgjithshme të datës 11 Maj 2025 dhe ndryshimeve në Kabinetin e ri të Këshillit të Ministrave, u rishikuan edhe fushat e përgjegjësisë funksionale të ministrive të linjës. Në këto kushte, lindi nevoja imediate për rishikimin sa më parë të ligjit të buxhetit 2025, me fokus kryesor rishpërndarjen e fondeve buxhetore sipas riorganizimit të ri të ministrive të sipërcituara. Pas analizimit të performancës 8 mujore të ecurisë së zbatimit të treguesve të konsoliduar makrofiskal dhe buxhetor, si edhe vlerësimit të pritshmërive të realizimit të tyre deri në fund të vitit, Qeveria përgatiti skenarin e rishikimit të tretë të buxhetit për vitin 2025, nëpërmjet paraqitjes së Aktit Normativ i cili siguroi:

- *Rritjen e nivelit të planifikuar të të ardhurave të përgjithshme me 12.1 miliardë LEK.*
- *Rritjen e shpenzimeve të përgjithshme me rreth 5.7 miliardë LEK.*
- *Përditësimin e zërave të borxhit shtetëror.*
- *Uljen e defiçitit buxhetor në nivelin 61.6 miliardë LEK ose 2.4% e PBB, nga 2.6% e PBB të miratuar në buxhetin fillestar 2025.*

Në shpenzimet **korente** ndër alokimet kryesore, veçojmë:

- *Skema e Pensioneve – Rreth 7.6 miliardë LEK shtesë, nga të cilat 1.7 miliardë LEK rritje e tavanit të shpenzimeve 2025 dhe 5.9 miliardë LEK për fondin e dedikuar bonusit të fundvitit.*
- *AKSHI – Rreth 1.2 miliardë LEK shtesë për mbulimin e shërbimeve nga Microsoft, platformave AI, mirëmbajtjes së rrjeteve IT të institucioneve, etj.*
- *MPB – Rreth 648 milionë LEK shtesë për nevoja të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Gjendjes Civile dhe Prefekturave.*
- *Ministria e Arsimit – Rreth 329 milionë LEK shtesë, financim i mangësive në shp.personeli e tekste falas;*
- *MD – Rreth 152 milionë LEK shtesë për nevoja të Burgjeve dhe detyrime vendimesh gjyqësore.*
- *MEI dhe MTKS – Rishpërndarja e fondeve pas riformatimit të strukturës programore të tyre, si dhe akomodimi i disa nevojave për fonde shtesë në këtë drejtim.*

Shpenzimet **kapitale me financim të brendshëm** u rritën me 7.97mld LEK, ku ndër alokimet kryesore, veçojmë:

- *MIE – Rreth 6 miliardë LEK shtesë për avancimin e projekteve të ndryshme,*
- *AKSHI – Rreth 1.6 miliardë LEK shtesë për sisteme kompjuterike, në kuadër të projektit me Bankën Botërore dhe projekteve me kompaninë Oracle.*
- *SHISH – Rreth 555.5 milionë LEK shtesë për blerje sistemesh/softuerësh.*
- *MB – Rreth 468 milionë LEK për nevojat e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës,*
- *MD – Rreth 400 milionë LEK shtesë për avancimin e financimit nga vitet 2026 për projektin e Institutit të të Miturve në Konflikt me Ligjin.*
- *MBZHR – Rreth 300 milionë LEK shtesë për avancimin e projekteve të miratuara për bashkitë në programin Ujitja dhe Kullimi.*

Shpenzimet **kapitale me financim të huaj** u ulën me 2 miliardë LEK, nga të cilat 1 miliardë LEK nga reduktimi i fondeve për "Growth Plan" meqenëse nuk ishte finalizuar detajimi i projekteve me BE.

Sa i takon buxhetit të **Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**, ky rishikim materializoi:

- *Rritjen me 200 milionë LEK të pjesës së taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor.*
- *Rritjen me 154.6 milionë LEK të transfertës së pakushtëzuar sektoriale për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.*
- *Rritjen me 75 milionë LEK si transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme për disa NJVQV që nuk kanë realizuar mjaftueshëm nivelin e të ardhurave.*
- *Rritjen me 44 milionë LEK si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet: i) arsim parashkollor dhe ii) mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi. Këto fonde shtohen për disa bashki, në funksion të plotësimit të standarteve kombëtare për këto shërbime.*
- *Pakësimin në masën 473.6 milionë LEK të financimit të huaj vendor, për shkak të mos realizimit të plotë deri në këtë periudhë.*

4) Akti Normativ nr.11 datë 19.12.2025 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025, të ndryshuar".*

Pas vlerësimit 11 mujor dhe pritshmërive në nivel vjetor të treguesve fiskalë, Qeveria përgatiti skenarin e rishikimit të fundit të buxhetit 2025, i cili synon:

- *Mbajtjen të pandryshuar të të ardhurave buxhetore në nivel total.*
- *Rishpërndarjen me efekt neutral në defiçit të rreth 30 miliardë LEK kursimeve të evidentuara në nivel 11M, mes zërave të shpenzimeve buxhetore korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike në nivel vjetor.*
- *Ruajtjen të pandryshuar të defiçitit buxhetor 2025, në nivelin e planifikuar 61.64miliardë LEK.*

Me këtë Akt Normativ, shpenzimet e përgjithshme nuk pësuan ndryshime të nivelit total të planifikuar të tyre, duke reflektuar vetëm rialokime mes zërave me efekt neutral, të cilat konsistojnë në këto drejtime kryesore:

Shpenzimet **korente** shtohen me 6.9 miliardë LEK, ku ndër alokimet kryesore veçojmë:

- *Mbështetjen financiare të disa kategorive më vulnerabël në masën 15.000 LEK për rreth 148.500 përfitues të kategorive sociale në NE/PAK, me një efekt financiar prej 2.23mld LEK.*
- *Financimin shtesë për Fermerët në masën 2.3 miliardë LEK.*
- *Rishpërndarjen e kursimeve të veta të MSHMS në masën 1.76 miliardë LEK.*
- *Shtesën e fondeve në masën 1.6 miliardë LEK për MIE, për financimin e detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes rrugore, krahas vendimeve gjyqësore të shpronësimeve.*
- *Shtesën e fondeve në masën 1.3 miliardë LEK për Ministrinë e Brendshme, kryesisht përmbulimin e shpenzimeve të Policisë së Shtetit për kompensimin ushqimor, orë jashtëorarit/dieta/karburant në kuadër të sezonit intensiv turistik, krahas shlyerjes së detyrimeve nga vendimet gjyqësore të IKMT.*
- *Shtesën e fondeve në masën 847 milionë LEK për MTKS, kryesisht me qëllim financimin e programit të Sportit referuar organizimit të aktiviteteve me karakter kombëtar e ndërkombëtar.*
- *Shtesën e fondeve në masën 626 milionë LEK për Ministrinë e Mbrojtjes, kryesisht përmbulimin e detyrimeve financiare ndaj NATO-s dhe misioneve ushtarake jashtë vendit.*
- *Përcaktimin për transferimin e të gjitha fondeve të papërdorura në mbyllje të buxhetit 2025, në llogarinë e mbështetjes së pensionistëve në Bankën e Shqipërise, që përdoret me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

Shpenzimet **kapitale me Financim të Brendshëm** u ulën me rreth 3 miliardë LEK. Gjithashtu, janë bërë rishpërndarje fondesh me efekt neutral në shpenzime kapitale ku ndër alokimet shtesë përmendim:

- *MIE – Alokimi i rreth 10 miliardë LEK shtesë synon avancimin e projekteve me performancë të mirë.*
- *MF – Alokimi i 1miliardë LEK shtesë për financimin e kapitalit të Bankës Shqiptare të Zhvillimit.*
- *MEPJ – Shtesë rreth 551 milionë LEK, kryesisht për blerjen e Selisë Diplomatike në Londër.*
- *MD – Alokimi i rreth 200 milionë LEK shtesë për projektin e Institutit të të Miturve në Konflikt me Ligjin.*

Shpenzimet **kapitale me Financim të Huaj** u ulën me 1.98 miliardë LEK, si rezultat i rishikimit të ritmeve të zbatimit të disa projekteve të financuara nga burime të huaja, vonesave në disbursimet e kredive dhe granteve, si dhe përshtatjes së planeve të investimeve me kapacitetet reale të zbatimit gjatë vitit buxhetor.

Për buxhetin e **Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**, ky rishikim materializoi**:**

- *Alokimin e 1.2 miliardë LEK shtesë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore.*
- *Uljen me 256 milionë LEK të financimit të huaj vendor, për shkak të mosrealizimit.*
- *Rritjen me 56 milionë LEK për pjesën e taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor.*

5.4 Rishpërndarja e fondeve buxhetore me VKM

Gjatë vitit 2025 është miratuar vetëm 1 VKM për rishpërndarje fondesh buxhetore dhe konkretisht: VKM nr.683 datë 12.11.2025 *"Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2025",* e cila pati për qëllim mbulimin e nevojave për furnizimin me medikamente të QSUT.

Tabela 15 Rishpërndarje fondesh buxhetore me VKM (në 000/LEK)

Nr.	Emertimi I Min/Inst	Kodi	VKM/ PROGRAMI	Emërtimi i VKM/Programit	Shuma Artikulli 604
1	MSHMS	13	Nr.683 datë 12.11.2025	*"Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2025"*	
			Programi 07220	*"Shërbimet e Kujdesit Parësor".*	-200,000
			Programi 07330	*"Shërbimet e Kujdesit Dytësor".*	200,000

5.5 Rezervat dhe Kontigjencat

Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit i planifikuar në ligjin fillestar 2025 për 6.7 miliardë LEK nga i cili: 3 miliardë LEK për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme; 2.5 miliardë LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve të përgjithshme; 1.2 miliardë LEK për t'u përdorur për projekte/aktivitete të njësive të qeverisjes qendrore në kuadër të planit të rritjes me Bashkimin Evropian me VKM. Ky fond është rishikuar me aktet normative të miratuara në vitin 2025 dhe konkretisht:

- **Akti Normativ nr.6/2025:**
  - *Rriti vlerën e planifikuar të fondit rezervë për raste të paparashikuara me 1.2miliardë LEK, duke e cuar nivelin ligjor në 4.2 miliardë LEK.*
  - *Mban të pandryshuar fondin prej 2.5 miliardë LEK për përballimin e kostove për zgjedhjet.*
  - *Pakëson fondin 1.2 miliardë LEK për projekte/aktivitete të njësive të qeverisjes qendrore në kuadër të planit të rritjes me Bashkimin Evropian.*

- **Akti Normativ nr.10/2025:**
  - *Uli vlerën e planifikuar të fondit rezervë për raste të paparashikuara në nivelin 2.9miliardë LEK.*
  - *Mban të pandryshuar fondin prej 2.5 miliardë LEK për përballimin e kostove për zgjedhjet.*

Gjatë vitit 2025 rezultoi se **Fondi Rezervë për raste të paparashikuara** të njësive të qeverisjes së përgjithshme prej 2.9 miliardë LEK është përdorur në masën rreth 2 430 milionë LEK, nga të cilat:

- *Rreth 2mld LEK ose 69.1% e planit për shpenzime operative dhe transferta të brendshme/ jashtme.*
- *Rreth 326.4 milionë LEK ose 11.3% e planit për shpenzime personeli.*
- *Rreth 98.6 milionë LEK ose 3.4% e planit, janë akorduar për shpenzime kapitale.*

Fondi Rezervë "*Për përballimin e kostos së zgjedhjeve të përgjithshme për vitin 2025*" i planifikuar në masën 2.5 miliardë LEKsh, është akorduar për KQZ përmes VKM nr.47 datë 22.01.2025 "*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ, për organizimin e zgjedhjeve në Kuvend të dt. 11 Maj 2025*".

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit i planifikuar në masën 5.85 miliardë LEK, deri më datë 31.12.2025 rezultoi i papërdorur.

Në mënyrë të detajuar, fondet e akorduara si mësipër cituar paraqiten në **Aneksin ç) *"Tabela analitike e përdorimit të Fondit Rezervë dhe Kontigjencave 2025"***.

Fondi për Indeksimin e Pensioneve, i planifikuar në nivelin 1.14 miliardë LEK është përdorur në masën 100% të tij, në zbatim të VKM nr.590/2025 "*Për indeksimin e pensioneve*", si më poshtë:

- *Për MEI në masën prej 1 111 milionë LEK*
- *Për MM në masën prej 29 milionë LEK*

Fondi për Bonusin e Pensionistëve, i parashikuar në buxhetin fillestar 2025 në masën 3 750 milionë LEK dhe i shtuar me AN nr.10/2025 në masën 9.7 miliardë LEK, u akordua në zbatim të VKM nr.711/2025 "*Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2025*".

5.6 Programi i Rindërtimit

Një paketë e veçantë ligjore që vijoi tërmetin shkatërrues të nëntorit 2019 përcaktoi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e rindërtimit, si dhe mënyrën e financimit dhe procedurat përkatëse. Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim të ngushtë më Komisionin Shtëtëror të Rindërtimit, u caktuan si autoriteti përgjegjës për propozimin dhe bashkërendimin e programit. Me Aktin Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 u krijua dhe Fondi i Rindërtimit, i cili konsiston në:

- *Një program të veçantë të buxhetit të shtetit, me të ardhura nga buxheti i shtetit dhe donatorë dhe*
- *Kontribute në natyrë nga donatorë*

Fondi i Rindërtimit shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me vendimet përkatëse. Detajimi i tij u krye në përputhje me ecurinë e procedurave të ndërlikuara të identifikimit dhe vlerësimit të dëmeve; verifikimit të kërkesave për dëmshpërblime dhe projektimit e zbatimit të investimeve publike.

Fondi i Rindërtimit për vitin 2025 u planifikua në masën 5 miliardë LEK, ku në nenin 7 të Ligjit nr.115/2024 "*Për buxhetin e vitit 2025"* të ndryshuar, është përcaktuar se:

"Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 5 miliardë LEK përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja. Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji. Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji".

Deri në datën 31.12.2025, Fondi i Rindërtimit 2025 prej 5 miliardë LEK, rezulton i përdorur me VKM në masën 36%, dhe konkretisht:

- ✓ *1 544 milionë LEK të akorduara për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.*
- ✓ *189.5 milionë LEK të akorduara për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.*

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) deri në 31 dhjetor 2025 u akorduan fonde në projekte specifike në masën 1.5miliardë LEK dhe 7.3miliardë LEK janë trashëguar në buxhetin 2025, si fonde të papërdorura nga viti 2024. Nga këto, u shpenzuan nga njësitë zbatuese 3.1miliardë LEK ose 35.2% e fondeve të akorduara, dhe diferenca është mbartur në buxhetin 2026 në formën e transfertës së pakushtëzuar për NJVQV, në përputhje me parashikimet. Realizimi i fondit të Rindërtimit për vitin 2025, sipas akordimeve me VKM dhe pjesës së trashëgimit, përçdo NJVQV, në trend zbritës rezultoi si mëposhtë:

- ✓ *Bashkia Kavajë ka realizuar 421.8 milionë LEK nga 636.5 milionë LEK ose 66%,*
- ✓ *Bashkia Kamëz ka realizuar 119.4 milionë LEK nga 261.5 milionë LEK ose 46%,*
- ✓ *Bashkia Mirditë ka realizuar 72.3 milionë LEK nga 164.8 milionë LEK ose 44%,*
- ✓ *Bashkia Krujë ka realizuar 487.6 milionë LEK nga 1.2 miliardë LEK ose 40%,*
- ✓ *Bashkia Vorë ka realizuar 110.3 milionë LEK nga 335.6 milionë LEK ose 33%.*
- ✓ *Bashkia Durrës ka realizuar 407 milionë LEK nga 1.4 miliardë LEK ose 28%,*
- ✓ *Bashkia Kurbin ka realizuar 263.1 milionë LEK nga 944 milionë LEK ose 28%,*
- ✓ *Bashkia Tiranë ka realizuar 1 miliardë LEK nga 2.9 miliardë LEK ose 37%,*
- ✓ *Bashkia Shijak ka realizuar 84.9 milionë LEK nga 436.7 milionë LEK ose 19%,*
- ✓ *Bashkia Rrogozhinë ka realizuar 56.4 milionë LEK nga 302.6 milionë LEK ose 19%,*
- ✓ *Bashkia Lezhë ka realizuar 22.2 milionë LEK nga 181.9 milionë LEK ose 12%,*

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e qeverisjes qendrore (NJQQ) deri në 31 dhjetor 2025, u akorduan fonde në projekte specifike në masën 189.5mln LEK, nga të cilat u realizuan 26.9mln LEK ose 14.2%, dhe konkretisht:

- ✓ *FSHZH shpenzoi 23.2 milionë LEK, nga 185.9 milionë LEK të akorduara ose në në masën 12.5% të planit.*
- ✓ *Ministria e Brendshme shpenzoi 100% të planit të akorduar prej rreth 3.69 milionë LEK.*

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në **Aneksin b) "*Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2025*"**.

6 BUXHETI VENDOR

Gjatë vitit 2025 është evidentuar një performancë pozitive e financave të pushtetit vendor. Të ardhurat e veta vendore arritën në vlerën rreth 1.55% të PBB, ndërkohë që shpenzimet faktike të pushtetit vendor arritën në rreth 3.32% të PBB, duke reflektuar rolin dhe kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në buxhetin e vitit 2025, Ministria e Financave ka ndjekur me prioritet konsolidimin financiar të qeverisjes së përgjithshme, ku buxheti vendor zë një rol të rëndësishëm. Qëndrueshmëria në ofrimin e shërbimeve publike, konsolidimi i procesit të decentralizimit dhe vijimi i reformave të modernizimit përbëjnë aspekte kyçe të vizionit për forcimin e rolit të pushtetit vendor në qeverisje. Për realizimin e këtyre objektivave, Ministria e Financave ka vendosur theksin në nxitjen e rritjes së investimeve vendore, digjitalizimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe forcimin e burimeve të të ardhurave të veta vendore.

Në raport me PBB në vitin 2025 konsolidimi i buxhetit vendor arriti 3.32%, kurse në raport me shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit, buxheti vendor arriti rreth 11%, që tregon qartazi potencialin në rritje të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve. Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore është rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë vitit 2025, të ardhurat e veta të pushtetit vendor në raport me planin fillestar u realizuaan në 100.3%, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive vendore për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve me burimet e veta.

Disa prej treguesve më të rëndësishëm gjatë vitit 2025, që mbështetën përmirësimin në proceset e menaxhimit të financave vendore, paraqiten si më poshtë:

- *Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale) nga 38.4miliardë LEK në vitin 2024, në rreth 44.6mld LEK në 2025 që do të thotë rreth 16.2% më shumë se një vit më parë nga pushteti qendror, në terma nominalë.*
- *Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet rritjes së peshës së të ardhurave të veta vendore në burimet e financimit vendor. Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në tërësi në vitin 2025 kanë treguar stabilitet duke ecur në përputhje me pritshmëritë dhe parashikimin sipas kuadrit makroekonomik. Në krahasim me vitin 2024 të ardhurat tatimore kanë pësuar një rritje të moderuar me rreth 580 milionë LEK;*
- *Akordimi në buxhetin e vitit 2025 për njësitë e vetëqeverisjes vendore, së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme prej 1.2 miliardë LEK për shlyerjen e detyrimeve, sipas Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar", për të mbështetur bashkitë për shlyerjen/uljen e detyrimeve të prapambetura si dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve;*
- *Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale për bashkitë në vlerën 1 641.3 milionë LEK;*
- *Mbështetja e dhënë nga buxheti qendror me ligjin e buxhetit vjetor, për pushtetin vendor në formën e transfertës së pakushtëzuar për mbulimin e rritjes së pagave në masën 3.5 miliardë LEK.*
- *Ka vazhduar reforma e iniciuar në taksën e pasurisë, si një taksë e rëndësishme në të ardhurat e veta vendore, reflektuar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë, e cila vazhdon e stabilizuar me tendencë rritëse edhe në vitin 2025.*

Nga analiza e treguesve financiarë të pushtetit vendor gjatë 2025, evidentojmë arritjet kryesore si më poshtë:


- *Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2025, një tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.*
- *Konsolidimi i procedurave të buxhetimit dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i PBA tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të NJVQV, në përputhje me standardet ndërkombëtare;*
- *Zbatimi i metodologjisë për hartimin e PBA në nivel produkti buxhetor; Përdorimi i Sistemit SMBV-Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor në përgatitjen e PBA dhhe raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit vendore nga të gjitha NJVQV-të;*
- *Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;*
- *Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;*

- *Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor "Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore";*
- *Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me NJVQV në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.*
- *Detyrimet e prapambetura paraqiten me një përmirësim për vitin 2025, me një ulje prej 326 milionë LEK nga viti 2024. Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur dhe monitoruar procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të përformacës së NJVQV. Në vitin 2025 Ministria e Financave ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për vitin 2024 për 61 bashkitë dhe 12 qarqet, ku ka rezultuar se 4 njësi vendore (1 qark dhe 3 bashki) kanë qenë në vështirësi financiare; 6 njësi vendore (1 qark dhe 5 bashki) me probleme financiare; 50 njësi vendore (3 qarqe dhe 47 bashki) pa probleme financiare dhe 13 nësi vendore (7 qarqe dhe 6 bashki) me situatë të mirë financiare (me zero detyrime të prapambetura). Në këtë drejtim, janë përgatitur raporte periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor. Gjithashtu, është monitoruar periodikisht edhe plani i shlyerjes së detyrimeve për bashkitë me vështirësi financiare për daljen nga kjo situatë. Ministria e Financave do të vijojë në vitin 2026, me publikimin e raportit për vlerësimin e gjendjes financiare të NJVQV-ve për vitin 2025, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.*

6.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore

Rritja e të ardhurave nga burimet e veta të NJVQV është synim i menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe një nga shtyllat më të rëndësishme të decentralizimit fiskal. Megjithatë NJVQV -të, përveç të ardhurave nga burimet e veta, përfitojnë gjithashtu të ardhura në formën e transfertave nga qeveria qendrore, ku rolin më të rëndësishëm e zë transferta e pakushtëzuar e përgjithshme, që përbën një burim konstant dhe të qëndrueshëm për pushtetin vendor në masën jo më pak se 1% e PBB. Për vitin 2025 transferta e pakushtëzuar e përgjithshme zë 1.04% të PBB, me një rritje prej 6.6% kundrejt vitit 2024, që do të thotë drejtëpërdrejt më shumë financim për NJVQV-të. Të dhënat në vlera dhe trendi i ecurisë së saj në vite, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 24 Transferta e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Sa i përket të ardhurave e veta vendore të klasifikuara sipas natyrës së burimit të tyre (tatimore dhe jotatimore) për vitin 2025, këto burime kanë vazhduar trendin e një viti më parë. Për vitin 2025, NJVQV në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 40 911 milionë LEK, shifër kjo që është rreth 580 milionë LEK më shumë ose rreth 1.4% më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2024 (40 331 milionë LEK).

Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore vendore, për vitin 2025 janë mbledhur rreth 3 935 milionë LEK nga ky burim ose rreth 216 milionë LEK më pak se vlera e të ardhurave jotatimore mbledhur gjatë vitit 2024. Në total, pushteti vendor ka mbledhur të ardhura të veta rreth 364 milionë LEK më shumë në vitin 2025, kundrejt një viti më parë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e realizmit të këtyre burimeve gjatë viteve 2019-2025:


Grafiku 25 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Të ardhurat e pushtetit vendor në vitet e fundit kanë ruajtur një trend rritjeje, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura, një konfirmim ky i efekteve pozitive të decentralizimit pavarësisht sfidave. Nga viti 2015 e në vazhdim, me përjashtim të vitit 2020, të ardhurat tatimore të pushtetit vendor kanë ruajtur tendencën pozitive duke provuar në këtë mënyrë që roli i pushtetit vendor në potencialin fiskal për të ofruar shërbime të rritet ndjeshëm. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite për të ardhurat tatimore të pushtetit vendor, rezultati paraqitet në grafikun si më poshtë:


Grafiku 26 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Në të njëjtën kohë, kjo rritje e të ardhurave të pushtetit vendor ka bërë që raporti i tyre kundrejt totalit të të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto të ndryshojë dhe të jetë në rritje në vitet e fundit. Megjithatë gjatë vitit 2025, të ardhurat e pushtetit vendor në raport me të ardhurat publike kanë zënë 5.4% nga 5.7% që ishin në vitin 2024. Gjithashtu, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi duke ndryshuar raportin nga 0.8% e PBB në vitin 2015, në rreth 1.6 % në vitin 2025.


Grafiku 27 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Ecuria e të ardhurave vendore sipas llojit të burimit të tyre, pas rikthimit të trendit rritës prej vitit 2021, ka vazhduar trendin rritës edhe në vitet pasuese, ku rritja e të ardhurave vendore në vitin 2025 reflektohet në disa nga llojet e tyre sipas burimit. Kjo ecuri tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm, ku konstatohet një rritje me rreth 364 milionë LEK i të ardhurave të NJVQV në total, ku nga viti 2024 rezulton se të ardhurat nga "Taksa të tjera vendore" kanë rritjen më të madhe prej rreth 2.1 miliardë LEK ose me rreth 29.5%; të ardhurat nga "Taksa mbi pasurinë e paluajtshme" kanë gjithashtu rritje prej rreth 473 milionë LEK ose 6%, të ardhurat nga "Tarifat e shërbimeve vendore" kanë pothuajse të njëjtat vlera me vitin e kaluar, ndërkohë që të ardhurat nga "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja" rezultojnë me ulje prej rreth 2 miliardë LEK osë 11% krahasuar me vitin 2024, ku rënia e të ardhurave nga ky burim lidhet kryesisht me Bashkinë Tiranë, e cila ka arkëtuar rreth 7.7 miliardë LEK më pak ose më një rënie prej 53.8% krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 28 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Siç konstatohet edhe nga grafiku i mësipërm, ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Është e dukshme që "taksa mbi pasurinë" është rritur nga viti në vit dhe vlerësohet si një burim i qendrueshëm dhe i rëndësishëm në totalin e të ardhurave që mbledh pushteti vendor.

Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, siç e theksuam është një burim mjaft i rëndësishëm i buxhetit vendor, përmes së cilës bashkitë mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere, por dhe ndërtimi i një kadastre të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës për këtë burim financimi të pushtetit vendor. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite, duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim, kjo taksë ka patur trend rritës duke zënë rreth 19.9% të peshës së të ardhurave tatimore në vitin 2025, ndërkohë që në raport me një vit më parë janë mbledhur rreth 473.6 milionë LEK më shumë.

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi mbi biznesin e vogël në vite si pasojë e ndryshimeve fiskale, ka patur një rënie në peshën që zë në buxhetin vendor. Taksa mbi biznesin e vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (*Ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"*). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2025, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 36.4 milionë LEK, që përbëjnë vetëm 0.1% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara/mbledhura me vonesë.

Taksat Lokale


Taksat lokale janë një ndër burimet më të rëndësishme të financimit. Rritja e të ardhurave nga taksat lokale, gjithmonë e më shumë po dëshmon konsolidimin në këndvështimin financiar të NJVQV-ve. Në total për vitin 2025, të ardhurat nga taksat lokale zënë rreth 80% të të ardhurave të veta vendore, të cilat gjatë këtij viti kanë arritur në masën rreth 32.73 miliardë LEK ose vetëm 167 milionë LEK më shumë se një vit më parë. Ky rezultat vjen si pasojë e uljes së burimit që zë peshën më të madhe në të ardhurat nga taksat lokale që është "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja", siç analizuam më sipër. Megjithatë nga burimet e tjera të taksave lokale reflektohet një stabilitet i qëndrueshëm i situatës ekonomike; për shembull ecuria pozitive në turizëm gjatë vitit 2025 dëshmohet edhe nga rritja e të ardhurave të taksës së fjetjes në hotel me 18% më shumë nga viti i kaluar ose 111 milionë LEK më shumë.

Të tjera taksa/tarifa që zënë peshë të madhe në të ardhurat tatimore vendore janë *"Tarifa për zënien e hapësirave"* me 123 milionë LEK rritje nga viti kaluar dhe përkatësisht me peshë 2.6% kundrejt totalit të të ardhurave tatimore vendore , si dhe "*Tarifat e pastrimit dhe higjenës"*, që zë rreth 14.5% të të ardhurave tatimore vendore për vitin 2025.

6.2 Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore

Niveli i shpenzimeve për pushtetin vendor për vitin 2025 arriti në masën rreth 87.8 miliardë LEK, nga 74.4 miliardë LEK të shpenzuara një vit më parë. Kjo shifër përfaqëson një rritje prej rreth 13.4 miliardë LEK ose rreth 18% në krahasim me shpenzimet vendore të vitit 2024 dhe një rritje të lehtë prej 0.4% në raport me PBB. Gjatë vitit 2025, proceset e menaxhimit financiar publik në nivel vendor vazhduan në trendin pozitiv, gjë që dëshmohet edhe nga rritja e mëtejshme me 18% e shpenzimeve të buxhetit vendor në krahasim me vitin 2024 që në vetvete ishte një vit pozitiv. Në vitin 2025, shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 3.32% të PBB nga 3% që ishin në vitin 2024 dhe mbajnë peshë më të lartë prej pothuajse 11% në raport me shpenzimet e përgjithshme publike, kundrejt 10.2% në vitin 2024. Në mënyrë grafike, këto rezultate paraqiten si më poshtë:


Grafiku 29 Shpenzimet e buxhetit vendor ndaj PBB, në vite



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Në raport me vitin 2024, pushteti vendor gjatë vitit 2025 ka një rritje prej 13.4 miliardë LEK të shpenzimeve faktike, të cilat janë realizuar në vlerën 87.8 miliardë LEK. Grafikisht ecuria e këtyre shpenzimeve në vite dhe raporti i ndryshimit të tyre kundrejt vitit paraardhës, paraqitet si më poshtë:


Grafiku 30 Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet vendore gjatë vitit 2025, të detajuara sipas klasifikimit ekonomik, japin një panoramë të tillë: Peshën më të madhe të shpenzimeve vendore e zënë shpenzimet e personelit me 45.6% të totalit. Në raport me një vit më parë konstatohet që të gjitha shpenzimet klasifikuar sipas natyrës ekonomike kanë pësuar rritje në termsa nominalë, kurse shpenzimet kapitale kanë rritje si në vlerë edhe në peshën që zënë në totalin e shpënzimeve të buxhetit vendor. Shpenzimet e personelit kanë rritje përkatësisht me 6 063 milionë LEK ose 18% krahasuar me shpenzimet e personelit 2024, që vjen edhe nga rritja e nivelit të pagave. Shpenzimet operative kanë rritje përkatësisht me 375 milionë LEK ose 2%, shpenzimet për subvencione janë rritur 1 099 milionë LEK osë pothuajse trefishuar në raport me vitin 2024, kurse shpenzimet e tjera korente janë rritur me rreth 1 469 milionë LEK ose 43%. Shpenzimet për investime në buxhetin faktik vendor të vitit 2025 zënë rreth 21.5% dhe janë realizuar me 18.9 miliardë LEK, ose rreth 4.3 miliardë LEK më shumë se viti 2024. Në nivel llogarie ekonomike, struktura e shpenzimeve 2025 krahasuar me 2024, jepet në grafikun si mëposhtë:

Grafiku 31 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Në vitet e fundit, pavarësisht situatave të ndryshme, shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qendrueshmërisë së shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë, përmes shpenzimeve operative si dhe një rritje e shpenzimeve për subvencione. Më poshtë është paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela analitike e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë vitit 2025 krahasuar me 2024 dhe diferencat mes tyre në vlerë dhe në përqindje.

Tabela 16 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 12 mujori		Diferenca 2025-2024	
		2025	2024	në vlerë	në %
I.	**Të ardhura nga Pushteti vendor**	**40,911**	**40,331**	**580**	**101%**
I.1	*Taksa mbi pasurinë*	*8,144*	7,670	*474*	*106%*
I.2	*Taksa e biznesit të vogël*	*36*	*97*	*-61*	*37%*
I.3	*Taksa Lokale*	*32,731*	*32,564*	*167*	*101%*
II.	**Shpenzime nga Pushtetit Vendor**	**87,793**	**74,407**	**13,386**	**118%**
II.1	***Shpenzime Korente***	68,879	59,872	9,007	115%
	Personeli	*40,077*	*34,014*	*6,063*	*118%*
	Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtje	*22,232*	*21,857*	*375*	*102%*
	Subvencione	*1,666*	*567*	*1,099*	*294%*
	Shpenzime të tjera korente	*4,904*	*3,435*	*1,469*	*143%*
II.2	***Shpenzime Kapitale***	18,915	14,534	*4,380*	130%

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet vendore të personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të NJVQV. Për vitin 2025, këto shpenzime janë realizuar në mbi 40 miliardë LEK, që rezulton në rritje prej rreth 18% ose rreth 6 miliardë LEK më shumë se viti 2024. Rritja e shpenzimeve të personelit nga NJVQV përbën ndryshim të ndjeshëm krahasuar edhe me vitin e kaluar, pasi përveç trendit të zakonshëm të rritjes që njësitë vendore realizojnë me qëllim motivimin e punonjësve për rritjen e cilësisë së shërbimeve, por në kuadër të politikës së qeverisë për rritjen e pagave, ndryshimi i formulës së vlerësimit të vjetërsisë në punë, rritja e kufirit të pagës minimale si dhe rritja e niveleve të pagave të punonjësve sipas kategorive në tërësi, gjithashtu kanë sjellë këtë rezultat. Siç u tha edhe më sipër në buxhetin e vitit 2025, pushteti vendor u financua nga transfertat qendrore edhe me 3.5 miliardë LEK për mbështetjen e politikës së rritjes së pagave, përveç burimeve të veta. Këto shpenzime për vitin 2025 zënë 45.6% të totalit të shpenzimeve të pushetit vendor.

Shpenzimet vendore operative zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm, pasi janë shumë të nevojshme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Për vitin 2025, këto shpenzime janë realizuar në masën rreth 22.2 miliardë LEK, pothuajse në të njëjtat nivele me vitin e mëparshëm, por rezultojnë më një rritje prej 2% ose rreth 375 milionë LEK më shumë në raport me një vit më parë. Shpenzimet operative në vitin 2025 përbëjnë rreth 25.3% të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Shpenzimet vendore për subvencione dhe të tjera korente janë shpenzimet që zhvillojnë NJVQV për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Subvencionet në vitin 2025 kanë pësuar gjithashtu një rritje të konsiderueshme me rreth 294% nga viti 2024 ose rreth 1 099 milionë LEK më shumë.

Tashmë njësitë vendore planifikojnë në periudhë afatgjatë dhe mbështetur mbi strategji të qarta zhvillimi dhe ofrimi të shërbimit publik, që në mënyrë vazhdueshme të mbështesin me subvencione zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksionin e tyre. Kurse shpenzimet e tjera korente në tërësinë e tyre janë rritur me rreth 43% ose me 1 469 milionë LEK krahasuar me vitin 2024, ku rritja më konsiderueshme evidentohet në llogarinë 604 "transferta të brendshme korente" si dhe në llogarinë 651 "shpenzimet për interesa për huamarrje të tjera të brendshme" me rreth 572 milionë LEK më shumë se në vitin 2024.

Shpenzimet kapitale vendore për vitin 2025 rezultojnë të realizuara në një vlerë të konsiderueshme prej mbi 18.9 miliardë LEK, duke zënë kështu rreth 21.5% të totalit të shpenzimeve vendore. Krahasuar me vitin 2024 shpenzimet kapitale rezultojnë më të larta në vlerë nomkinale me 4.3 miliardë LEK ose rreth 30%. Projektet kryesore të investimeve janë përqëndruar kryesisht në ndërtimin apo rikonstruksionin e rrugëve, fushave sportive, palestrave, bibliotekave, shkollave, ndërtim të kopshteve, rikualifikime urbane, ujësjellësat etj. Nisur nga burimi i financimit të tyre vërejmë se mbi 4.6 miliardë LEK investime janë realizuar nga kapitulli 01 "çelje nga buxheti" që do të thotë se kanë patur burim financimi transfertat qendrore, kurse mbi 14 miliardë LEK janë realizuar me burim nga kapitulli 05 "të ardhurat e veta", ndërkohë që rezultojnë të realizuara rreth 156 milionë LEK investime të pushtetit vendor me financim të huaj (kapitulli 02) si dhe rreth 54 milionë LEK investime nga të ardhurat jashtë limitit (kapitulli 06).

7 RISQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka nisur monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente. Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të buxhetit afatmesëm, duke vlerësuar dy kategori risqesh:

- *Eksplicite", Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.*
- *"Implicite", kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.*

Tabela 17 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet eksplicite	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet implicite dhe detyrimet kontigjente	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave (2025)


Për vitin 2025, Ministria e Financave vijoi monitorimin e risqeve kryesore buxhetore sipas Udhëzimit nr.35 datë 29.12.2022 "*Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik*", Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*" dhe Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025*".

7.1 Ndërmarrjet shtetërore

Ndërmarrjet shtetërore përbëjnë një komponent kyç të sektorit quasi-publik dhe një burim të rëndësishëm të ekspozimit fiskal për financat publike. Struktura dhe aktiviteti i tyre, veçanërisht në sektorë strategjikë si energjia dhe ujësjellës-kanalizimet, shoqërohen me një nivel të konsiderueshëm risqesh fiskale, të cilat burojnë nga performanca financiare e paqëndrueshme, niveli i lartë i detyrimeve të ndërsjella, si dhe varësia ndaj mbështetjes buxhetore dhe instrumenteve të tilla si garancitë sovrane dhe nënhuatë. Evidencat tregojnë se këto ndërmarrje, për shkak të ekspozimit ndaj faktorëve të jashtëm (si kushtet hidrologjike dhe luhatjet e çmimeve të energjisë), si dhe problematikave strukturore të brendshme (likuiditet i kufizuar, eficiencë operative e ulët), mund të gjenerojnë detyrime të kushtëzuara dhe presione të drejtpërdrejta mbi buxhetin e shtetit. Në këtë kontekst, monitorimi i vazhdueshëm financiar dhe operacional nga Ministria e Financave, si dhe forcimi i kuadrit të menaxhimit të risqeve fiskale, mbeten thelbësore për identifikimin në kohë, vlerësimin dhe mitigimin e këtyre risqeve, në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale afatmesme dhe afatgjatë. Referuar publikimit më të fundit të INSTAT (Shtator 2025) mbi sektorin publik në Shqipëri, numri total i institucioneve jashtëbuxhetore është 180. Këto institucione ndahen si më poshtë:

- ✓ *57 Extra-buxhetore Qeveria qendrore*
- ✓ *83 Extra-buxhetore Qeveria lokale*
- ✓ *37 Ndërmarrje publike jo-financiare*
- ✓ *2 Ndërmarrje publike financiare*
- ✓ *1 Banka e Shqipërisë*

Grafiku 32 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve




Burimi: INSTAT (2026)

Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar*", specifikisht nenit 4/2 sipas së cilit: *"...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave..."*, dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.2/2025 "*Për zbatimin e buxhetit 2025*", kanë detyrimin e ndarjes së planeve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare mbi bazë 3M pranë Ministrisë përgjegjëse për financat. Mbi këtë bazë, MF monitoron dhe përgatit periodikisht mbi baza tremujore, analizat financiare të performancës së NSH-ve kryesore bazuar në potencialin e tyre për të impaktuar financat publike dhe buxhetin e shtetit. Monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit energjetik, që është thelluar në kuadër të reformës të këtij sektori, si edhe në performancën financiare të disa ndërmarrjeve shtetërore me relevancë të konsiderueshme si: Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UKT) sh.a, Hekurudha Shqiptare sh.a, AlbGaz sh.a, Albcontrol sh.a, Albpetrol sh.a, Posta Shqiptare sh.a, krahas edhe dy entiteteve të tjera (jo me status sh.a) si Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) dhe Autoriteti Portual Durrës (APD). Këto analiza monitorimi, të cilat përgatiten rregullisht në bazë tremujore, bëhen pjesë/publikohen në të gjitha raportet periodike të MF si Buxheti Faktik, Raporti i Mesvitit dhe projektbuxheti vjetor.

7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive: OSHEE Group sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a.

Grafiku 33 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 34 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në përqind)



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Gjatë 2025, sektori energjetik ka shënuar rënie të performancës financiare si pasojë e: *(i) kushteve të pafavorshme meteorologjike në vend gjatë vitit, dhe rrjedhimisht (ii) rënies së prurjeve në kaskadën e Drinit, që ka ndikuar në uljen e prodhimit vendas të energjisë elektrike nga KESH sh.a. përgjatë vitit 2025*.

Megjithëse në fund të vitit niveli i basenit të Fierzës arriti në 281.2m, duke tejkaluar kuotën mesatare prej 277.9m dhe duke treguar se në total reshjet vjetore ishin mbi mesataren, shpërndarja e tyre gjatë vitit nuk ka qenë e njëtrajtshme, çka ka ndikuar negativisht në rezultatin financiar.

Në nivel sektori, krahasuar me vitin 2024, vërehet se:

- ✓ *Rezultati financiar (fitim/humbje) i sektorit energjetik ka qenë negativ, me një humbje prej rreth 5.32 miliardë LEK, duke pësuar rënie të ndjeshme me rreth -14.29 miliardë LEK më pak, krahasuar me 2024.*
- ✓ *Marzhi i fitimit për 12 mujorin e vitit 2025 rezultoi në vlerë negative prej rreth 5.1 përqind, i cili krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shënon një rënie prej rreth 13.7 pikë përqind.*
- ✓ *Niveli i përgjithshëm i prodhimit neto vendas, ka pësuar rënie me rreth 4.7 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Konkretisht, gjatë 12M 2025 prodhimi neto vendas shënon vlerën 7.47 TWh, kundrejt 7.84 TWh realizuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.*
- ✓ *KESH sh.a. realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 3.71 TWh, kundrejt 4.37 TWh realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke rezultuar me një rënie rreth 15.1 përqind.*
- ✓ *Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2025 ato rezultuan në nivelin rreth 17 përqind, duke shënuar një rënie kundrejt një viti më parë, ku humbjet ishin në nivelin 17.9%.*
- ✓ *Niveli i arkëtimeve të OSHEE Group sh.a. për vitin 2025 arriti në nivelin 99 përqind, duke rezultuar me një rënie 1.5 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto financiare apo të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2025 vlerësohet rreth 5.28 miliardë LEK, nga rreth 6.05 miliardë LEK në vitin 2024. Duke qenë se sektori i energjisë varet ndjeshëm nga kushtet atmosferike, ndryshimet në to ndikojnë në performancën e sektorit dhe rrjedhimisht edhe në financat publike.

Projektet e investimeve me financim të huaj për sektorin e energjisë për vitin 2025 u miratuan në nivelin 2 mld LEK sipas buxhetit fillestar 2025, por nuk patën realizim.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndikimi i sektorit të Energjisë në financat publike:

Tabela 18 Të dhëna faktike mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milionë LEK)

	2021	2022	2023	2024	2025
Ndikimi në financat publike (në milionë LEK):	**5,504**	**33,017**	**5,286**	**6,045**	**5,277**
1. Garancitë dhe nënhuatë e paguara nga MF	***5,407***	***32,973***	***5,285***	***6,045***	***5,277***
Garanci të paguara nga MF	*1,504**	*2,989*	*1,149*	*1,631*	*2,256*
Projekte me financim të huaj të nënhuazuara	*3,903*	*2,077*	*4,136*	*4,414*	*3,021*
Hua e dhënë për energjinë	-	*7,907***	-	-	-
2. Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik		*20,000***	*0****	-	-
3. Detyrimet Tatimore (Vjetore)	***97.2***	***43.4***	***0.1***	***0.5***	***0.02***

** "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" (OSHEE Group Sh.a.) nëpërmjet instrumentit të garancisë sovrane në shumën 10 000 milionë LEK për vitin 2021 me anë të Aktit Normativ nr.31 datë 27.10.2021.*
*** "Hua e dhënë për energjinë" planifikuar në shumën 8 000 milionë LEK për vitin 2022 (realizimi faktik 7 907 milionë LEK) dhe "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 20 000 milionë LEK për vitin 2022 (realizimi faktik 20 000 milionë LEK).*
**** "Mbështetja buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 12 000 milionë LEK për vitin 2023 nuk u përdor dhe, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023 u rishpërnda për zërat e tjerë të shpenzimeve publike, bazuar në situatën e qëndrueshme të sektorit.*
Burimi: Ministria e Financave (2026)

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 datë 30.09.2021 "*Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", nëpërmjet së cilit, ndërmarrjet e sektorit energjitik raportojnë në mënyrë periodike mujore, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërsjella ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Përgjatë vitit 2025, në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, MF ka monitoruar periodikisht mbi bazë mujore detyrimet e ndërsjella të raportuara nga ndërmarrjet e sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Për periudhën 12 mujore të vitit 2025 vërehet një trend rritës i detyrimeve të ndërsjella krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje i atribuohet kryesisht detyrimeve që ndërmarrja KESH-sh.a rezulton të ketë ndaj MF dhe OSHEE Group ndaj DPT.

Megjithëse ndërmarrjet e sektorit energjetik raportojnë se, një pjesë e këtyre detyrimeve të ndërsjella janë shlyer sipas planit të masave për reduktimin e tyre, niveli i përgjithshëm vijon të rritet. Kjo pasi, shoqëritë vazhdojnë të përballen me një situatë likuiditeti të pamjaftueshme, të mbartur nga vitet e kaluara, e cila ka bërë të pamundur shlyerjen e të gjithë detyrimeve sipas planit vjetor. Një tjetër faktor që ka ndikuar në situatën aktuale janë edhe vonesat në shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella nga ndërmarrjet UK. Ndërmarrjet e sektorit energjetik konfirmojnë se angazhimi i tyre mbetet maksimal në drejtim të përmbushjes me sukses të marrëveshjeve për likuidimin tërësor të stokut të detyrimeve të ndërsjella.

Më poshtë jepet një tablo e detyrimeve të ndërsjella, të regjistruara deri në Dhjetor 2025:

Tabela 19 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB, MF dhe DPT

Deri në Dhjetor 2025 (në miliardë LEK)	KESH	OST	OSHEE	MF	DPT	Total
KESH ndaj:		0*		45.13		**45.13**
OST ndaj:	10.24*		0.04	7.40		**17.69**
OSHEE ndaj:	45.47**	8.07**		2.83	4.65	**61.02**
Ndërmarrjet UK ndaj:			33.80	11.19		**44.99**
ML/IB ndaj:			6.60			**6.60**
Total	**55.71**	**8.07**	**40.44**	**66.55**	**4.65**	**175.42**

** Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 0-0.13 miliardë LEK për KESH ndaj OST dhe nga 10.24-13.58 miliardë LEK për OST ndaj KESH, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.*

*** Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 45.47-49.70 miliardë LEK për OSHEE ndaj KESH dhe nga 8.07-15.61 miliardë LEK për OSHEE ndaj OST, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.*

Burimi: MF, KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE Group sh.a, AKUK (2026)

Të Dhëna Financiare për Sektorin Energjetik

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025*", MF periodikisht mbi bazë tremujore ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve buxhetore që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë. Bazuar në të dhënat më të fundit të raportuara pranë MF për vitin 2025, më poshtë paraqitet performanca financiare e tre ndërmarrjeve të sektorit energjetik (*OSHEE Group sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a*) mbi bazë krahasimore për të njëjtat periudha pararendëse:

Tabela 20 Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë LEK)[2]

Zërat/Periudha	12M 2023	12M 2024	12M 2025
Të ardhurat	*147,098,293*	*116,501,361*	*111,627,879*
Shpenzimet	*120,976,782*	*107,540,836*	*116,952,582*
Humbje/Fitim	**26,121,511**	**8,960,525**	**(5,324,702)**
Aktivet Afatshkurtra	*160,808,096*	*139,827,957*	*123,704,979*
Aktivet Afatgjata	*219,191,444*	*224,112,925*	*233,112,479*
Total Aktive	**379,999,540**	**363,940,882**	**356,817,458**
Detyrimet afatshkurtra	*188,128,567*	*163,461,465*	*154,594,247*
Detyrimet afatgjata	*91,758,670*	*86,019,619*	*84,344,674*
Total Detyrime	**279,887,236**	**249,481,085**	**238,938,921**
Kapital	**100,112,304**	**114,459,797**	**117,878,537**

Burimi: OSHEE Group sh.a, OST sh.a, KESH sh.a. (2026)

➢ *Performanca financiare e OSHEE Group sh.a.*

Tabela 21 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2023	12M 2024	12M 2025
Të ardhurat	*93,182,743*	*78,358,635*	*72,787,453*
Shpenzimet	*86,051,068*	*70,779,989*	*65,708,915*
Humbje/Fitim	**7,131,675**	**7,578,646**	**7,078,538**
Aktivet Afatshkurtra	*42,410,250*	*34,853,588*	*29,191,497*
Aktivet Afatgjata	*68,932,021*	*71,271,886*	*80,710,161*
Total Aktive	**111,342,271**	**106,125,474**	**109,901,658**
Detyrimet afatshkurtra	*81,065,671*	*73,034,634*	*65,383,049*
Detyrimet afatgjata	*58,973,387*	*54,208,980*	*51,751,971*
Total Detyrime	**140,039,058**	**127,243,614**	**117,135,021**
Kapital	**(28,696,787)**	**(21,118,140)**	**(7,233,363)**

Burimi: OSHEE Group sh.a.

[2] *Deri në përfundimin e procesit të auditimit, të dhënat financiare janë paraprake për OSHEE Group sh.a (vitet 2023-2024), KESH sh.a (vitet 2022-2024) dhe OST sh.a (viti 2024). Këto të dhëna mund të jenë subjekt i ndryshimeve në vijim.*

➢ *Performanca financiare e KESH sh.a.*

Tabela 22 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2023	12M 2024	12M 2025
Të ardhurat	*41,973,808*	*28,323,926*	*28,209,489*
Shpenzimet	*28,478,190*	*28,702,644*	*41,947,444*
Humbje/Fitim	**13,495,618**	**(378,718)**	**(13,737,955)**
Aktivet Afatshkurtra	*99,764,401*	*88,659,440*	*81,615,556*
Aktivet Afatgjata	*85,349,460*	*85,366,477*	*81,999,861*
Total Aktive	**185,113,860**	**174,025,917**	**163,615,417**
Detyrimet afatshkurtra	*79,805,047*	*63,768,692*	*63,901,649*
Detyrimet afatgjata	*17,545,032*	*17,397,937*	*18,745,837*
Total Detyrime	**97,350,079**	**81,166,629**	**82,647,486**
Kapital	**87,763,782**	**92,859,288**	**80,967,930**

Burimi: KESH sh.a.

➢ *Performanca financiare e OST sh.a.*

Tabela 23 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2023	12M 2024	12M 2025
Të ardhurat	*11,941,741*	*9,818,799*	*10,630,937*
Shpenzimet	*6,447,524*	*8,058,203*	*9,296,223*
Humbje/Fitim	**5,494,218**	**1,760,597**	**1,334,714**
Aktivet Afatshkurtra	*18,633,446*	*16,314,929*	*12,897,926*
Aktivet Afatgjata	*64,909,963*	*67,474,562*	*70,402,458*
Total Aktive	**83,543,408**	**83,789,491**	**83,300,383**
Detyrimet afatshkurtra	*27,257,849*	*26,658,139*	*25,309,548*
Detyrimet afatgjata	*15,240,251*	*14,412,702*	*13,846,866*
Total Detyrime	**42,498,100**	**41,070,842**	**39,156,414**
Kapital	**41,045,309**	**42,718,649**	**44,143,969**

Burimi: OST Sh.a.

7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, Ministria e Financave ka monitoruar disa tregues kryesorë financiarë të ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizime. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2025, për ndërmarrjet e U-K të analizuara, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër. Pasojat nga pandemia COVID19 dhe faktorë të tillë si efektet e krizës globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, kanë patur impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K.

Për vitin 2025, buxheti i shtetit ka alokuar një vlerë totale subvencioni prej 350 milionë LEK në strukturën buxhetore të MIE, i cili detajohet nga AKUK/MIE bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin "*Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve...*", miratuar nga Ministri përgjegjës për Infrastrukturën dhe Energjinë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes. Sa i takon stokut të detyrimeve të akumuluara nga ndërmarrjet UK sh.a ndaj sektorit të energjisë, vlen për t'u theksuar se në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë. Plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me Urdhërin e Përbashkët MIE/MF nr.304/2020 "*Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", përfshin në procesin e shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella edhe sektorin e Ujit.

Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, MIE dhe MF bashkëfirmosën Urdhërin e dytë të Përbashkët nr.379/2021 "*Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", i cili ngarkon (krahas ndërmarrjeve të sektorit energjitik) edhe AKUK për raportim mujor mbi ecurinë e shlyerjen së detyrimeve të prapambetura të ndërsjella. Kështu, deri në Dhjetor 2025, OSHEE Group sh.a. raporton se detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 33.8 miliardë LEK. Nga këto, rreth 14.1 miliardë LEK janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 19.7 miliardë LEK janë detyrime për kamatëvonesa. Nga totali i detyrimeve principal (pa kamatëvonesa), vetëm ndërmarrja e UK Durrës sh.a ka 5.75 miliardë LEK detyrime të akumuluara në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet U-K që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve (pa kamatëvonesa) ndaj OSHEE Group sh.a, deri në Dhjetor 2025.

Tabela 24 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në miliardë LEK)

	(miliardë/LEK)
Ndërmarrjet U-K kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group sh.a	**9.16**
Njësia Durrës UK sh.a	5.75
Njësia Fier UK sh.a	0.89
Njësia Shkodër UK sh.a	0.88
Njësia Patos UK sh.a	0.87
Njësia Kavajë UK sh.a	0.77

Burimi: AKUK (2026)

Në zbatim të VKM nr.302/2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*", reforma për sektorin e ujësjellës kanalizimeve ka hyrë tashmë në një faze konsolidimi. Synimi i kësaj reforme ishte ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve U-K aktuale nëpërmjet rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK (*Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta*) rajonale, me qëllim rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës financiare. Aktualisht janë krijuar 14 shoqëri SKP-UK rajonale dhe procesi ka përparuar edhe në drejtim të strukturimit të brendshëm të këtyre shoqërive. Mbeten 3 bashki të cilat ende nuk kanë firmosur marrëveshjet e bashkëpunimit për krijimin e shoqërisë rajonale UK Tiranë.

7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme

Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 "*Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*", Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t'u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore.


Duke nisur nga muaji Dhjetor 2020, ky proces i cili më parë kryhej mbi bazë tremujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, tashmë gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*", gjë që përveçse ka rritur saktësinë e të dhënave dhe sigurimin e tyre në kohë reale, ka unifikuar njëkohësisht edhe modalitetin e raportimit për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*", në nenin 52 përcaktohet qartë se: "...*Shpenzimet që rezultojnë nga angazhimet e ndërmarra gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit, kryhet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës*...". Nisur nga sa më sipër, shlyerja e detyrimeve të prapambetura përbën një detyrim ligjor për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në "*Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2024-2026*" të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Kjo, përsa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqituar gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme në këtë drejtim.

Njëkohësisht, për të parandaluar akumulimin dhe ulur stokun total të detyrimeve të prapambetura ndër vite, si në rastin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore, Ministria e Financave krahas monitorimit periodik të tyre, apelon edhe tek institucionet buxhetore që të ulin edhe më tej barrën e tyre, nëpërmjet aplikimit në kohë të kësteve të pagesave ose implementimin e instrumente të tjera lehtësuese ndaj përfituesve të vendimeve gjyqësore. Prioriteti kryesor i Ministrisë së Financave në periudhën afatmesme, mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre.

Grafiku 35 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në milionë LEK.



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Deri në fund të muajit Dhjetor 2025 u regjistrua një stok kumulativ i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme prej 5.9 miliardë LEK[3], nga të cilat:

- ✓ *Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 1.56 miliardë LEK*
- ✓ *Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 2.93 miliardë LEK.*
- ✓ *Totali i detyrimeve për rimbursimin e TVSH rreth 1.41 miliardë LEK.*

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për të njëjtën periudhë të vitit 2024, rezulton se niveli i përgjithshëm i tyre është rreth 1.42 miliardë LEK më i ulët ose me një rënie prej 19.4%. Konkretisht,

- ✓ *Detyrimet e prapambetura qendrore janë ulur me rreth 1.1 miliardë LEK, ndërsa ato vendore janë ulur me rreth 325.8 milionë LEK.*
- ✓ *Detyrimet për rimbursimin e TVSH janë rreth 1.41 miliardë LEK, duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin paraardhës 2024.*

Në total, gjatë vitit 2025 janë shlyer rreth 1.42 miliardë LEK detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer në vijim karakterizohen nga një "moshë mesatare" e re e krijimit të tyre.


7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore

Sipas informacionit të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për periudhën deri në Dhjetor 2025, stoku i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore është rreth 1.56 miliardë LEK, ose rreth 1.1 miliardë LEK më i ulët krahasuar me stokun e regjistruar në Dhjetor 2024. Sipas kategorive të shpenzimeve rezulton se:

- ✓ *Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit rreth 47%,*
- ✓ *Vendimet gjyqësore zënë rreth 25.8%,*
- ✓ *Detyrime të prapambetura të tjera zënë rreth 10.2%,*
- ✓ *Shërbimet me rreth 5.2%,*
- ✓ *Mallra me rreth 3.3%,*
- ✓ *Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 2.7%,*
- ✓ *Të Ardhurat Personale me rreth 2.7%,*
- ✓ *Detyrimet për sigurimet shëndetësore me rreth 1.2%.*
- ✓ *Rimbursimi i TVSH 1.1%,*
- ✓ *Mirëmbajtje me rreth 1%.*


[3] *Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizime dhe Universiteteve*

Grafiku 36 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku 37 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Krahasuar me vitet e kaluara, viti 2025 shënoi një ulje të detyrimeve të prapambetura në shpenzimet për investime, të cilat zënë dhe peshën kryesore ndaj totalit në nivel qendror.

- ✓ *Deri në Dhjetor 2025, detyrimet e prapambetura të shpenzimeve për investimet rezultuan në rreth 732 milionë LEK ose rreth 47% e totalit të detyrimeve në nivel qendror, nga 1,093.7 miliardë LEK që ishin në Dhjetor 2024.*

Një zë me peshë të konsiderueshme vijon të mbetet ai i vendimeve gjyqësore administrative, të cilat:


- ✓ *Kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Deri në Dhjetor 2025, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore për njësitë e qeverisjes qendrore rezultuan në rreth 402.3 milionë LEK ose rreth 25.8% e stokut total të detyrimeve të prapambetura të njësive qendrore, nga 911.6 miliardë LEK që ishin deri në Dhjetor 2024. Ministria e Financave, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumenteve të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.*

7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2025, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave është mbi 2.9 miliardë LEK. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është rritur me rreth 107 milionë LEK, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025, dhe është ulur me rreth 326 milionë LEK, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2024, që ishte 3.2 miliardë LEK.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Kavajë në vlerën rreth 755 milionë LEK ose 26.2% të totalit të detyrimeve (pa përfshirë detyrimet e qarqeve). Më pas, bashkia Pogradec në vlerën rreth 251 milionë LEK ose 8.7% të totalit të detyrimeve; bashkia Vorë në vlerën rreth 185 milionë LEK ose 6.4% të totalit të detyrimeve; bashkia Rrogozhinë në vlerën rreth 141 milionë LEK ose 4.9% të totalit të detyrimeve dhe bashkia Tiranë në vlerën rreth 133 milionë LEK ose 4.6 % të totalit të detyrimeve.

Grafiku 38 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Sipas kategorive, rezulton që:

- ✓ *Investimet zënë një peshë të madhe të stokut të detyrimit me rreth 32.4%,*
- ✓ *Detyrime të prapambetura të tjera me rreth 24.2%,*
- ✓ *Shërbimet rreth 19.7%,*
- ✓ *Vendimet Gjyqësore rreth 10.7%,*
- ✓ *Mallra me rreth 7.2%,*
- ✓ *Mirëmbajtje rreth 4.1%, etj.*

Tabela 25 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive

Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha ne % (Bashki)	Pesha ne % (Qarqe)
4864100	Vendime Gjyqësore	269,068,597	44,521,820	9.3%	94.7%
4864200	Det.Prap. Shërbime	575,659,018	1,279,017	19.9%	2.7%
4864300	Det.Prap.Mirëmbajtje	120,193,707	0	4.2%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	948,499,801	576,220	32.9%	1.2%
4864500	Det.Prap.Rimbursim TVSH	0	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	209,910,980	517,735	7.3%	1.1%
4864900	Det.Prap.Të Tjera	710,737,397	120,000	24.6%	0.3%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqërore	38,234,856	0	1.3%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shëndet.	2,811,899	0	0.1%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personale	9,617,123	0	0.3%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	1,220,430	0	0.0%	0.0%
TOTAL		**2,885,953,808**	**47,014,792**	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2026)

7.3 Pagesat për Kontratat Koncesionare/PPP

Sa i takon ecurisë së pagesave faktike për kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore, për vitin 2025 monitorimi dhe raportimi i tyre është institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", i cili përcakton skedulin e detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor, krahas formateve standarde për këtë qëllim. Në nivel total për 2025:

- ✓ *Rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP të miratuara me mbështetje buxhetore.*
- ✓ *Janë realizuar pagesa faktike për 10 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore[4].*
- ✓ *Fondet buxhetore të planifikuara, sipas planit vjetor me ndryshime, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë rreth 13.68 miliardë LEK.*
- ✓ *Pagesat faktike vjetore total ishin 13.36mld LEK ose 97.6% e pagesave të planifikuara, sipas planit me ndryshime.*

Respektimi i rregullit fiskal, për vitin 2025:

- ✓ Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit pararendës 2024, përllogaritet në rreth 32.95 miliardë LEK.
- ✓ Referuar tabelës së mëposhtme, pagesat vjetore faktike të kryera nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, rezultuan në rreth 13.36mld LEK.
  - ***Rrjedhimisht, për vitin 2025 u respektua rregulli fiskal <5%, pasi niveli 13.36mld LEK përbën vetëm 2.03% të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit pararendës 2024, prej 659.1mld LEK.***

Tabela 26 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK)

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2023	Fakt 2024	Plan 2025	Fakt 2025	% e realizimit Fakt/Plan 2025
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	2,844,000	3,504,000	3,360,000	3,360,000	100%
	2	Subvencioni i kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë"	2019	2032	04520	Investime	666,563	608,601	588,670	588,670	100%
	3	Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2021	2034	04520	Investime	726,787	786,380	769,146	762,548	99.1%
	4	Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë	2022	2032	04540	Investime	-	-	-	-	-
Ministria e Financave	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	01150	Korente	1,540,310	1,411,985	1,441,412	1,441,412	100%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2026	07220	Korente	876,083	876,083	876,090	860,158	98.2%
	2	Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale	2016	2026	07330	Korente	1,749,982	1,755,835	1,900,000	1,899,982	100%
	3	Ofrimi i shërbimit të hemodializës	2016	2026	07330	Korente	849,129	894,392	960,000	931,978	97.1%
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike mjekësore	2020	2030	07330	Korente	1,718,879	1,802,818	1,900,000	1,893,575	99.7%
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit	1	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tirana 4"	2018	2026	09230/09120	Investim	698,074	722,121	707,570	707,568	100%
(MIE) MM / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2047	05100	Korente	989,797	931,363	1,180,000	913,112	77.4%
	11	TOTALI					12,659,602	13,293,576	13,682,888	13,359,003	97.6%
Totali i të Ardhurave Tatimore							598,661,930	659,096,060	716,283,250		
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.34%	2.22%	2.03%		

Burimi: Ministria e Financave, Autoritetet Kontraktore (2026)

[4] *Për kontratën "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e 'Portit të Integruar' në Triport Vlorë", referuar modelit financiar të kësaj kontrate, pagesat nga Autoriteti Kontraktor do të kryhen jo më parë se tre vite nga data efektive e kontratës, pasi të jenë kryer 100% të volumit të punimeve.*

7.4 Detyrime të tjera Kontigjente

7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Ministria e Financave ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likuidimit të VKM respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MF ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe proceduriale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negocim me përfituesit. Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin "*Për Avokaturën e Shtetit*", përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ, ku në nenin 19/5 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi:

- ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM përkatëse për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ.*
- ✓ *Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) EUR, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Gjatë vitit 2025,rezultoi se:

- ✓ Këshilli i Ministrave ka miratuar 4 (katër) VKM me një vlerë totale prej 56 500 EUR (rreth 5.56 milionë LEK) të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit i miratuar për vitin 2025 dhe konkretisht:
  - *VKM 547/2025 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 16.07.2024 për çështjen 'Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V kundër Shqipërisë'" (kërkesat nr.41373/21 dhe 48801/21), në vlerën 17 200 EUR.*
  - *VKM 592/2025 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 10.12.2024 për çështjen 'Ramaj kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.17758/06), në vlerën 14 000 EUR.*
  - *VKM 724/2025 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 14.01.2025 për çështjen 'Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.81057/17 dhe 4 kërkesa të tjera), në vlerën 12 800 EUR.*
  - *VKM 652/2025 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 27.05.2025 për çështjen 'ARB, sh.p.k dhe të tjerë kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.39860/19 dhe 3 kërkesa të tjera), në vlerën 12 500 EUR.*
- ✓ Ndërkohë, Ministria e Financave ka ekzekutuar gjatë 2025 edhe 13 (trembëdhjetë) vendime të tjera të GJEDNJ, me vlera nën 10 000 EUR, për një total prej 55 905 EUR (*rreth 5.57 milionë LEK*).

Deri në fund të vitit 2025, detyrimet e materializuara dhe ato kontigjente për vendimet e GJEDNJ, paraqiten mëposhtë:

Tabela 27 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ (në EUR)

Data e vendimit	Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM	Detyrimi kontingjent	Totali i detyrimit
14.09.2015	Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
17.03.2016	Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa: Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
28.05.2018	Sharxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
05.06.2024	Iliria s.r.l kundër Shqipërisë	10,800 €		10,800 €
11.09.2024	Zela kundër Shqipërisë	60,000 €		60,000 €
26.11.2025	Kroi dhe Nocka kundër Shqipërisë	11,200 €		11,200 €
18.11.2025	Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë	6,600 €		6,600 €
25.11.2025	Selimi kundër Shqipërisë	6,500 €		6,500 €
Vendim në pritje nga GJEDNJ	Ramaj kundër Shqipërisë		1,970,000 €	1,970,000 €
	Totali	**17,975,750 €**	**1,970,000 €**	**19,945,750 €**

Shënim: Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM është detyrimi përkatës nga një vendim i formës së prerë të GJEDNJ/VKM-së respektive, i cili rezulton ende i papaguar deri në fund të vitit 2025.

Shënim: Detyrim kontingjent është detyrimi i pritshëm/potencial nga një vendim në shqyrtim ose në pritje për të marrë formë të prerë nga GJEDNJ, i raportuar nga Avokatura e Shtetit deri në fund të vitit 2025.

Burimi: Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit (2026)

7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qenësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit.

Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje) dhe nga buxheti i ndërmarrjeve publike, të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likuidohen përmes buxhetit të Ministrisë së Financave dhe/ose Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja. MF në vazhdimësi ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e proçesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllim final lehtësimin, reduktimin dhe shmangien e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

Për 2025, vlera totale e paguar nga buxheti i shtetit në kuadër të kostove të përfaqësimit ligjor, proceseve të kundërshtimit, shpenzimeve gjyqësore/administrative, etj, rezultoi në masën rreth 147.5 milionë LEK.

Tabloja e pagesave buxhetore sipas institucioneve shtetërore përgjegjëse, jepet në tabelën e mëposhtme:

- ✓ *Rreth 145.6 milionë LEK nga Ministria e Financave për pagesën e shërbimeve juridike dhe kostove të tjera ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e RSH në vendime të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 1.84 milionë LEK nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për pagesën e shpenzimeve gjyqësore dhe administrative për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 56 mijë LEK nga MBZHR, për pagesën e kostove administrative lidhur me çertifikimin, apostilimin dhe noterizimin e vendimit final për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar PCA Case 2018-49.*

Tabela 28 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)

Detyrimet për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar

në Euro

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Totali i detyrimit fillestar	Detyrimi i Faturuar	Likuidimi	Nga të cilat: Likuidimi 2025	Detyrimi i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit/kosto ligjore (A)	Detyrime Kontigjente (B)	Totali i detyrimit (C=A+B)
MIE/ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH). *JV Copri-Aktor vs ARRSH.*	41,144,749	41,144,749	0	0	41,144,749	0	41,144,749
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)	691,400	466,400	466,400	0	150,000	0	150,000
MIE/AKUK	ICC Case 24140/MHM Construzioni DONDI S.P.A	13,282,845	13,282,845	0	0	13,282,845	0	13,282,845
	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH *Construzioni DONDI S.P.A*	2,281,133	2,252,633	2,252,633	0	28,500	0	28,500
MIE	ICC Case No. 20564/EMT/GR Hydro srl	142,976	0	0	0	142,976	0	142,976
MIE/AKBN/ Albpetrol Sh.a	ICC Case no.22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol	11,855,415	0	0	0	11,855,415	0	11,855,415
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit në çështjen ICC Case no. 22676/GR	2,054,951	1,847,451	1,647,451	0	407,500	0	407,500
MF	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit Mimoza Ndroqi kundër RSH	945,000	586,153	550,000	420,000	36,153	0	36,153
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	108,302,807	0	0	0	0	108,302,807	108,302,807
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	9,325,570	4,499,240	4,499,240	983,658	2,714,575	1,050,000	3,764,575
	Kosto ligjore për proceset e kundërshtimit të Dekretit Ekzekutues R.G.n 27416/2024	511,750	51,750	51,750	51,750	50,000	410,000	460,000
MBZHR	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen PCA Case 2018-49 *Valeria Srl vs RSH*	1,945,509	1,945,509	1,945,509	559	0	0	0
MEI	Shpenzime gjyqësore/administrative për çështjen ICC Case 29497/ICA3 Sweco GmbH vs. MEKI	18,400	18,400	18,400	18,400	0	0	0
	Total	192,502,504	66,095,129	11,431,383	1,474,367	69,812,712	109,762,807	179,575,519

Sqarojmë se, duke qënë se detyrimet për vendimet e Arbitrazhit janë në monedha të ndryshme, janë reflektuar kurset aktuale të këmbimit.

Sqarojmë se, në tabelë paraqiten çështje të arbitrazhit/kosto ligjore të lidhura me to, për të cilat ka detyrime aktuale (të mbetura apo kontingjente) dhe/ose janë realizuar pagesa gjatë vitit 2025.

Sqarojmë se, për kontratat të cilat zgjidhen përpara përfundimit të shërbimit të kontraktuar, subjekti likuidohet vetëm për shërbimet e realizuara në funksion të kontratës. Rrjedhimisht nuk ezaurohet e gjithë vlera e përcaktuar në kontratë.

Shënim: Informacioni i mësipërm bazohet në të dhënat më të fundit (Prill 2026) të raportuara në MF nga Avokatura e Shtetit dhe nga Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore, për detyrimet dhe pagesat deri në fund të vitit 2025. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit.

Shënim: Në tabelën e mësipërme përfshihen detyrime nga vendime përfundimtare të gjykatës së Arbitrazhit dhe detyrime që rrjedhin nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur etj (kryesisht për procedura të përfaqësimit dhe mbrojtjes, kundërshtimit/rishikimit/anullimit të një vendimi arbitrazhi apo kosto të tjera administrative/aplikimi/përkthimi etj).

Shënim: Totali i detyrimit fillestar është vlera e detyrimit të përcaktuar në një vendim përfundimtar të gjykatës së Arbitrazhit apo vlera totale e përcaktuar në një kontratë të lidhur mes shtetit shqiptar dhe një studio ligjore/ekspert të pavarur etj (kryesisht për procedura të përfaqësimit dhe mbrojtjes, kundërshtimit/rishikimit/anullimit të një vendimi arbitrazhi apo kosto të tjera administrative/aplikimi/përkthimi etj.

Shënim: Detyrimi i mbetur nga vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar/kosto ligjore është detyrimi i papaguar nga një vendim përfundimtar i gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar ose detyrimi i mbetur (i papaguar) nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për pjesën e detyrimit që është faturuar nga Avokatura e Shtetit dhe rezulton e papaguar ose detyrimi i cili, bazuar në kontratë, duhet të likuidohet sipas fazave të përcaktuara në kontratë, në nenin përkatës për 'tarifat dhe mënyrën e pagesës'.

Shënim: Detyrim kontigjent është detyrimi i pritshëm/potencial i cili ka gjasa të materializohet në periudhat e ardhshme, konkretisht për vendime të gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar të cilat janë subjekt i procedurave juridike të kundërshtimit/rishikimit/pezullimit/anullimit ose detyrime të pritshme nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për fazat proceduriale të përcaktuara në kontratë të cilat vazhdojnë në rastet kur Tribunali gjen juridiksion dhe vazhdon me fazat e tjera të përcaktuara në kontratë, faza të cilat implikojnë kosto financiare.

Burimi: Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit, ML/IB, Ndërmarrjet Publike (2026)

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

8 SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar*" (*referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB*), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirëmenaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksion paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskale përgjatë vitit 2025.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qendrojë poshtë nivelit 45% të PBB.

Zbatimi i ligjit (1):

Ligji fillestar i buxhetit vjetor 2025 (Ligj nr.115/2024 datë 3.12.2024) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Më specifikisht, raporti i borxhit ndaj PBB për vitin 2024, i vlerësuar në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit fillestar të buxhetit vjetor 2025, ishte 55.2% e PBB-së. Ndërsa niveli i borxhit që planifikohej në ligjin fillestar të vitit 2025 ishte 54.8% e PBB-së, pra më i ulët se sa niveli i vlerësuar për vitin 2024.

Sa i takon vlerësimit të borxhit faktik gjatë vitit 2025 (*sipas shifrave të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij raporti*) ai rezulton 52.9% e PBB. Kjo konsiston në një rënie prej 1.3 pp të borxhit publik total nga niveli faktik prej 54.2% që ishte në 2024. Ndërsa, nëse në konsideratë do të merrej treguesi i borxhit publik total *neto* nga gjendja e depozitës së Qeverisë në Bankën e Shqipërisë (Llogarisë Unike të thesarit), atëherë rënia e borxhit sipas këtij treguesi (*borxhi neto*) rezulton me 1.3 pp, nga 51.9% në 2024 në 50.7% në 2025.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës ''a'') mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij LOB.

Zbatimi i ligjit (2):

Gjatë vitit 2025 nuk ka qenë rasti i aplikimit të kësaj klauzole përjashtuese.

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në LEK, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj PBB për vitet buxhetore që planifikohen dhe vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (*World Economic Outlook*) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit 2025 hartuar dhe miratuar për vitin 2025 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore të LOB.

Shënim: *Në ligjin e buxhetit 2025, si vlera referencë për projeksionet e FMN-së janë përdorur projeksionet më të fundit dhe të përshtatshme të FMN-së, të dërguara zyrtarisht Ministrisë së Financave më 9 tetor 2024. Kjo qasje u adoptua pasi projeksionet e FMN-së për Raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook - WEO[5]) të tetorit 2024 ishin finalizuar përpara publikimit nga Instituti i Statistikave (INSTAT), më 30 shtator 2024, të statistikave të rishikuara të Llogarive Kombëtare Vjetore (PBB vjetore) për periudhën 2018-2023. Duke qenë se rishikimet e PBB-së nominale rezultuan të konsiderueshme, veçanërisht për vitin bazë 2023, projeksionet e WEO-së të tetorit 2024, të bazuara në statistika më të vjetra, humbën relevancën për qëllimin e këtij rregulli fiskal të LOB. Për këtë arsye, në këtë rast të veçantë, FMN-ja i dërgoi zyrtarisht Ministrisë së Financave projeksionet e përditësuara të PBB nominal për vitet 2024 dhe 2025, të cilat reflektojnë dhe bazohen në statistikat më të fundit të rishikuara të INSTAT.*
Ndërkohë përsa i përket ndryshimeve të ligjit të buxhetit 2025, nëpërmjet AN nr. 3, AN nr. 6, AN nr. 10 dhe AN nr. 11 si vlera referencë të projeksioneve të FMN-së janë përdorur projeksionet e WEO-së të përgatitura në prill 2025.

[5] *World Economic Outlook, 14 October 2024, World Economic Outlook, October 2025; Global Economy in Flux, Prospects Remain Dim*

Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2025 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligji fillestar i Buxhetit 2025 Ligji Nr.115, dt 03.12.2024		AN. Nr. 3, Dt. 29.04.2025		AN. Nr. 6, Dt 11.06.2025		AN. Nr 10, Dt. 08.10.2025		AN. Nr 11, Dt. 19.12.2025	
PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)	PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)	PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)	PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)	PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)	PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)
2,681	2,620	2,691	2,620	2,691	2,620	2,691	2,620	2,691	2,620

(1) WEO - Tetor 2024; (2) WEO - Prill 2025;

***Shënim**: Vlerat faktike të PBB 2025 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT, nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më i lartë se sa parashikmi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit, është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me ''realizmin'' e parashikimeve të PBB dhe veçanërisht, elemiminin e devijimeve ''optimiste'' sistematike (të përsëritura disa vite rresht).*

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë prej jo më pak se 0.7% e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (4):

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2025

Vlera e Buxhetuar e zërit "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit"

Ligji Nr.115, dt 03.12.2024	AN. Nr. 3, Dt. 12.03.2022	AN. Nr. 6, Dt 11.06.2025	AN. Nr 10, Dt. 08.10.2025	AN. Nr 11, Dt. 19.12.2025
5.7 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	5.7 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	5.7 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	5.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	5.8 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2025 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela mëposhtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit e miratimit të ligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues gjatë 2025 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5%, atëherë defiçiti i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2% e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (5):

Në çdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2025 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në raportet respektive *''Perspektiva Ekonomike Botërore*" të FMN, nuk parashikohej një rritje reale për vitin 2025 prej të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2025 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2025

Ligji Nr.115, dt 03.12.2024		AN. Nr. 3, Dt. 29.04.2025		AN. Nr. 6, Dt 11.06.2025		AN. Nr 10, Dt. 08.10.2025		AN. Nr 11, Dt. 19.12.2025	
Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)	Rritja Reale e PBB (e parashikuar nga FMN)	Deficiti i targetuar (ne % te PBB)
2025	2025	2025	2025	2025	2025	2025	2025	2025	2025
3.3	2.6	3.3	2.6	3.7	2.6	3.7	2.4	3.7	2.4

(1) WEO - Tetor 2024; (2) WEO - Prill 2025;

***Shënim:** Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundra-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet ''përtej potencialit të natyrshëm'' të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si ''rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%'', atëherë në këtë rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi defiçitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse defiçiti do të ankorohej sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4pp.*

Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejet të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritje reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundra-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, që në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli nën 60% të PBB.

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (6):

Në fund të vitit 2025 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i ulët se niveli që shënoi në vitin 2024 (*deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti*), specifikisht borxhi në vitin 2024 shënoi 54.2% ndërsa në fund të 2025 shënoi 52.9%. Rrjedhimisht, kjo pikë nuk është relevante për sa i takon planifikimeve në buxhetet pasuese.

Shënim: *Kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2025, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.*

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50%, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (7):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2025 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2025 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën e rreth 301 milionë LEK, e cila është një vlerë marxhinale, pa rëndësi relative, krahasuar me ndryshimet e pësuara përgjatë vitit (në ndryshimet ligjore, si dhe rezultatet faktike) të zërit të shpenzimeve kapitale totale, si dhe atij të huamarrjes totale neto. Pra, pjesa e dytë e kësaj pike (lidhur me përdorimin e këtyre të hyrave në rast arkëtimi) nuk gjen aplikim (nuk është relevante) në këtë rast.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (8):

Amendimet kryesore të ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2025, kanë nisur në fillim të katërmujorit të tretë 2024. Ndryshimet kryesore ligjore për TVSH-në, për tatimin mbi të ardhurat, për taksat kombëtare dhe për akcizat, i janë nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Këto ndryshime janë miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe më pas kanë vijuar procedurat e miratimit nga Kuvendi, me efekte që fillojnë nga viti 2025. Efektet e ndryshimeve fiskale përgjithësisht janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2025, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve ligjore të legjislacionit fiskal.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e defiçitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveç në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, që parashikohen në nenin 4/4 të këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit (9):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2025 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit 2025 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2025

Ligji Nr.115, dt 03.12.2024		AN. Nr. 3, Dt. 29.04.2025		AN. Nr. 6, Dt 11.06.2025		AN. Nr 10, Dt. 08.10.2025		AN. Nr 11, Dt. 19.12.2025	
Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)
68.0	162.3	68.0	163.3	68.0	158.8	61.6	164.1	61.6	157.0

Shënim: *Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit.*

Përcaktimi ligjor (10):

Neni 4/1, pika (5) i LOB sanksionon që duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk duhet të rezultojë më e vogël sesa zero, përveçse në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme që parashikohen në nenin 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (10):

Çdo ligj vjetor i buxhetit i hartuar dhe miratuar për vitin 2025 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Niveli i balancës primare i rezultuar në fund të 2025 është në përputhje të plotë me detyrimin ligjor të këtij neni/pike të LOB. Balanca primare gjatë vitit 2025 rezulton me një suficit prej 0.3 përqind e PBB ose 7,605 milionë LEK. Tabela më poshtë paraqet shifrat specifike të parashikuara sipas secilit ligj të buxhetit 2025.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2025

Ligji Nr.115, dt 03.12.2024	AN. Nr. 3, Dt. 29.04.2025	AN. Nr. 6, Dt 11.06.2025	AN. Nr 10, Dt. 08.10.2025	AN. Nr 11, Dt. 19.12.2025
500 milionë lekë	500 milionë lekë	500 milionë lekë	50 milionë lekë	50 milionë lekë

Shënim: *Kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit dhe është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit.*

Përcaktimi ligjor (11):

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i defiçitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme të parashikuara në nenin 4/4 të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni, si më poshtë:

a) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 30% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
b) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 55% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
c) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 80% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.*

Zbatimi i ligjit (11):

Gjatë vitit 2025, nuk janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm.

8.2 Shtojca 2 - Efektet e paketës fiskale 2025

Masat e politikave fiskale të parashikuar në këtë buxhet janë ligje tatimore të miratuara në paketat e mëparshme dhe që sjellin efekte në të ardhura në vitin 2025, si dhe të ardhura nga efekti i politikave buxhetore dhe konkretisht:

Masat	Efekti i parashik. i paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parash/Të ardhura të mbledhura	Faktorët	Efektet
Zbatimi i kalendarit të akcizës (2022–2026)	1.022 miliardë LEK	1.028 miliardë LEK	0.006 miliardë LEK	Ritja graduale e normave të akcizës	Ritja e të ardhurave doganore nga akciza dhe TVSH, ndikim total 1.028 miliardë LEK. • Në akcizë +857 milionë LEK. • Në tvsh në Import +171 milionë LEK.
Ndryshimet në Ligjin për Lojërat e Fatit dhe Kazinotë	2 miliardë LEK	0 miliardë LEK	-2 miliardë LEK	Mungesa akteve nënligjore.	Të ardhurat e parashikuara nuk u materializuan.
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore nga rritja e pagave	4.297 miliardë LEK	4.297 miliardë LEK	0 miliardë LEK	Reforma e dytë buxhetore e rritjes së pagave në Administratën Publike	Ritje e fondit të pagave nga faza e dyte e rritjes së pagave në administratën publike politika e pagave rritje kontributesh.
TAP nga rritja e pagave në administratën publike	2.002 miliardë LEK	2.002 miliardë LEK	0 miliardë LEK	Reforma e dytë buxhetore e rritjes së pagave në Administratën Publike	Ritje të ardhurash nga tatimi mbi pagat në sektorin publik
Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA/MTRS). Plani i veprimit për vitin 2025	15.96 miliardë LEK	19.64 miliardë LEK	3.68 miliardë LEK	Zbatimi i masave të planifikuara të strategjise për vitin 2025	Efekte +3.7 miliardë mbi parashikumin për vitin 2025

8.3 Shtojca 3 - Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2025, financoi 130 programe buxhetore dhe synonte realizimin e 1474 produkteve të 12 ministrive të linjës. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e institucioneve të pavarura, fondeve speciale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në 61 bashki dhe 12 qarqe. Në përgjithësi, evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministritë e linjës, ku nga 1474 produkte të planifikuara për vitin 2025, janë realizuar plotësisht 1000 produkte ose 67.8%, pjesërisht 258 produkte ose 17.5% dhe nuk janë realizuar vetëm 216 produkte ose 14.6%. Konkretisht:

Tabela 29 Treguesit kryesorë të performancës 2024, sipas ministrive të linjës

Nr	Ministria e Linjës	Produktet (në numër)			
		Planifikuar	Realizuar		
			Plotësisht	Pjesërisht	Pa realizuar
1	**Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit**	125	86	18	21
2	**Ministria e Bujqësise dhe Zhvillimit Rural**	128	83	22	23
3	**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**	434	358	18	58
4	**Ministria e Financave**	53	21	16	16
5	**Ministria e Arsimit**	151	88	62	1
6	**Ministria e Kulturës Turizmit dhe Sportit**	91	38	45	8
7	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale**	138	84	24	30
8	**Ministria e Drejtësise**	61	34	18	9
9	**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**	24	22	2	0
10	**Ministria e Brendshme**	88	77	8	3
11	**Ministria e Mbrojtjes**	129	82	10	37
12	**Ministria e Mjedisit**	52	27	15	10
	TOTALI	**1 474**	**1 000**	**258**	**216**

Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2025 për ministritë dhe institucionet qendrore (në 000/LEK)

Ministria/Institucioni	Viti 2025 Plan Fillestar	Viti 2025 Plan i Rishikuar	Viti 2025 Fakti	Viti 2024 Fakti	Shpenzime korrente v. 2025 Fakt/plan fillestar	Shpenzime Investime v. 2025 Fakt/plan fillestar	Realizimi Shpenzimeve TOTAL 2025 Fakt/plan fillestar 2025	Fakti 2025/ Fakti 2024
Presidenca	643,980	479,280	314,907	292,376	83%	11%	49%	108%
Kuvendi	2,051,167	1,992,094	1,781,085	1,712,398	89%	59%	87%	104%
Kryeministria	912,900	819,440	672,153	680,447	82%	3%	74%	99%
Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit *	51,764,980	56,696,106	56,105,548		110%	86%	108%	
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	14,603,848	16,007,754	14,835,068	13,012,165	115%	75%	102%	114%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	74,032,381	74,546,992	71,459,339	62,247,630	118%	94%	97%	115%
Ministria e Financave	11,060,087	10,332,504	9,508,607	10,192,868	82%	112%	86%	93%
Ministria e Arsimit *	61,387,997	62,674,783	59,433,212	55,020,590	98%	84%	97%	108%
Ministria e Kultures, Turizmit dhe Sportit *	6,568,874	7,977,102	7,514,582	60,252,651	137%	69%	114%	12%
Ministria e Shendetesise dhe Mireqenies Sociale	80,730,151	82,382,695	81,900,621	78,794,718	102%	96%	101%	104%
Ministria e Drejtesise	14,372,920	15,698,249	14,930,820	13,930,300	102%	117%	104%	107%
Ministria e Evropes dhe Puneve te Jashtme	3,874,300	3,810,800	3,526,656	3,364,950	82%	193%	91%	105%
Ministria e Brendshme	31,006,552	31,610,161	31,429,315	28,596,132	106%	58%	101%	110%
Ministria e Mbrojtjes	52,685,544	53,427,923	39,593,995	33,965,455	111%	44%	75%	117%
Sherbimi Informativ Shteteror	2,816,500	3,029,030	2,988,561	2,679,982	86%	640%	106%	112%
Drejtoria e Radio Televizionit	870,000	874,000	810,188	673,498	103%	19%	93%	120%
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	448,200	464,700	461,911	400,685	99%	115%	103%	115%
Akademia e Shkences	549,680	559,980	534,044	481,361	96%	181%	97%	111%
Kontrolli Larte i Shtetit	694,000	639,450	636,438	613,038	91%	121%	92%	104%
Ministria e Mjedisit *	2,966,907	2,308,570	2,141,026	2,155,571	90%	56%	72%	99%
Prokuroria e Pergjithshme	3,322,800	3,097,120	3,042,847	3,544,096	92%	82%	92%	86%
Këshilli I Lartë I Gjyqësor	6,159,959	5,182,980	4,731,473	4,734,658	83%	42%	77%	100%
Gjykata Kushtetuese	262,000	270,032	252,586	305,425	98%	72%	96%	83%
Agjensia Telegrafike Shqiptare	99,469	103,069	92,117	78,971	105%	0%	93%	117%
Këshilli I Lartë I Prokurorisë	211,583	211,733	199,466	199,960	97%	0%	94%	100%
Partite Politike	355,800	487,002	484,335	353,133	136%		136%	137%
Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Kri	2,369,613	1,480,420	1,351,504	1,224,100	63%	42%	57%	110%
Instituti Statistikes	1,022,100	996,328	980,585	962,727	93%	119%	96%	102%
Shkolla e Magjistratures	491,601	443,729	427,822	462,602	89%	57%	87%	92%
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	22,539,500	24,885,348	24,012,184	19,713,666		107%	107%	122%
Qendra Kombetare e Kinematografise	166,848	202,048	200,058	171,953	120%	53%	120%	116%
Institucionet e sistemit te drejtesise	642,600	556,069	526,061	1,228,703	85%	45%	82%	43%
Avokati i Popullit	196,909	197,159	177,253	176,904	92%	16%	90%	100%
Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	98,381	92,933	89,260	89,739	93%	0%	91%	99%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	532,107	3,972,369	3,328,004	584,792	822%	112%	625%	569%
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të	297,680	299,621	290,024	270,824	100%	85%	97%	107%
Autoriteti i Konkurences	124,250	138,000	121,172	102,718	100%	64%	98%	118%
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	18,550	18,650	13,248	13,237	75%	9%	71%	100%
Institucione te tjera Qeveritare *+	15,320,250	22,180,755	17,336,577	16,908,392	132%	70%	113%	103%
Mbeshtetje per Shoqerine Civile	135,675	135,775	128,797	128,101	95%	32%	95%	101%
Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mb	169,700	159,450	140,904	154,204	88%	0%	83%	91%
Komisioni I Prokurimit Publik	119,698	94,848	87,700	109,036	76%	22%	73%	80%
Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	74,850	75,050	72,727	70,196	97%	92%	97%	104%
Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	58,810	58,910	49,773	52,697	86%	9%	85%	94%
Autoriteti per te Drejten e Informimit	168,200	166,560	159,480	160,003	96%	75%	95%	100%
TOTALI	**468,999,901**	**491,837,571**	**458,874,028**	**420,867,651**	**105%**	**78%**	**98%**	**109%**

** Për këto ministri krahasimi i treguesve të vitit 2025 me ato të vitit 2024 nuk mund të bëhet pasi ka ndryshuar struktura programore e tyre, ndërsa MEI është një ministri e re e krijuar në vitin 2025.*

8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2025, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	445,013	22,300	400,953	18,614	396,053	18,161	89%	81%	99%	98%
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1,448,051	-	1,444,451	-	1,440,659	-	99%	-	100%	-
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	6,362,045	316,754	4,762,685	68,123	4,758,056	48,784	75%	15%	100%	72%
Financimi i huaj	-	158,000	-	108,000	-	124,718	-	79%	-	115%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	36,654,465	1,949,708	39,168,119	1,206,690	38,990,579	965,890	106%	50%	100%	80%
Financimi i huaj	-	852,000	-	2,002,600	-	2,295,076	-	269%	-	115%
Shërbime të Shëndetit Publik	4,637,287	382,000	4,237,583	284,308	4,192,606	241,158	90%	63%	99%	85%
Përkujdesja Sociale	27,246,590	205,938	28,540,171	140,398	28,327,375	101,506	104%	49%	99%	72%
Financimi i huaj	-	50,000	-	-	-	-				
Gjithsej	**76,793,451**	**3,936,700**	**78,553,962**	**3,828,733**	**78,105,328**	**3,795,292**	**102%**	**96%**	**99%**	**99%**
Gjithsej	**80,730,151**		**82,382,695**		**81,900,621**		**100%**		**99%**	

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale u rishikua në rritje për shpenzimet korente gjatë vitit 2025 me rreth 2.3%, duke u rritur nga 76.8 miliardë LEK në planin fillestar, në 78.6 miliardë LEK në planin e rishikuar. Ndërkohë, shpenzimet kapitale u rishikuan në ulje me rreth 2.7%, duke zbritur nga 3.94 miliardë LEK në planin fillestar në 3.83 miliardë LEK në planin e rishikuar për vitin 2025. Më konkretisht, për vitin 2025:

Programi **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor"** ka realizuar qëllimin, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor. Personeli shëndetësor u angazhua maksimalisht nëpërmjet vizitave në qendra shëndetësore. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivit, sa më poshtë:

- *Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve.*

Ky objektiv u realizua nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2025, është si më poshtë:

- ✓ *378,480 "Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes", me kosto faktike 2.9 miliardë LEK;*
- ✓ *7.3 milionë vizita në kuadër të "Mbulimit me kujdesin parësor", me kosto faktike 942 milionë LEK;*
- ✓ *455,849 individë të moshës 35 - 70 vjeç, kanë kryer kontrollin bazë (Chek-up), me kosto faktike 876 milionë LEK.*

Programi **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor"**, synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar. Gjatë vitit 2025 janë trajtuar në shërbimet me shtretër rreth 331,256 pacientë (rreth 9.2 mijë më shumë nga e njëjta periudhë e një viti më parë).

Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivave, sa më poshtë:

- *Ofrimi cilësor dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor.*
- *Adresimi me efektivitet i thirrjeve për urgjenca mjekësore në nivel qendror.*

Përgjatë vitit 2025, u kryen normalisht këto shërbime:

- ✓ *331,256 pacientë të shtruar në spitale, me kosto faktike rreth 31 miliardë LEK;*
- ✓ *212,151 seanca për trajtimin e pacientëve me dializë, me kosto faktike rreth 2.7 miliardë LEK;*
- ✓ *5,011,819 ekzaminime laboratorike, shoqëruar me kosto faktike 1.89 miliardë LEK;*
- ✓ *11,628 pacientë të trajtuar nga paketat spitalore të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë, kosto faktike 1.37mld LEK;*
- ✓ *1,444 pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike, me kosto faktike 1.14 miliardë LEK;*
- ✓ *143,437 raste të trajtuara nga njesite e urgjences mjekesore, me kosto faktike 294 milionë LEK;*
- ✓ *27,586 pacientë me radioterapi, me kosto faktike 136 milionë LEK;*
- ✓ *3,794 pacientë me katarakte, shoqëruar me kosto faktike 90 milionë LEK;*

- ✓ *15 pacientë nga paketat e transplanteve renale, me kosto faktike 26.7 milionë LEK;*
- ✓ *127 çifte u trajuan për procesin e riprodhimit mjekësor të asistuar në institucionet shëndetësore publike me kosto faktike totale 21.9 milionë LEK.*

Programi **"Shërbime të Shëndetit Publik"** ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Gjatë vitit 2025:

- ✓ *3,006 monitorime të situatave epidemilogjike, me kosto faktike rreth 2.9 miliardë LEK;*
- ✓ *24,513 kontrolle dhe inspektime, shoqëruar me kosto faktike 509 milionë LEK;*
- ✓ *476 inspektime të kryera nga Operatori i Kujdesit Shëndetësor në Spitale, Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendra Shëndetësore, me kosto faktike 310 milionë LEK;*
- ✓ *200,000 mijë fëmijë të vaksinuar të moshës 0-18 vjeç, me kosto faktike 191.7 milionë LEK;*
- ✓ *224,545 persona të vaksinuar me vaksinen e gripit sezonal, me kosto faktike 109 milionë LEK;*
- ✓ *4,736 gra të depistuara për kancerin e gjirit dhe 11,920 gra për kancerin e qafës së mitrës, me kosto faktike 28 milionë LEK.*

Programi **"Përkujdesi Social"** mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike. Gjatë vitit 2025, programi i përkujdesit social u rishikua në rritje duke mundësuar akordimin e një mbështetje financiare të menjehershme në fund të vitit për familjet që ishin përfituese. Më hollësisht, produktet e financuara nga programi përfshijnë:

- ✓ *95,784 "Persona me aftësi të kufizuar nga programi i aftësisë së kufizuar", me kosto faktike 18.6 miliardë LEK;*
- ✓ *50,631 "Familje dhe individë në nevojë përfitues nga skema e Ndihmës Ekonomike", me kosto faktike 5.3mld LEK;*
- ✓ *23,225 bebe kanë përfituar nga "Shpërblimi i lindjes", me një kosto faktike totale rreth 1.4 miliardë LEK;*
- ✓ *7,848 gra të papunësuara me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç kanë përfituar mbrojtje të veçantë nga shteti, me një kosto faktike prej 829 milionë LEK;*
- ✓ *242 persona "Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qëndrat rezidenciale publike", është realizuar me një kosto faktike prej rreth 478 milionë LEK;*
- ✓ *154 foshnje dhe fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit social, me kosto faktike 310mln LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2025 ishte 47.8% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.4 milard LEK) ose 80.1% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 dhe 228.3% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (2.4 miliardë LEK) ose 114.6% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime duke pakësuar fonde për projekte që nuk mund të realizoheshin gjatë vitit me financim të brendshëm dhe një rritje të rëndësishme për fondet me financim të huaj, përfshirë edhe disa rialokime. Janë mbyllur 8 projekte investimi në vlerën e 2.3 miliardë LEK, si më poshtë:

- ✓ *Rikonstruksion i godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe Obstetrikës dhe ndërtimin e dy godinave të reja në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", me vlerë kontrate 559.7 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksioni i shtëpizave të mbështetura në Spitalin Psikiatrik Vlorë, me vlerë 252.6 milionë LEK;*
- ✓ *Projekt i Bankës Botërore "Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë'', në të cilën janë mbyllur projektet si më poshtë:*
  - o *Spitali i Krujës i cili konsiston në "Rikonstruksion i plotë i ndërtesës, ndërtimi i strukturës dhe instalimi i një ashensori të ri për pacientët", me vlerë 371 milionë LEK;*
  - o *Spitali Rajonal Lezhë i cili konsiston në "Rikonstruksion i plotë i ndërtesës", me vlerë 321 milionë LEK;*
  - o *Spitali Kardiokirurgjisë në QSUT, "Rikonstruksion i plotë i ndërtesës", me vlerë 584.3mln LEK;*
  - o *Spitali Psikiatrisë në QSUT i cili konsiston në "Rikonstruksion i plotë i ndërtesës së Fëmijëve dhe shtesë kati për Godinën e pranimit dhe alkologjisë", me vlerë 140.6 milionë LEK;*
- ✓ *Furnizim Vendosje platforma automatike për gjenotipizimin e grupeve të gjakut për QKTGJ Tiranë, me vlerë 25 milionë LEK;*
- ✓ *Aparature Fibrogastroskpi komplet për shërbimin e patologjisë Sp Korçë, me vlerë 6.2 milionë LEK.*

8.3.2 Arsimi

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2025, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Arsimit paraqitet si më poshtë:

Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Arsimit (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,095,200	55,000	1,057,194	0	1,043,695	0	95%	0%	99%	-
Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	32,735,397	1,537,000	33,556,739	1,440,231	33,431,522	1,357,382	102%	88%	100%	94%
Arsimi i Mesem (i Përgjithshëm)	10,082,000	1,362,000	8,687,348	1,495,590	8,621,589	1,397,937	86%	103%	99%	93%
Arsimi Universitar	11,550,000	1,180,000	13,486,192	1,131,000	11,478,222	1,013,524	99%	86%	85%	90%
Financim i huaj		300,000		100,000		72,256		24%		72%
Fonde per Shkencen	841,400	350,000	1,168,153	252,336	602,715	227,654	72%	65%	52%	90%
Financim i huaj		300,000		300,000		186,716		62%		62%
Gjithsej sipas natyrës	56,303,997	5,084,000	57,955,626	4,719,157	55,177,744	4,255,468	98%	83%	95%	89%
Totali	61,387,997		62,674,783		59,433,212		97%		95%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Arsimit u rishikua në rritje gjatë vitit 2025 prej rreth 2% nëpërmjet akteve normative për rishikimin e buxhetit, duke arritur në 62.7 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 59.4 miliardë LEK, ose 95 % e planit të rishikuar.

Në programin **"Arsimi Bazë"** është ofruar shërbimi i mësimdhënies për 213,520 fëmijë në sistemin 9vj publik dhe rreth 56,928 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjec që ndjekin arsimin parashkollor publik apo përkatësisht 88% e fëmijëve në sistemin 9vj dhe 86% e fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjec ndjekin arsimin në institucionet publike. Vëmendje e veçantë i është kushtuar uljes së braktisjes shkollore; tërheqjes së fëmijëve romë/egjiptianë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përgjatë vitit 2025, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *35 000 nxënës që kanë vendbanimi mbi 2km nga shkolla si dhe 12,000 mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës, iu ofrua shërbimi i transportit me kosto faktike 1.2 miliardë LEK ose 96.5% e fondeve të miratuara për vitin 2025.*
- ✓ *Përfituan tekste shkollore falas për përdorim, të gjithë nxënësit nga klasa e parë në klasën e nëntë me efekt financiar rreth 1.2 miliardë LEK e fondeve të miratuara për vitin 2025.*
- ✓ *Nxënës me aftësi të veçanta janë mbështetur për mbulimin e shpenzimeve për bursa dhe kuotë ushqimore më një kosto prej 230.1 milionë LEK ose 86.7% e fondeve të miratuara për vitin 2025 si dhe janë mbështetur për të mbuluar shpenzimet për shërbimin arsimor me efekt financiar 26.6 milionë LEK ose 93.6% e fondeve të miratuara për 2025.*

Në programin **"Arsimi Mesëm i Përgjithshëm"**, janë 60,027 nxënës që u regjistruan dhe ndjekin arsimin e mesëm në institucionet arsimore publike apo 83% e nxënësve ndjekin arsimin e mesëm në institucionet publike. Gjatë 2025, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar si vijon:

- ✓ *Rreth 13 000 nxënës të grupeve sociale në nevojë kanë përfituar tekste mësimore falas, për vitin 2025, shoqëruar me kosto faktike 119.4 milionë LEK.*
- ✓ *2 641 mësuesve të AML ju ofrua shërbimi i transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin për vitin 2025, shoqëruar me kosto faktike 74.6 milionë LEK.*
- ✓ *Realizimi i veprimtarisë së maturës shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare dhe ndërkombëtare për 26,774 nxënës me kosto faktike 24.99 milionë LEK.*

Në programin **"Arsimi Universitar",** gjatë vitit 2025, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cënuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar, numri i studentëve në ciklin e parë të studimeve në IAL publike është rreth 59,260 dhe rreth 21,738 studentë që ndjekin ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në IAL publike.Përgjatë vitit 2025, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *11 000 studentë kanë përfituar bursa dhe mbështetje financiare për akomodim në shtëpitë e studentëve me një kosto vjetore 794 milionë LEK.*
- ✓ *7 000 studentë kanë përfituar akomodim në një nga tetë "Shoqërite e Trajtimit të Studentëve në Tiranë dhe në Rrethe" me efekt financiar për vitin 2025 prej 285 milionë LEK.*
- ✓ *350 studentë të shkëlqyer që studiojnë në programet prioritare me efekt financiar për vitin 2025 prej 150mln LEK.*

Në programin **"Kërkimi Shkencor"** synohet integrimi i kërkimit shkencor shqiptar në hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA). Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2025, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *U financuan rreth 3 500 kërkues për kërkime fondamentale në masën 146 milionë LEK për vitin 2025.*
- ✓ *U zhvilluan 10-15% më shumë projekte bashkëpunimi të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare në krahasim me një vit më parë me kosto faktike rreth 29 milionë LEK.*

Sa u përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2025 ishte 85.4% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (4 milard LEK) (92.5% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025) dhe 36.1% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.22 miliardë LEK) (55.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime, duke shkurtuar fonde për projekte të cilat nuk mund të realizoheshin gjatë vitit. Janë mbyllur 73 projekte investimi në vlerën e rreth 4 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Ndërtim i shkollës "22 Tetori", Bashkia Berat, me vlerë rreth 355.2 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i gjimnazit "Sali Nivica" dhe ambientet sportive në B.Memaliaj me vlerë 175.1milionë LEK;*
- ✓ *Ndërtimi i shkollës "Jonuz Sali Çarçiu", Bashkia Elbasan, me vlerë rreth 139.3 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i shkollës "Meleq Gostnishti", Bashkia Përmet, me vlerë rreth 117 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i gjimnazit "Skënderbeu", Bashkia Has, me vlerë rreth 113.4 milionë LEK*
- ✓ *Rehabilitim i shkollës "Avni Rustemi", Bashkia Kukës, me vlerë rreth 107 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion e shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Bashkia Pogradec, me vlerë 107milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Rilindja", Bashkia Gramsh, me vlerë rreth 105.5 milionë LEK;*
- ✓ *Rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të shkollës 9-vjeçare Bashkia Finiq, me vlerë rreth 100mln LEK;*
- ✓ *Pajisje mobileri arsimi bazë, me vlerë rreth 100 milionë LEK;*
- ✓ *Pajisje laboratorike,Fizike-Kimi-Bilogji, arsimi i mesëm i përgjithshëm, me vlerë rreth 95.5 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja e Malësisë", Bashkia Tropojë, me vlerë rreth 85.2mln LEK;*
- ✓ *Pajisje mobilerie arsimi i mesëm i përgjithshëm, me vlerë rreth 65.8 milionë LEK.*

8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e MBZHR, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim menaxhim administrimi	521,516	55,000	506,816	7,000	489,412	5,711	94%	10%	97%	82%
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	2,224,540	200,000	2,666,144	182,675	2,632,577	178,890	118%	89%	99%	98%
Financim i huaj	-	158,000	-	106,123	-	105,777	-	67%	-	100%
Mbështetje për peshkimin	215,664	100,000	179,864	89,546	175,304	88,034	81%	88%	97%	98%
Financim i huaj	-	211,423	-	7,108	-	99	-	0%	-	1%
Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes	991,476	1,890,000	1,076,518	2,355,045	1,044,828	2,285,452	105%	121%	97%	97%
Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë,	5,031,409	643,363	6,954,325	489,047	6,112,334	468,262	121%	73%	88%	96%
Financim i huaj	-	1,569,408	-	597,408	-	513,527	-	33%	-	86%
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	707,049	50,000	722,710	42,155	700,107	17,039	99%	34%	97%	40%
Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	25,000	10,000	18,000	7,270	17,715	0	71%	-	98%	0%
Gjithsej sipas natyrës	**9,716,654**	**4,887,194**	**12,124,377**	**3,883,377**	**11,172,277**	**3,662,790**	**115%**	**75%**	**92%**	**94%**
Totali	**14,603,848**		**16,007,754**		**14,835,067**		**102%**		**93%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u rishikua me rritje (prej 9.6%) gjatë vitit 2025. Nëpërmjet rishikimeve të buxhetit janë reduktuar shpenzimet kapitale (-20.5%) dhe janë rritur shpenzimet korente (+20.7%). Realizimi faktik ishte 14.8 miliardë LEK ose 102% e buxhetit fillestar dhe 93% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korente ishte 92% dhe investimeve 94% e planit të rishikuar.

Në programin **"Zhvillimi Rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë",** me kosto faktike 6.1 miliardë LEK (ose 121% e planit fillestar të programit dhe 88% e të rishikuarit), është mundësuar:

- ✓ *17,050 aplikantë kanë aplikuar në skemat kombëtare, 52,828 aplikantë kanë aplikuar në skemën mbështetëse me naftë për bujqësinë si dhe 403 aplikime për skemën e investimeve;*
- ✓ *Fondi për masat mbështetëse për vitin 2025, arriti në rreth 6.3 miliardë LEK në total, (nga 4.4 miliardë LEK të planifikuar në fillim të vitit), pra pati një rritje të ndjeshme;*
- ✓ *15,373 përfitues rezultuan nga skema kombëtare, 50,062 përfitues rezultuan nga skema e subvencionimit të naftës për bujqësinë si dhe 200 përfitues rezultuan nga skema e investimeve;*
- ✓ *106 mostra të duhanit janë degustuar dhe janë analizuar 164 puro/duhan i grirë dhe cigare të gjeneratës së re, me kosto faktike 35.4 milionë LEK;*
- ✓ *302 njësi vreshti të reja dhe 12,551 njësi ulliri janë regjistruar, me kosto faktike 27.1 milionë LEK;*
- ✓ *Janë promovuar bizneset dhe produktet shqiptare në 11 aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, me kosto faktike 13.4 milionë LEK.*

Në programin **"Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit",** janë realizuar produkte me kosto faktike 2.6 miliardë LEK (ose 118% e planit fillestar të programit dhe 99% e të rishikuarit), ndër to janë përfshirë:

- ✓ *178,814 krerë gjedhë janë gjurmuar për Tuberkulozin dhe Brucelozën, me kosto faktike 1.2 miliardë LEK;*
- ✓ *105,769 inspektime të zhvilluara në kuadër të menaxhimit të riskut në fushën e sigurisë ushqimore, me kosto faktike 778.2 milionë LEK;*
- ✓ *373,370 kampione janë analizuar nga ISUV, kampione të dërguara nga veterinerët zyrtar, inspektorët e AKU dhe operatorët e biznesit të cilët eksportojnë drejt vendeve të BE-së dhe më gjerë, me kosto faktike 325.3 milionë LEK;*
- ✓ *630,443 krerë kafshë janë vaksinuar, nga të cilat 503,507 krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Brucelozës dhe 126,936 krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Plasjes, me kosto faktike 102.3 milionë LEK;*
- ✓ *Rreth 67 milionë fidanë perimor, frutorë, dekorativ dhe fara patate, foragjerë e misër janë testuar dhe certifikuar, me kosto faktike 35.5 milionë LEK;*
- ✓ *1,384 inspektime dhe mbikëqyrje në terren nga Drejtoria e Mbrojtjes të Bimëve dhe Drejtoria e Veterinarisë, me kosto faktike 24 milionë LEK;*
- ✓ *286 analiza të cilat kanë qenë për të përcaktuar fuqinë mbirëse, testin e pastërtisë, testin e lagështirës si dhe analiza në kuadër të vetëkontrollit.*

Në programin "**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**", janë realizuar produkte me kosto faktike 1 miliardë LEK (ose 105% e planit fillestar të programit dhe 97% e të rishikuarit), përfshirë:

- ✓ *70,000 ha "Përmirësim i kullimit me ngritje mekanike (hidrovore) dhe rritja e sigurisë nga përmbytjet, me kosto faktike 281.8 milionë LEK;*
- ✓ *65,000 ha "Pastrim i infrastrukturës kryesore kulluese", me kosto faktike 268.4 milionë LEK;*
- ✓ *21 kanale kryersore ujitëse janë mirëmbajtur dhe kanë furnizuar me ujë rrjetin sekondar që ujit rreth 100,000 ha kryesisht në zonat Peqin, Kavajë, Lushnje, Fier, Divjakë dhe Shkodër, me kosto faktike 79.5 milionë LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 103.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (3 milard LEK) ose 95.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025, si dhe 31.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.62 miliardë LEK) ose 87.2 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit duke rritur fondet për projekte me financim të brendshëm dhe pakësuar fondet me financim të huaj. Janë mbyllur 45 projekte investimi në vlerën e rreth 1.9 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ Në programin "**Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit"** kanë përfunduar 2 kontrata me vlerë 86.3 milionë LEK si më poshte:
  - *Fuqizim i kapaciteve laboratorike të ISUV në të tre fushat ku ushtron aktivitetin e tij analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh, në vlerën e 81.3 milionë LEK;*
  - *Rikonstruksion i zyrave të DRVMB Vlorë, në vlerën e rreth 5 milionë LEK.*
- ✓ Në programin e ***Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe Ujitjes*** kanë përfunduar 28 projekte me vlerë të plotë investimi prej rreth 1.4 miliardë LEK, ku veçojmë kontratat e mëposhtme:
  - *Rehabilitimi i ushqyesit te rezervuarit të Bllacës dhe rehabilitimi i rezervuarit të Bllaces (burimi ujor), në vlerë 257.3 milionë LEK;*
  - *Blerje eskavatorë, në vlerë 161 milionë LEK;*
  - *Riparim i argjinaturës Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint, në vlerë 105 milionë LEK;*

- *Rehabilitimi i Kanalit Kryesor Ujitës Llakatund,Vlorë, në vlerë 94.3 milionë LEK;*
- *Rikonstruksion hidrovori Grethe, në vlerë 90.3 milionë LEK;*
- *Argjinatura Mbrojtëse nga lumi Shkumbin në Fatisht, Bashkia Peqin, në vlerë 89 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga permbytja e lumit Osum në Havales , Bashkia Berat, në vlerë 64.5 milionë LEK;*
- *Ndërtimi i shkarkuesve të rinj në Kanalin Kryesor Ujitës Peqin-Kavajë, në vlerë 59 milionë LEK;*
- *Rikonstruksion i kanalit vaditës të Allanit, Dorëz-Gizavesh-Librazhd Qendër, në vlerë 56.7mln LEK;*
- *Mbrojtja lumore nga gërryerjet në lumin Erzen, Ibe e Poshtme (fshati Shkallë), në vlerë 55.7mln LEK.*

✓ Në programin "**Këshillimi i Informacionit Bujqësor**" kanë përfunduar 14 projekte me vlerë 11.1mln LEK.

- *Rikonstruksion çatie nga QTTB Fushë-Krujë, në vlerë 2.6 milionë LEK;*
- *Ndërtimi i linjës për furnizimin me energji elektrike, stacioni i pompave të ujitjes për 1.9milionë LEK;*
- *Agregatë bujqësorë të blera nga QTTB Lushnjë, në vlerë 1.4 milionë LEK;*
- *Studim Projektim për projekti "Rrethim i Bazës Eksperimentale në QTTB Vlore", në vlerë 1mln LEK.*

✓ Në programin "**Mbështetje për Peshkimin**" ka përfunduar 1 projekt:

- *Implementimi i sistemit ERS, në vlerë 70 milionë LEK.*

8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të MIE, paraqitet si më poshtë:

Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	740,244	13,000	1,271,191	9,000	1,258,418	0	170%	0%	99%	0%
Mbështetje per Energjinë	120,520	250,000	46,134	448,700	45,236	437,191	38%	175%	98%	97%
Financim i Huaj		3,000,000		1,563,000		1,248,902		42%		80%
Mbështetje për Burimet Natyrore	349,605	97,000	306,728	139,406	299,555	138,931	86%	143%	98%	100%
Mbështetje për Industrinë	375,733	78,000	385,049	18,750	379,994	18,750	101%	24%	99%	100%
Transporti Rrugor	3,660,122	26,236,699	4,722,736	34,560,900	4,602,108	34,355,775	126%	131%	97%	99%
Financim i Huaj		3,588,323		5,037,021		2,765,604		77%		55%
Transporti Detar	178,330	14,795,000	144,154	27,224	142,519	15,893	80%	0%	99%	58%
Financim i Huaj		10,000		5,334		4,148		41%		78%
Transporti Hekurudhor	537,500	550,000	515,753	525,000	515,610	510,215	96%	93%	100%	97%
Financim i Huaj		4,992,702		2,619,704		2,249,351		45%		86%
Transporti Ajror	25,550	2,000	29,726	7,001,958	29,538	7,001,688	116%	350084%	99%	100%
Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	70,000	0	0	0	0		0%		
Planifikimi Urban	97,973	104,000	87,094	52,058	82,390	39,083	84%	38%	95%	75%
Furnizimi me uje dhe kanalizime	620,470	13,539,610	566,703	14,463,669	553,211	14,765,229	89%	109%	98%	102%
Gjithsej sipas natyrës	**6,706,047**	**67,326,334**	**8,075,268**	**66,471,724**	**7,908,580**	**63,550,759**	**118%**	**94%**	**98%**	**96%**
Totali	**74,032,381**		**74,546,992**		**71,459,339**		**97%**		**96%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë fillestar u rishikua në rritje gjatë vitit 2025 prej rreth 1% nëpërmjet akteve normative për rishikimin e buxhetit, duke arritur në 74.5 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 71.5 miliardë LEK, ose 96 % e planit të rishikuar.

Në programin "Transporti Rrugor" sipas objektivave të përgjithshme të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, ka vijuar puna për zhvillimin më tej të sistemit kombëtar të transportit, përmirësimin e qëndrueshmërisë, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin, mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standarteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm si dhe përfundimin e akseve të Koridorit VIII dhe të Koridorit Blu, të cilat janë në listën e Projekteve Strategjike Kombëtare.

Në këtë kuadër, qëllimi i politikës së programit është:

- *Të krijojë parakushtet për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë;*
- *Të rrisë aksesin e mallrave dhe udhëtarëve në tregti dhe ofrimin e shërbimeve;*
- *Të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e përgjithshme dhe zhvillimin e ekonomisë;*
- *Rehabilitimin dhe mirëmbajtjen, për të ruajtur investimet e realizuara në infrastrukturën rrugore.*

Ky qëllim është realizuar nëpërmjet treguesit të performancës "*Rritja e standarteve dhe mirëmbajtja e rrjetit kombëtar rrugor"*, ku për vitin 2025 janë administruar dhe mirëmbajtur 3,522 km rrugë nëpërmjet 52 kontratave të mirëmbajtjes, me kosto 3.9 miliardë LEK apo 97% e fondeve të planifikuara. Përkatësisht u relizuan:

- ✓ 1*,400 km rrugë primare që mirëmbahen me 4 kontrata mirëmbajtje,*
- ✓ *2,122 km rrugë sekondare që mirëmbahen me 48 kontrata mirëmbajtje.*

Për programin "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime", për të mundësuar ofrimin e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare u realizuan shpenzime në masën 15.3 miliardë LEK apo 98% e planit të rishikuar, ose 17% më shumë se një vit më parë. Qëllimi i politikës së programit është realizuar nëpërmjet përmbushjes së objektivit i cili synon z*gjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve*, ku, për vitin 2025 është realizuar furnizimi me ujë të pijshëm mestarisht për 18 orë në ditë.

Produktet që kanë kontribuar në realizimin e objektivit përgjatë vitit 2025, paraqiten të renditura sa më poshtë:

- ✓ *488,207 ml ndërtim rrjet ujësjellësi dhe rikonstruksion rrjeti apo 95% e sasisë sipas planit të rishikuar*.
- ✓ *29,718 ml ndërtim rrjet kanalizimi dhe ITUN dhe rikonstruksion rrjeti, apo 92% e sasisë sipas planit të rishikuar.*

Për programin **"Mbështetje për Burimet Natyrore"**, është realizuar qëllimi i programit lidhur me realizimin e politikave të promovimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe transparencës në fushën e gjeologjisë, minierave, ambientit dhe ujërave. Në këtë kuadër:

- ✓ *U akorduan 415 leje për shfrytëzimin e burimeve minerare, metalore e jo metalore, me kosto faktike 21.2mln LEK.*
- ✓ *U realizua studimi mbi azhornimin gjeohapsinor të hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi minerar nëntokësor, me kosto faktike 13milionë LEK.*
- ✓ *Kryer monitorimi i Fenomeneve të post shfrytezimit në minierat e mbyllura, me kosto faktike 9.9milionë LEK.*
- ✓ *Janë përditësuar 568 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinore (100% e sasisë së planifikuar), për 6.5mln LEK.*
- ✓ *Realizuar promovimi i minerave të rinj dhe kërkimeve teknologjike e mjedisore, me kosto faktike 6mln LEK.*
- ✓ *Realizuar studimi mbi zonimin minerar dhe hartimit të planit vjetor dhe 3-vjecar minerar, kosto faktike 6mln LEK.*
- ✓ *U realizua raporti vjetor i gjendjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji, me kosto faktike 6milionë LEK.*

Në programin **"Mbështetje për Energjinë"** u realizuan fonde në masën 1.7 miliardë LEK me qëllim krijimin dhe mbështetjen e sektorit energjitik për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjitike me kosto minimale. Në këtë kuadër, është rritur përdorimi i energjisë së rinovueshme në masën prej 40%. Projektet kyç të realizuara përfshijnë:

- ✓ *Kryerjen e studimit mbi vlerësimin e efiçencës së përdorimit të burimeve energjitike hidrokarbure në sektorin e transportit referuar zhvillimeve teknologjike, shoqëruar me kosto faktike 2 milionë LEK për vitin 2025.*

Për sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 101.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (54.2 miliardë LEK) ose 99.2% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025, si dhe 67.8% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (9.4 miliardë LEK) ose 79% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit 2025 duke rritur fondet për projekte me financim të brendshëm dhe duke pakësuar fondet për projekte me financim të huaj. Janë mbyllur projektet e investimit si më poshtë, ku veçojmë:

Transporti rrugor janë financuar plotësisht 21 projekte investimi me vlerë totale rreth 23.1 miliardë LEK ku ndër më kryesoret përmendim:

- ✓ *Ndërtim i Unazës së jashtme Tirane, Loti 7 me vlerë 2.7 miliardë LEK;*
- ✓ *Plotësim, rakordim e vazhdim punime Sh.Shqiponja-Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT për 2.7mld LEK;*
- ✓ *Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza III) me vlerë 2.5 miliardë LEK;*
- ✓ *Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4 me vlerë 2.4 miliardë LEK;*
- ✓ *Ndërtim i segmentit Sheshi Shqiponja - Bulevardi i ri -Shkozë, Urat mbi lumin Tirana, 2.4mld LEK;*
- ✓ *Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 5 me vlerë 2.2 miliardë LEK;*
- ✓ *Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 6 me vlerë 2.1 miliardë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelce me vlerë 1.4 miliardë LEK;*

- ✓ *Sistemim asfaltim rruga Ura e Cerenecit - Peshkopi (Peshkopi - Maqellare), Loti 3 me 1.4mld LEK;*
- ✓ *Sistemim asfaltim rruga Qafa e Buallit - Martanesh me vlerë 1.1 miliardë LEK;*
- ✓ *Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve, Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi pallati me shigjeta rrethrrotullimi Shqiponja Loti 3 me vlerë 539.2 milionë LEK;*
- ✓ *Plotësim i punimeve në segmentin rrugor Qukës - Qafë - Plloce Loti 0 me vlerë 295.5 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelce, modifikim kontrate me vlerë 279.4 milionë LEK.*

Programi ***"Ujësjellës kanalizime"*** janë financuar 81 projekte investimi me vlerë rreth 16.1mld LEK, ku veçojmë:

- ✓ *Rikonstruksion i ujësjellësit në 15 fshatrat e njësisë Administrative Novoselë, me vlerë 875mln LEK;*
- ✓ *Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik, Draleos, Drimadhes dhe Dhermi.Faza I, me vlerë 816 milionë LEK;*
- ✓ *Furnizimi me ujë për zonat bregdetare, nj.administrative Shenkoll, B.Lezhë, me vlerë 786.3mln LEK;*
- ✓ *Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Fruti Kulturës, Valias i Vjetër ,Bashkia Kamëz, me vlerë 595 milionë LEK;*
- ✓ *Ndërtim linje transmetimin rrjeti jashtem ujësjellësi Rajonal (nga Burimi i Poçemit), me 568.4mln LEK;*
- ✓ *Rikonstruksioni i nyjes hidroteknike në rezervuarin e Maskurisë,), me vlerë 527 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh, me vlerë 498 milionë LEK;*
- ✓ *Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të bashkise Divjakë dhe njësisë administrative Remas Loti I-njësisë administrative Remas, me vlerë 496 milionë LEK;*
- ✓ *Ndërtimi i linjës së dërgimit Depo Lis, Burrel, Faza II, me vlerë 484 milionë LEK;*
- ✓ *Furnizimi me ujë të zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik, Draleos, Drimadhes dhe Dhërmi të Bashkisë Himarë Faza II, me vlerë 426 milionë LEK;*
- ✓ *Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Drenoce, Belishovë, Belistan e Visokë, B.Mallakaster, për 422mln LEK;*
- ✓ *Impiant i Trajtimi i Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Drimadhe, Dhërmi, me vlerë 400 milionë LEK.*

8.3.5 Kultura dhe Turizmi

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2025 për Ministrinë e Turizimit, Kulturës dhe Sportit për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Programi buxhetor	Plani fillestar		Plani i rishikuar 2025		Fakti 12M 2025		Realizimi ne % me planin fillestar		Realizimi ne % me planin e ndryshuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	446,979	0	555,177	0	524,495	0	117%	0%	94%	0%
Trashegimia Kulturore dhe Muzete	846,878	272,500	847,415	278,085	790,354	175,667	93%	64%	93%	63%
Financimi i huaj	-	20,000	-	23,000	-	22,424	-	112%	-	97%
Arti dhe Kultura	1,521,563	1,467,500	1,622,628	1,430,500	1,590,254	1,283,353	105%	87%	98%	90%
Financimi i huaj	-	20,000	-	5,000		0	-	0%	-	0%
04760 Zhvillimi i Turizmit	918,000	90,000	909,620	22,205	904,970	705	99%	1%	99%	3%
Financimi i huaj	-	-	-	5,000	-	0	-	-	-	0%
08140 Zhvillimi i sportit	412,100	200,000	2,008,200	2,818	1,976,626	2,818	480%	1%	98%	100%
Financimi i huaj	-	20,000	-	0	-	0	-	0%	-	0%
08610 Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët	233,354	50,000	220,454	47,000	212,946	29,970	91%	60%	97%	64%
Financimi i huaj	-	50,000	-	0	-	0	-	0%	-	0%
Gjithsej sipas natyrës	**4,378,874**	**2,190,000**	**6,163,494**	**1,813,608**	**5,999,645**	**1,514,937**	**137%**	**69%**	**97%**	**84%**
Totali	**6,568,874**		**7,977,102**		**7,514,582**		**114%**		**94%**	

Buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit gjatë vitit 2025 u rishikua në rritje (prej 23%), ose 1.48 miliardë LEK në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm. Realizimi faktik ishte 7.5 miliardë LEK, ose 114% e buxhetit fillestar dhe 94% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve ishte 5.99 miliardë LEK. Realizimi përkundrejt planit fillestar ishte 137% për shpenzimet korente dhe 69% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar, realizimi ishte rreth 97% për shpenzimet korente dhe 84% për investimet.

Programi **"Arti dhe Kultura"** ka për qëllim, edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenes artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike. Fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën 3 miliardë LEK, nga 2.9 miliardë LEK të parashikuara në planin fillestar. Për 12-mujorin 2025 fondet në shpenzimet korente janë realizuar në vlerën 1.59 miliardë LEK, ose në masën 105 % të buxhetit të akorduar në fillim të vitit dhe 98% të planit të ndryshuar. Kështu gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- ✓ *248 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar, me kosto faktike 611 milionë LEK;*
- ✓ *269 projekte/programe mbështetje të skenës së pavarur (95% e sasisë së planifkuar), për 275mln LEK;*
- ✓ *79 aktivitete për qytetarët përdorues e frekuentues të koleksioneve bibliotekare ose 47.5% e sasisë së planifikuar, me kosto faktike 144.6milionë LEK;*
- ✓ *93 subjekte përfituese në javët kulturore të huaja në Shqipëri, me kosto faktike 141.4mln LEK;*
- ✓ *158 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit teatror klasik dhe bashkëkohor ose 89% e sasisë së planifikuar, me kosto faktike 135milionë LEK;*
- ✓ *157 veprimtari artistike ne zhanrin e cirkut dhe eksperimentimin e formave te reja te shprehjes skenike bashkekohore, me kosto faktike 67.9milionë LEK;*
- ✓ *190 akivitete për veprimtari edukuese të teatrit me dhe për fëmijë ose 95% e sasisë së planifkuar, me kosto faktike 56.9milionë LEK;*
- ✓ *332 premiera e shfaqje artistike të zhanrit teatror eksperimental klasik/bashkekohor, për 52.9mln LEK;*
- ✓ *5 ekspozita me vepra pjesë e fondit të GKA, të përkohshme të traditës dhe bashkëkohore, autorë të diasporës dhe të huaj, me kosto faktike 49.6milionë LEK;*
- ✓ *12 aktivitete për promovimin e krijimtarisë letrare (100% e sasisë së planifkiuar), për 32mln LEK;*
- ✓ *155 aktivitete në kuadër të veprimtarive promovuese të materialeve filmike, pjesë e fondit të kinematografisë shqiptare dhe asaj të huaj (97% e sasisë së planifikuar), me kosto faktike 22.2mln LEK.*

Në programin **"Trashëgimia Kulturore",** i cili ka qëllim "Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale, jomateriale dhe muzeve, duke synuar ne realizimin e objektivit "Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peisazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara. Fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 1.12 miliardë LEK, nga 1.11 miliardë LEK të parashikuara në planin fillestar. Për 12-mujorin 2025 fondet në shpenzimet korente janë realizuar n vlern 790 milionë LEK, ose në masën 93% të buxhetit të akorduar në fillim të vitit dhe të planit të ndryshuar. Realizuar produktet si më poshtë:

- ✓ *Me një kosto rreth 372.6 milionë LEK, janë ruajtur dhe mirëmbajtur 2 340 objekte monumente kulture;*
- ✓ *Janë mirembajtur 12 muze të vizitueshëm nga publiku me kosto faktike 237.8 milionë LEK;*
- ✓ *Janë zhvilluar 265 aktivitete edukuese/promovuese mbi trashëgiminë kulturore, nga 270 të planifikura, ose 98% e sasisë së planifikuar me kosto faktike 153 milionë LEK;*
- ✓ *Eshtë realizuar produkti "Trashëgimia materiale e jo materiale e inventarizuar", me nr.16 810 kartelash, me kosto faktike 16 milionë LEK.*

Në programin **"Zhvillimi i Sportit"** synohet mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit për cdo disiplinë sportive dhe aktivizimi i Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare me fokus te të rinjtë. Në këtë kuadër, për vitin 2025:

- ✓ *Janë financuar 36 Federata Olimpike dhe jo-Olimpike që marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare, me kosto totale 1.38 miliardë LEK;*
- ✓ *Janë zhvilluar 150 Aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të të gjitha disiplinave, në përputhje me kalendarin sportiv kombëtar dhe ndërkombëtar, me kosto faktike 378.3 milionë LEK;*
- ✓ *Janë zhvilluar programe trajnuese në sistemin sportiv kombëtar, në funskion të rritjesë së kapaciteteve në fushën e sportit, me synimin për të trajnuar çdo vit 20-50% të stafit teknik të sistemit sportiv kombësysar (732 teknikë, specialistë, instruktorë, mjekë), me prioritet për sportistët dhe trajnerët gra, me kosto faktike 128.5 milionë LEK;*
- ✓ *Shpërblyer 28 sportistët elitarë dhe trajnerët medaliste për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, kosto faktike 51.2 milionë LEK.*

Në programin "**Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët**", qëllimi i politikës i së cilit është mbështetja dhe nxitja e inovacionit rinor, rritja e aftësive dhe profesionalizimit përmes edukimit cilësor, pjesëmarrjes aktive në jetën qytetare, sociale, politike, fondet në shpenzimet korente janë realizur në masën 212.9 milionë LEK ose 97% e planit vjetor të rishikuar dhe 91% e planit fillestar. Gjatë 12M 2025 janë realizuar produktet:

- ✓ *Janë realizuar 480 aktivitete në kuadër të Planit Kombëtar për Rininë i zbatuar, me kosto faktike 196.6 milionë LEK;*
- ✓ *480 studentë kanë marrë pjesë në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, program i relalizuar me kosto faktike 16.3 milionë LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 83.8% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025, për projektet me financim të brendshëm (1.5 miliardë LEK) dhe 68.0% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025, për projektet me financim të huaj. Janë mbyllur 6 projekte të investimit me vlerë 0.016 miliardë LEK, ku nga të cilat veçojmë:

- ✓ Për programin "*Arti dhe Kultura*" kanë përfunduar 3 projekte me vlerë totale 139.6mln LEK, konkretisht:
  - *Rivitalizimi i Sallës qëndrore të Pallatit të Kulturës Shefqet Doda, rikonstruksioni i Galerisë së Arteve Tahir Tahiraj dhe mobilimi i bibliotekës Pjetër Budi, Bashkia Mat, me vlerë 59.6mln LEK;*
  - *Rikonstruksioni Pallatit të Kulturës "Artan Cuku" (Hidroizolimi i tarracës dhe riparimi i fasadës)", me vlerë rreth 50 milionë LEK;*
  - *Instalimi i sistemit të Kondicionimit "Teatri Migjeni, me vlerë rreth 30 milionë LEK;*
- ✓ Për programin "*Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë*" kanë përfunduar 3 projekte me vlerë 20.3mln LEK, konkretisht:
  - *Nderhyrje emergjente dhe restauruese, Konservimi dhe restaurimi I kullave dhe kurtinave midis tyre, Kalaja e Beratit (segmenti 12-12), me vlerë rreth 5.7 milionë LEK;*
  - *Restaurim i objektit Muzeu Kombetar i Fotografise Marubi, me vlerë rreth 1 milionë LEK;*
  - *Rikonstruksioni Muzeu Arkeologjik Korce, me vlerë rreth 13.6 milionë LEK;*
- ✓ Për programin "*Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët*", janë financuar në vlerë 47 milionë LEK projekte për: Ndërtim infrastrukture aventuriere për të rinjtë, Qendra Rinore Dixhitale për aftësitë e rinisë dhe punësimit- Digital Youth Hub, biblioteka, YOUTech- Qendra Rinore të Teknologjisë dhe Inovacionit, Rikonstruksioni i Qendrës Rinore etj.

8.3.6 Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit paraqitet si mëposhtë:

Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Mjedisit

Emertimi I Programit	Plani Fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 12 Mujori I 2025		Realizimi ne % me planin fillestar		Realizimi ne % me planin e ndryshuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	341,727	3,000	328,241	4,000	317,697	861.0	93%	29%	97%	22%
Administrimi i Pyjeve	538,450	541,100	511,404	602,985	492,831	599,515	92%	111%	96%	99%
Financimi I huaj	-	-	-	1,000	-	-	-	-	-	0%
Programet e mbrojtjes së mjedisit	476,770	90,000	439,665	55,220	413,796	18,213	87%	20%	94%	33%
Financimi i huaj	0	390,000	0	216,000	0	150,953	-	39%	-	70%
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	56,113	329,747	53,163	96,892	50,905	96,256	91%	29%	96%	99%
Financimi i huaj	-	200,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej sipas natyres	**1,413,060**	**1,553,847**	**1,332,473**	**976,097**	**1,275,229**	**865,798**	**90%**	**56%**	**96%**	**89%**
Totali	**2,966,907**		**2,308,570**		**2,141,027**		**72%**		**93%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Mjedisit u rishikua në ulje 22%, ose 658.3 milionë LEK më pak. Realizimi faktik ishte rreth 2.14 miliardë LEK ose 72% e buxhetit fillestar apo 93% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korente ishte 1.27 miliardë LEK, 90% e planit fillestar apo 96% e planit të rishikuar.

Në programin "**Mbrojtja e Mjedisit**" për vitin 2025, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për shpenzimet korente janë realizuar në masën 413.7 milionë LEK, ose 94% kundrejt fondeve vjetore te rishikuara, ose 87% e planit fillestar. Në realizimin e qëllimit të programit, i cili lidhet me "Përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit", kanë kontribuar produktet si më poshtë:

- ✓ *644 inspektime për parandalimin e përkeqësimit të shfrytëzimit pa kriter të burimeve ujore, të ndotjes se ujit, ajrit dhe tokës me ndikim në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, ajrit, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit me kosto faktike 260 milionë LEK;*
- ✓ *3 840 raporte monitorimi për mjedisin, ose 91% e sasisë plan, me një kosto faktike prej 83.8 milionë LEK;*
- ✓ *794 dosje të shqyrtuara për leje Mjedisi të tipit A, B dhe III.2.B, me kosto faktike 26.7 milionë LEK;*
- ✓ *28 akte ligjore/nënligjore të miratuara, me kosto faktike 25.4 milionë LEK.*

Në programin **"Administrimi i Pyjeve"**, për 12M 2025 fondet në shpenzimet korente janë realizuar në masën 492.8 milionë LEK, ose në nivelin 96% kundrejt fondeve vjetore të ndryshuara dhe 92% përkundrejt planit fillestar. Produktet, të cilët kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit, i cili lidhet me "Zhvilllimin e qëndrueshëm të zonave pyjore të mbrojtura nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet dhe komunitetin", paraqiten si vijon:

- ✓ *4 milionë turistë kanë hyrë në zonat e mbrojtura në Parkun Kombëtar Dajt, Parkun Natyror Syri i Kaltër, Kune-Vain-Patok-Fushekuqe-Ishem;Parkun Kombetar Divjakë-Karavasta;*
- ✓ *26 333 monitorime për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura, me kosto faktike 339.2 milionë LEK;*
- ✓ *80 Objekte të administruara nga AKZM përgjatë 12M , ose 93% e sasisë së planifikuar, me kosto faktike prej 82.5 milionë LEK;*
- ✓ *Hartuar 12 plane menaxhimi për pyjet (100% e sasisë së planifkuar), me kosto faktike 23.3mln LEK;*
- ✓ *381 orë mësimore të zhvilluara për ndërgjegjësimin dhe informimin e nxënësve mbi zonat e mbrojtura.*

Në programin "**Menaxhimi i Mbetjeve Urbane**" , Misioni i Agjencisë Kombëtare të Mbetjeve është të sigurojë koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me NJQV, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e integruar të mbetjeve, me qëllin kalimin e këtij sektori në ekonomi qarkullese. Për 12M 2025, realizimi shpenzimeve korente është në vlerën 50.9 milionë LEK, 96% të planit të rishikuar ose 91% të planit fillestar.

- ✓ *Janë kryer 29 raporte monitorimi të menaxhimit të mbetjeve, ose 100% e sasisë së planifikuar, me kosto faktike 50.9 milionë LEK.*

Sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 67.8% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.71 miliardë LEK) (94.2% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025) dhe 25.6% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.15 miliardë LEK) (69.6% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke rritur shpenzimet me financim të brendshëm. Në fushën e mjedisit janë financuar projektet si më poshtë:

- ✓ *Hartim Projekti "Qendra Multifunksionale në Luginën e Vjosës" me vlere 791.7 milionë LEK;*
- ✓ *Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore-EKO-PARK ULZA me vlerë 462 milionë LEK;*
- ✓ *SANEX Kapitulli 27 – SIDA me vlerë 169 milionë LEK;*
- ✓ *Ndërtim vend-depozitimi për mbetjetet urbane me vlerë 61 milionë LEK.*

8.3.7 Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet kryesore në Ministrinë e Drejtësisë, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 37 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	723,936	793,790	1,600,506	1,241,800	1,538,494	1,229,123	213%	155%	96%	99%
Publikimet Zyrtare	67,044	5,000	52,016	3,900	49,744	3,900	74%	0.78	96%	100 %
Mjekësia Ligjore	108,150	30,000	105,950	173,000	105,160	169,273	97%	564%	99%	98%
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	18,440	200	18,540	200	14,876	86	81%	43%	80%	43%
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	2,412,446	3,000	2,366,046	3,000	2,353,383	-	98%	0%	99%	0%
Ndihma juridike	120,350	2,000	101,550	500	87,168	411	72%	21%	86%	82%
Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	297,936	5,000	293,326	3,900	279,573	3,816	94%	76%	95%	98%
Sistemi i Burgjeve	8,872,240	700,000	8,952,390	478,287	8,489,489	374,236	96%	58%	95%	78%
Financim i huaj	-	-	-	91,000		28,820	-	-	-	32%
Shërbimi i Provës	211,388	2,000	210,338	2,000	203,099	170	96%	9%	97%	9%
Totali sipas natyrës	**12,831,930**	**1,540,990**	**13,700,662**	**1,997,587**	**13,120,985**	**1,809,835**	**102%**	**117%**	**96%**	**91%**
Totali	**14,372,920**		**15,698,249**		**14,930,820**		**104%**		**95%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Drejtësisë u rishikua me një rritje gjatë vitit 2025 (9.2% më shumë se buxheti fillestar). Realizimi faktik ishte 14.9 miliardë LEK ose 104% e buxhetit fillestar dhe 95% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundrejt planit fillestar ishte 102% për shpenzimet korente dhe 117% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar realizimi ishte, rreth 96% për shpenzimet korente dhe 91% për investimet.

Në programin "**Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**" janë realizuar produkte me kosto faktike 4.3 miliardë LEK ndër të cilat përmendim:

- ✓ *3,527 subjekte janë likuiduar plotësisht për kompensimin e pronave të prekura nga ndërtimet informale, me kosto faktike rreth 1.4 miliardë LEK;*
- ✓ *626 subjekte janë likuiduar për 70% të vlerës së kompensimit të pronave që janë prekur nga ndërtimet informale, me kosto faktike rreth 677.6 milionë LEK;*
- ✓ *"Shpërndarja e fondit fizik dhe financiar" për 96 subjekte, me kosto faktike rreth 294.1 miliardë LEK;*
- ✓ *255 raste gjyqësore janë depozituar për "Mbrojtja e interesave të ATP në proceset gjyqësore", për çështje njohje të drejte pronësie apo që kanë të bëjnë me vlerësimin e pronës së njohur për kompensim;*
- ✓ *101 kërkesa të trajtuara për njohje pronësie, ndërsa 159 subjekte të tjera janë në fazë plotësimi dokumentacioni.*

Në programin "**Shërbimi i Provës**" janë realizuar produkte me kosto faktike 203 milionë LEK, ku raportohet të jenë realizuar:

- ✓ *8,760 burra të "Mbikëqyrur me dënim alternativ" në të gjitha Degët e Shërbimit të Provës në rrethe dhe nga Drejtoria e Përgjithshme, me kosto faktike 194.8 milionë LEK;*
- ✓ *698 "Gra të përfshira në programin e ri-integrimit", me kosto faktike 5.9 milionë LEK;*
- ✓ *Janë trajtuar 312 "Të mitur në mbikëqyrje në shërbimin e provës", me kosto faktike 2.5 milionë LEK.*

Në programin **"Sistemi i Burgjeve"** disa nga produktet e këtij programi matin performancën e sistemit të burgjeve, ndërsa të tjerë lidhen me përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar, me kosto faktike 8.4 miliardë LEK për arritjen e këtyre treguesve:

- ✓ *477 "Të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor", me kosto faktike 100.4 milionë LEK;*
- ✓ *4,370 burra të dënuar të trajtuar me kosto faktike 1.9 miliardë LEK dhe 102 të dënuara femra të trajtuara në kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit, me kosto faktike 6.7 milionë LEK;*
- ✓ *20 të mitur të dënuar të cilët vuajnë dënimin në ambientet të përshtatshme për vuajtjen e dënimi, me kosto faktike 4.5 milionë LEK.*

Në programin **"Mjekësia Ligjore"** me kosto faktike prej 105 milionë LEK, për vitin 2025 ka realizuar:

- ✓ *17,608 akte ekspertimi mjeko-ligjore, me kosto faktike 100.7 milionë LEK;*
- ✓ *62 akte ekspertimi të rasteve të dhunës seksuale me kosto faktike 4.3 milionë LEK.*

Sa i përket **investimeve publike,** realizimi i shpenzimeve në vitin 2025 ishte 115.6% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.8 miliardë LEK) dhe 93.4% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 si dhe 0% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj dhe 31.7% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit 2025 duke rritur shpenzimet me financim të brendshëm në kuadër të mirëmenaxhimit të fondeve publike, dhe në kuadër të AN nr.6/2025 janë planifikuar fonde për projekte me Financim të Huaj. Janë financuar projektet:

- ✓ *Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të IML-së me vlerë investimi prej 61.3 milionë LEK;*
- ✓ *Përmirësimi i kushteve fizike të jetesës nëpërmjet përmirësimit të përgjithshëm të infrastrukturës;*
- ✓ *Nërtimi IEVP Kukës (hartim, projektim, rikonstruksion, supervizim, kolaudim punimesh);*
- ✓ *Digjitalizimi i programeve të transparencës.*

8.3.8 Financat

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përmbushjes së misionit të Ministrisë së Financave, që është arritja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të fondeve publike, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2025, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Financave, paraqitet si më poshtë:

Tabela 38 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Financave

Programet buxhetore	Plani Fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 12 Mujori 2025		Realizimi ne % me planin fillestar		Realizimi ne % me planin e ndryshuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,020,930	138,000	902,614	35,000	818,784	27,649	80%	20%	91%	79%
Financimi I huaj	-	400,000	-	455,000	-	302,397	-	76%	-	66%
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	718,940	300,000	482,536	0	463,371	0	64%	0%	96%	0%
Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	604,000	100,000	456,663	1,117,869	309,608	1,092,256	51%	1092%	68%	98%
Financimi I huaj	-	-	-	317	-	-	-	-	-	-
Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,857,634	83,000	2,663,834	30,423	2,456,676	27,640	86%	33%	92%	91%
Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	4,310,773	323,220	3,885,837	79,971	3,776,124	58,692	88%	18%	97%	73%
Financimi I huaj	-	6,000	-	29,000	-	1,009	-	17%	-	3%
Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	195,590	2,000	178,940	14,500	170,324	4,076	87%	204%	95%	28%
Gjithsej sipas natyrës	**9,707,867**	**1,352,220**	**8,570,424**	**1,762,080**	**7,994,888**	**1,513,719**	**82%**	**112%**	**93%**	**86%**
Totali	**11,060,087**		**10,332,503**		**9,508,607**		**86%**		**92%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Financave u rishikua në ulje 7%, ose 727 milionë LEK më pak. Realizimi faktik ishte rreth 9.5 miliardë LEK ose 86% e buxhetit fillestar apo 92% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korente ishte 7.99 miliardë LEK, ose 82% e planit fillestar apo 93% e planit të rishikuar.

Në programin **"Planifikim menaxhim administrim",** objektivi i së cilit është mirëmenaxhimi i financave publike përmes hartimit të politikave në fushën e financave dhe ekonomisë, si dhe rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese në respektim edhe të parimit të barazisë gjinore, fondet buxhetore buxhetore në shpenzimet korente për 12M 2025 u realizuan në vlerën 818.7 milionë LEK, ose 91 % e planit të rishikuar dhe 80% e planit fillestar.

Programi realizoi këto produkte:

- ✓ *80 Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara, me kosto faktike 702.8 milionë LEK;*
- ✓ *35 Kontrata te monitoruara nga CFCU, nga 35 të planfikuara, me kosto fakike 71.7 milionë LEK;*
- ✓ *"Taksa pasurie të arkëtuara", realizuar me kosto prej 22.6 milionë LEK;*
- ✓ *822 orë/trajnimi të kryera nga QTATD, ose 78% e sasisë plan, me kosto 21.6 milionë LEK. Janë zhvilluar 78 tema trajnimi nëpërmjet të cilëve trajnuar 1299 punonjës në total.*

Në programin **"Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore",** objektivi i të cilit është progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, aplikimi i metodave dhe sistemeve të reja; modernizimi, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore si rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë; Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore; hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor; zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut; përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore; mbledhja efikase dhe efektive e borxhit. Gjatë 12M 2025, shpenzimet korente në këtë program janë realizuar në vlerën e 2.45 miliardë LEK ose në masën 86% të buxhetit fillestar dhe 92% të buxhetit të rishikuar. Janë realizuar produktet:

- ✓ *105 988 Tatimpagues të asistuar, ose 88% e sasisë plan, realizuar me kosto faktike 2.3 miliardë LEK;*
- ✓ *86 vendime gjyqësore të ekzekutuara për ish-punonjës të adminstratës tatimore ose 86% e sasisë plan, në vlerën 113.8 milionë LEK;*
- ✓ *1925 inspektime dhe hetime tatimore, realizuar me kosto faktike 3.9 milionë LEK.*

Në programin "**Menaxhimi i të Ardhurave Doganore",** qëllimi i politikës është menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore, garantimi i sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare nga kontrabanda, trafiqet e paligjshme, mallrat e ndaluara e të fallsifikuara, evazioni fiskal.
Shpenzimet korente për 12M 2025 në këtë program janë realizuar në vlerën 3.77 miliardë LEK ose 88% e buxhetit fillestar dhe 97% e buxhetit të rishikuar. Lidhur me objektivin kryesor krijimin e lehtësirave për operatorët ekonomikë nëpërmjet lehtësimit dhe përshpejtimit të procedurave doganore, janë realizuar:

- ✓ *758 955 deklarata doganore të procesuara, ose 93% e sasisë së planifikuar, kosto faktike 2.11mld LEK;*
- ✓ *24 vendime gjyqësore të ekzekutuara, me kosto faktike 31.2 milionë LEK.*

Lidhur me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtarë nga: kontrabanda, trafiqet paligjshme, mallrat e ndaluara e falsifikuara, evazioni fiskal, etj. janë kryer:

- ✓ *Shërbime skanimi, në vlerën 1.44 miliardë LEK, i cili është efektiv në pesë pika doganore;*
- ✓ *8 994 inspektime, me kosto faktike 175.3 milionë LEK;*
- ✓ *2568 hetime doganore, me kosto faktike 11 milionë LEK.*

Në programin **"Ekzekutimi i pagesave te ndryshme"**, fusha e veprimit të këtij programi konsiston në realizimin e pagesave të ndryshme sipas natyrës së tyre: për kuotat e anëtarësimeve në organizatat ndërkombëtare, për rritjen e kapitalit në institucionet financiare ndërkombëtare, transferta të ndryshme për funksionarët e lartë, në rastet e largimit nga detyra si dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe detyrimeve të tjera të MF-së, sipas vendimmarrjeve specifike të cilat zbatohen nga Aparati i MF. Për vitin 2025, realizimi në shpenzimet korente ishtë 309.6 milionë LEK, ose 68 % e planit të rishikuar dhe 51% e planit fillestar. Programi realizoi këto produkte:

- ✓ *"Shërbime konsulence", janë realizuar 29 transferta, me kosto faktike prej 188 milionë LEK. Ky produkt ka të planifikuar shpenzimet që përdoren për konsulencë që lidhen me shpenzimet vjetore për emetimin dhe ndjekjen e procesit të Eurobond, shpenzimet për vlerësimin e riskut të kreditit vjetor të Republikës së Shqipërisë si dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit DMFAS;*
- ✓ *85 "Vendime Gjyqesore të Ekzekutuara", me kosto faktike 116.7 milionë LEK (65 Vendime Gjyqësore për burgim të padrejtë; 20 Vendime Arbitrazhi dhe Vendime të GJEDNJ);*
- ✓ *Shpërblimi i 21 funksionarëvë pas ndërprerjes nga funksionit", me kosto faktike prej 81.6 milionë LEK. Ky produkt nuk paraqitet me realizim pasi këto fonde iu transferohen institucioneve përfituese, realizimi i të cilave bëhet nga buxhetet e tyre respektive;*
- ✓ *"Pagesa për Kuota Ndërkombëtare", planifikuar për pagesat e anëtarësimit të MF në organizatat ndërkombëtare si OECD, kryer 5 transferta me kosto faktike 4.95 milionë LEK.*

Sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 127.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.2 miliardë LEK) (94.7% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025) dhe 74.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.30 miliardë LEK) (62.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke rritur shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe duke pakësuar ato me financim të huaj. Janë mbyllur 10 projekte investimi në vlerën rreth 0.11 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Për programin DPD kanë përfunduar 4 kontrata me vlerë totale 59.4 milionë LEK,*
  - *Skaner për kontroll bagazhesh me vlerë 28.7 milionë LEK;*
  - *Blerje minibus për transport personeli me vlerë 16 milionë LEK;*
  - *Rikonstruksion i çatisë së godinave ku ushtrojnë veprimtarinë administrata doganore dhe Agjensitë Doganore në Kapshtice, me vlerë 10.2 milionë LEK;*
  - *Blerje motorgjenerator dhe pajisje zyrash me vlerë 4.5 milionë LEK.*
- ✓ *Për DPT ka përfunduar:*
  - *Sistemi i ri i menaxhimit te borxhit me vlerë 25 milionë LEK.*
- ✓ *Për programet "Planifikim, menaxhim dhe administrim" si dhe "Lufta kundër transaksioneve financiare jo-ligjore", kanë përfunduar projektet: blerje pajisje zyrash dhe kompjuterike, me vlerë 24.3milionë LEK.*

8.3.9 Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2025 për MM, paraqiten si më poshtë:

Tabela 39 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Mbrojtjes

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,403,300	120,000	1,596,264	77,669	1,579,727	77,654	113%	65%	99%	100%
Forcat e Luftimit	7,452,258	11,201,500	9,238,135	8,836,120	9,154,977	8,225,628	123%	73%	99%	93%
Financimi i huaj	-	10,200,000	-	11,102,400	-	-	-	-	-	-
Mbështetja e Luftimit	6,754,936	1,558,500	7,660,371	2,317,855	7,559,558	2,069,971	112%	133%	99%	89%
Mbështetja për Shëndetësinë	1,406,000	500,000	1,722,440	197,000	1,709,712	193,285	122%	39%	99%	98%
Arsimi Ushtarak	870,000	557,000	989,771	462,031	945,966	396,905	109%	71%	96%	86%
Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	0	5,228,958	0	5,228,958	0	101%	-	100%	-
Emergjencat Civile	1,450,000	2,000,000	1,172,679	1,814,180	1,073,091	1,327,226	74%	66%	92%	73%
Financimi i huaj	-	2,012,050	0	1,012,050	0	51,337	-	3%	-	5%
Gjithsej sipas natyrës	**24,536,494**	**28,149,050**	**27,608,618**	**25,819,305**	**27,251,989**	**12,342,006**	**111%**	**44%**	**99%**	**48%**
Gjithsej	**52,685,544**		**53,427,923**		**39,593,995**		**75%**		**74%**	

Ministria e Mbrojtjes ka synuar që nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura, të arrijë realizimin e treguesve kryesor të përformancës, ku renditen:

- ✓ *Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut.*
- ✓ *Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.*
- ✓ *Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.*

Projektet prioritare në aspektin e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë kombëtare, janë:

- ✓ *Sistemet e Integruara të vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare.*
- ✓ *Kompletimi i Forcave të Armatosura me pajisje individuale të luftimit, në funksion të certifikimit të Batalionit të dytë të këmbësorisë si një komponent i gatshëm i NATO Response Force.*
- ✓ *Shpenzimet operacionale u përdoren me efikasitet për kryerjen e misionit të Forcave të Armatosura si në rang kombëtar ashtu dhe në kuadër të misioneve paqeruajtëse, duke rritur prezencën e Forcave të Armatosura në Detin Egje, Afganistan, KFOR, etj.*

Programi **"Forca e Luftimit",** i cili synon mbajtjen në gadishmëri të kapaciteteve operacionale të forcës tokësore, detare e ajrore, ka shpenzuar 9.1 miliardë LEK (shpenzime korente) në vitin 2025, ose 99% të planit të rishikuar. Konkretisht për vitin 2025:

- ✓ *2,657 personel i forcave toksore i mbajtur në gadishmëri, me kosto faktike 4.2 miliardë LEK.*
- ✓ *699 personel i forcave ajrore, i mbajtur në gadishmëri, me kosto faktike 1.8 miliardë LEK.*
- ✓ *707 personel i forcave detare, i mbajtur në gadishmëri, me kosto faktike 1.59 miliardë LEK.*
- ✓ *383 kontigjent ushtarak pjesmarrës në misione paqeruajtëse jashtë vendit, me kosto faktike 1.48 miliardë LEK.*

Programi **"Mbështetja e Luftimit"** siguron logjistikën dhe inteligjencën strategjike për operacione të ndryshme si dhe kapacitete operacionale për reparte të veçanta. Realizimi ishte 7.5 miliardë LEK (shpenzime korente), ose 112% e planit fillestar dhe 99% e atij të rishikuar.

- ✓ *Mbështetja logjistike e Forcave të Armatosura të RSH është realizuar përmes 1,242 kapaciteteve operacionale (personel), me kosto faktike 3.9 miliardë LEK.*
- ✓ *410 personel i policise ushtarake, me kosto faktike 736 milionë LEK.*
- ✓ *Sigurimi me sisteme komunikimi dhe informacioni në mbështetje të kërkesave të Forcave të Armatosura, me kosto faktike 405 milionë LEK.*
- ✓ *160 personel i rekrutuar dhe dosje të administruara për trajtim financiar, me kosto faktike 383 milionë LEK.*
- ✓ *Monitorimi i hapsirës detare, me kosto faktike 39.9 milionë LEK.*
- ✓ *130 m/linear dokumenta të proçesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit ne fuqi, me kosto faktike 36 milionë LEK.*
- ✓ *93 liçenca importi/eksporti të dhëna për mallrat ushtarak, me kosto faktike 32 milionë LEK.*

Për programin **"Mbështetje për Shëndetësinë"**, janë planifikuar 1 (një) produkt dhe 2 (dy) projekte, me një buxhet fillestar në vlerën 1.4 miliardë LEK për shpenzime korente dhe 500 milionë LEK për shpenzime kapitale. Gjatë vitit 2025, buxheti i programit është rishikuar në 1.72 miliardë LEK për shpenzime korente dhe 197 milionë LEK për shpenzime kapitale. Këto produkte u realizuan në vlerën 1.9 miliardë LEK në total, ose 99% e planit të rishikuar, duke siguruar kështu dhe paraqiten si më poshtë:

- ✓ *73,246 pacientë të trajtuar ambulator dhe të shtruar në urgjencë, me kosto faktike 1.7 miliardë LEK.*
- ✓ *Rikonstruksion godinash me kosto faktike 137 milionë LEK.*
- ✓ *35 pajisje mjeksore të blera me kosto faktike 56 milionë LEK.*

Programi **"Emergjenca Civile"** lidhet me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile dhe Rezervës Materiale të Shtetit. Gjatë vitit 2025 shpenzimet korente u realizuan në masën 1,07 miliardë LEK ose 92% e planit të rishikuar, ndër to përmendim:

- ✓ *Shërbime të kryera (orë pune) në kuadër të mbrojtjes së jetës njerzore, pronës, trashëgimisë kulturore e pyjeve, me kosto faktike 362 milionë LEK.*
- ✓ *161 milionë LEK të shpenzuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese për parandalimin e fatkeqësive natyrore.*
- ✓ *121 familje të ndihmuara per banesat e dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme, kosto faktike 428milionë LEK.*
- ✓ *Administrimi dhe menaxhimi i stokut të mallrave ushqimore dhe mallrave industriale në kushte optimale, me kosto faktike 120 milionë LEK.*

Sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 77.1% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (12.3 miliardë LEK) (89.7% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2025, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm. Janë mbyllur 14 projekte investimi me vlerë totale 2.7 miliardë LEK si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Ndërtim objekti shumefunksional për akomodimin e komandes, shtabit dhe kompanise së mbështetjes, rruge e sheshe në pronen nr.86 C Ferraj Tiranë, me vlerë 577.8 milionë LEK;*
- ✓ *Sistemim i infrastuktures + Postoblloku nr.4 + Tranazhim i fushes se futbollit ne Garnizonin Skenderbej me vlerë 207.8 milionë LEK;*
- ✓ *Ndertim i rrjetit inxhinierik i poligonit kombetar Pajet me vlerë 108.4 milionë LEK;*
- ✓ *Blerje Pajisjesh për Zonimin TEMPEST te ambienteve , godinave dhe mburojave me vlerë 70.2mln LEK.*

Në drejtim të mbrojtjes nga "*Fatkeqësitë Natyrore të menaxhuara*", janë financuar një numër i konsiderueshëm projektesh në vlerë rreth 1.7 miliardë LEK në 58 bashki.

- ✓ *Në programin "Forca e Luftimit", janë financuar një sërë projektesh të rëndësishme ku veçojmë projektin "Armatim i Lehtë Municion dhe Paisje e Makineri për Forcat e Armatosura" me vlerë 4.2 miliardë LEK.*

8.3.10 Ekonomia dhe Inovacioni

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2025 për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 40 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	0	80,000	58,200	98,760	48,418	93,229	-	-	83%	94%
Mbështetje për Inovacion e Teknologji	299,388	50,000	246,776	867,200	244,345	867,200	82%	1734%	99%	100%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	803,890	62,000	770,484	59,714	740,834	49,214	92%	79%	96%	82%
Financimi i huaj	0	164,690	0	64,690	0	19,913	-	12%	-	31%
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut……..	377,922	12,000	399,201	8,160	394,298	8,046	104%	67%	99%	99%
Sigurimi Shoqëror	40,800,090	-	46,284,132	-	46,280,277	-	113%	-	100%	-
Tregu i Punës	2,775,547	151,000	2,537,593	41,200	2,445,762	35,625	88%	24%	96%	86%
Financimi i huaj	-	100,000	-	30,000	-	2,375	-	2%	-	8%
Inspektimi në punë	260,984	22,000	260,371	22,000	257,538	21,522	99%	98%	99%	98%
Arsimi i Mesëm Profesional	3,132,000	808,469	3,058,863	213,649	2,981,543	211,909	95%	26%	97%	99%
Financimi i huaj		570,000		570,000		334,770	-	59%	-	59%
Strehimi	745,000	550,000	535,018	570,095	511,424	554,741	69%	101%	96%	97%
Gjithsej sipas natyrës	**49,194,821**	**2,570,159**	**54,150,638**	**2,545,468**	**53,904,436**	**2,198,543**	**110%**	**86%**	**100%**	**86%**
Gjithsej	**51,764,980**		**56,696,106**		**56,102,979**		**108%**		**99%**	

Buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit gjatë vitit 2025 u rishikua në rritje (prej 9.5%), ose 4.9 miliardë LEK në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm. Realizimi faktik ishte 56 miliardë LEK, ose 108% e buxhetit fillestar dhe 99% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundrejt planit fillestar ishte 110% për shpenzimet korente dhe 86% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar, realizimi ishte 100% për shpenzimet korente dhe 86% për investimet. Ndryshimet kanë ardhur si pasojë e ndarjes së fushave të përgjegjësisë së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit në zbatim të VKM nr.512, datë 25.9.2025 *"Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit"*, dhe VKM nr.516, datë 25.9.2025 *"Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit"*, si dhe Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar"*.

Në programin "**Tregu i Punës**, i cili synon nxitjen e mundësive për punë të denjë dhe rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, fondet për shpenzime korente sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.5 miliardë LEK, nga 2.7 miliardë LEK të parashikuara në planin fillestar. Gjatë vitit 2025, shpenzimet në këtë program janë realizuar në masën 96% të buxhetit të rishikuar dhe 88% të planit fillestar. Në veçanti, disa nga rezultatet kryesore të arritura nëpërmjet këtij programi ishin:

- ✓ *Janë trajtuar 2,597 punëkërkues të papunë me pagesë papunësie, realizuar në vlerën 692 milionë LEK;*
- ✓ *Janë punësuar nëpërmjet programeve te nxitjes se punësimit 2,816 punëkërkues, në vlerën 567 milionë LEK;*
- ✓ *Janë realizuar 22,539 ndërmjetësime për punëkërkues të papunë të punësuar, në vlerën 480 milionë LEK;*
- ✓ *Janë trajnuar 11,872 persona në qëndrat e formimit profesional publik, në vlerën 412 milionë LEK;*
- ✓ *Kanë përfituar 1,692 të rinj nga nisma "Garancia Rinore", në vlerën 98 milionë LEK;*
- ✓ *456 persona ndjekin nje kurs formimi për kodimin (Java, Cyber security, python etj), në vlerën 52 milionë LEK.*

Në programin "**Strehimi**", i cili mbështet zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për kategoritë në nevojë; fondet e parashikuara u ulën në 1.1 miliardë LEK, nga 1.29 miliardë LEK në buxhetin fillestar. Gjatë vitit 2025 u shpenzuan 1 miliardë LEK, ose 96% e buxhetit të rishikuar, ose 82% e buxhetit fillestar. Në përputhje me objektivat e programit të strehimit janë realizuar:

- ✓ *2,297 familje kanë përfituar subvencionim të qirasë në tregun e lirë sipas Ligjit nr.22/2018, me vlerë 247mln LEK;*
- ✓ *5,313 familje kanë përfituar "Subvencion të interesave për kreditë ekzistuese" me vlerë 153 milionë LEK;*
- ✓ *490 familje kanë përfituar subvencionim të interesave për kredi të reja me vlerën 86 milionë LEK;*
- ✓ *218 familje janë trajtuar me "Subvencionim qiraje për banorë të shpronësuar nga Unaza Madhe, Tiranë", me kosto faktike 20 milionë LEK;*
- ✓ *17 përfitues të përgjedhur për "Grant të Menjëhershëm, me kosto faktike 3.5 milionë LEK.*

Në programin "**Sigurimi Shoqëror**", synimi i së cilit është mbulimi me elementë të sigurimeve shoqërore, i gjithë popullsisë së vendit e i rezidentëve ekonomikisht aktiv dhe akordimi për këta persona i përfitimeve pensionale, përfitime në rast sëmundje, në rast të aksidentit në punë, në rast barrëlindje, përfitime suplementare apo nga programe të veçanta të Qeverise, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për ato; fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën 46.2 miliardë LEK nga 40.8 milirad LEK të parashikuar në planin fillestar. Për 12 mujorin 2025 janë realizuar 100% e fondeve të buxhetit të ndryshuar apo 113% të buxhetit fillestar. Nëpërmjet këtij programi është realizuar:

- ✓ *Transfertë buxhetore për të mbuluar diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së pensioneve publike, me kosto faktike 32.9 miliardë LEK;*
- ✓ *Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime të çmimeve, me kosto faktike 4.7 milard LEK;*
- ✓ *Transferte buxhetore per kompesime për të ardhurat e pensionistëve, me kosto faktike 3.2 miliardë LEK;*
- ✓ *14,919 Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për "Trajtim i vecantë i punonjësve të nëntokës", me kosto faktike rreth 508 milionë LEK;*
- ✓ *9,982 Përfitime dhe pagesa të llogaritura dhe shpërndara për sigurimin suplementar për persona nën statusin "Naftëtar", me kosto faktike 448 milionë LEK;*
- ✓ *3,357 përfitime llogaritur/shpërndar për sigurimin suplementar të ish policeve, kosto faktike 311mln LEK;*
- ✓ *1,079 Përfitues dhe pagesa të llogaritura e të shpërndara për sigurimin suplementar të personave me statusin "Profesor", me kosto faktike 136.4 milionë LEK;*
- ✓ *1,930 Përfitues dhe pagesa të llogaritura e shpërndara për sigurimin suplementar për persona me statusin "Metalurg", me kosto faktike 55 milionë LEK;*
- ✓ *317 Përfitime llogaritur/shpërndarë për kompensimin e statusit "Dëshmor i Atdheut", kosto faktike 27.2mln LEK;*

Fondet e parashikuara për programin e **"Arsimit të mesëm profesional"**, sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 3 miliardë LEK për shpenzime korente, nga 3.13 miliardë LEK të parashikuara në planin fillestar. Për 12M 2025 janë realizuar fondet në masën 95 % të buxhetit të akorduar në fillim të vitit dhe 97% të planit të ndryshuar. Për sigurimin e aksesit të nxënësve në Arsimin Profesional për 2025, janë mundësuar kushtet për:

- ✓ *15,459 nxënës kanë ndjekur shkollat publike te ars.profesional, ku 2616 vajza, kosto faktike 2.6mld LEK.*
- ✓ *Janë hartuar dhe miratuar 57 standarte profesionesh dhe kualifikimesh me kosto faktike 21.4mln LEK.*
- ✓ *4,741 nxënës kanë përfituar bursa në AP me kosto faktike 274 milionë LEK. Nxënësit i përkasin grupeve në nevojë, vajzat që zgjedhin AP, nxënësit me nevoja të veçanta, nxënësit rome dhe egjytianë.*
- ✓ *Janë hartuar 40 skelet-kurrikula dhe programe të kurseve të unifikuara dhe 20 materiale mësimore, me kosto faktike 25.5 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbështetur 43 ofrues të AFP nga AKAPF për sigurimin e cilësisë dhe për procesin e vetëvlerësimit dhe ka hartuar raportin kombëtar të vetëvlerësimit, me kosto faktike 1.2 milionë LEK.*
- ✓ *Janë kryer 9 inspektime të ofruesve AFP për garantimin e standateve të cilësisë, kosto faktike 6mln LEK.*
- ✓ *Janë trajnuar dhe atestuar 114 mësimdhënës, me kosto faktike 8.8 milionë LEK.*

Sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 74.3% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.8 miliardë LEK) (97.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025) dhe 42.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.35 miliardë LEK) dhe 53% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 . Janë mbyllur 17 projekte të investimit me vlerë 0.11 miliardë LEK, ku nga të cilat veçojmë:

- ✓ *Në programin Strehimi, i cili konsiston në sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për individë e familje që nuk përballojnë dot kostot e strehimit në treg, gjatë vitit 2025 përfunduan 17 projekte investimi me vlerë 0.11 miliardë LEK (projekte në vazhdim nga 2024). Në përputhje me objektivat e programit të strehimit u mundësua përmirësim i kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian në bashkitë Delvinë, Librazhd, Vau i Dejës, Selenicë, Dimal, Roskovec, Vlorë, Memaliaj, Gramsh, Mat, Dropul, Fier, Kolonjë, Sarandë, Rrogozhinë, Pogradec, Shkodër.*

8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 41 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë e Brendshme

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,582,495	92,849	2,181,870	70,778	2,145,196	38,444	136%	41%	98%	54%
Prefekturat dhe funksionet e deleguara	671,327	32,000	674,887	12,093	629,551	11,411	94%	36%	93%	94%
Shërbimi i Gjendjes Civile	628,742	202,000	766,277	202,000	740,701	202,000	118%	100%	97%	100%
Policia e Shtetit	22,863,012	694,127	23,776,493	1,105,517	23,746,508	1,099,413	104%	158%	100%	99%
Financim i Huaj		1,700,000		98,547		100,837		6%		102%
Garda e Republikës	2,480,000	60,000	2,561,500	160,200	2,555,196	160,059	103%	267%	100%	100%
Gjithsej sipas natyrës	**28,225,576**	**2,780,976**	**29,961,026**	**1,649,135**	**29,817,153**	**1,612,163**	**106%**	**58%**	**100%**	**98%**
Gjithsej	**31,006,552**		**31,610,161**		**31,429,315**		**101%**		**99%**	

Buxheti i Ministrisë së Brendshme u rishikua në rritje gjatë vitit 2025 me rreth 2% duke arritur në 31.6 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 31.4 miliardë LEK, ose 99% e planit të rrishikuar.

Në programin **"Policia e Shtetit"**, u realizuan 100% e shpenzimeve për të realizuar qëllimin e programit që është lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme edhe terroriste duke shënjestruar dhe goditur veprimtarinë e krimit të organizuar e rrjetet kriminale, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm; Përforcimi i zbatimit të ligjit për rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe asaj rrugore; Menaxhimi efektiv, eficent dhe i integruar i kufijve nëpërmjet mirëfunksionimit të 27 pikave të kalimit kufitar në RSH; Forcimi i kapaciteteve institucionale, garantimi i pavarësisë operacionale të policisë së shtetit dhe Konsolidimi i arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuartë strukturave të Policisë së Shtetit.

Kështu përgjatë vitit 2025, janë realizuar produktet e renditura sa më poshtë:

- ✓ *38,195 operacione policore të hetuara apo shërbime, me kosto faktike 12.2 miliardë LEK;*
- ✓ *685 shërbime të Forcave Speciale/NSH për sigurimin e rendit publik, me kosto totale 1.3 miliardë LEK;*
- ✓ *279 operacione të posaçme konvencionale për rritjen e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, me kosto faktike 484mln LEK;*
- ✓ *67 objekte dhe personalitete të siguruara, me kosto totale 425 milionë LEK;*
- ✓ *7,796 shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale me kosto totale 411 milionë LEK që kontribuojnë tek rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet;*
- ✓ *206 persona me cilësin e veçantë të mbrojtur, me kosto faktike 323.5 milionë LEK;*
- ✓ *65 operacione të sigurisë në kufirin blu për forcimin e masave në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve, kosto 175.5 milionë LEK;*
- ✓ *58 operacione policore ndaj ekstremisteve e grupeve terroriste, me kosto faktike 171.5 milionë LEK.*

Programi **"Garda e Republikës"** ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj, si dhe të objekteve të rëndësisë së veçantë, përmes rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përafrimit me standardet europiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e një niveli sigurie 100%. Për vitin 2025, programi ka realizuar fondet në masën rreth 100% të planit vjetor të rishikuar, duke garantuar mbrojtjen e 149 personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto faktike prej 2.6 miliardë LEK.

Programi **"Shërbimi i Gjendjes Civile"** synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi të dixhitalizuar të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe të Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA), si dhe regjistrimin dhe përditësimin në kohë reale dhe me saktësi të të dhënave të shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Për vitin 2025, programi ka realizuar rreth 97% të fondeve krahasuar me planin vjetor të rishikuar, duke mundësuar regjistrimin e 1,055,000 akteve dhe dokumenteve të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto faktike 721mln LEK.

Programi **"Prefektura dhe Funksionet e Deleguara"** synon ndjekjen e zbatimit të programit të qeverisë në nivel vendor, në rolin e përfaqësuesit të saj. Për vitin 2025, programi ka realizuar fondet në masën 93% të planit vjetor të rishikuar, duke arritur:

- ✓ *Verifikimin e 14,460 akteve normative, me një kosto faktike prej 448 milionë LEK;*
- ✓ *Trajtimin e 655 kërkesave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, me kosto faktike prej 108.5mln LEK;*
- ✓ *Kryerjen e 1,785 monitorimeve në nivel qarku, me një kosto faktike prej 73.3 milionë LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2025 ishte 142.1% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.5 miliardë LEK) (97.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025) dhe 6.1% e buxhetit fillestar dhe 99.7% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025 për projektet me financim të huaj (0.10 miliardë LEK). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2025, duke rritur shpenzimet me financim të brendshëm dhe duke pakësuar ato me financim të huaj. Janë mbyllur 4 projekte investimi me vlerë rreth 0.60 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Ndërtim/rikonstruksion të objekteve të Drejtorisë Vendore Policisë Berat me vlerë rreth 256.4 milionë LEK*;
- ✓ *Përmirësimi i sistemit TIMS dhe modulit të kontrollit kufitar me vlerë rreth 151.2 milionë LEK*;
- ✓ *Përmirësimi i moduleve Menaxhim i Çështjes, salla Operative me vlerë rreth 140 milionë LEK*;
- ✓ *Ndërtim i godinës së Postës së Policisë Roskovec me vlerë rreth 53.4 milionë LEK*.

Në programin "Policia e Shtetit" janë financuar projekte të cilat konsistojnë në ndërtim, rikonstruksion godinash si dhe armatime.

8.3.12 Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për tre programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 42 Realizimi i buxhetit 2025 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	338,490	260,000	290,890	5,100	278,882	1,542	82%	1%	96%	30%
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,907,230	50,000	2,612,230	601,000	2,349,131	597,452	81%	1195%	90%	99%
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	318,580	-	301,580	-	299,648	-	94%	-	99%	-
Totali sipas natyrës	**3,564,300**	**310,000**	**3,204,700**	**606,100**	**2,927,661**	**598,995**	**82%**	**99%**	**91%**	**99%**
Totali	**3,874,300**		**3,810,800**		**3,526,656**		**91%**		**93%**	

Buxheti vjetor i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme u rishikua me një ulje të lehte prej 1.6% gjatë vitit 2025. Realizimi faktik ishte 3.5 miliardë LEK ose 91% e buxhetit fillestar dhe 93% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korente krahasuar me planin fillesara ishte 82% dhe i shpenzimeve për investime 99%. Ndërsa realizimi i shpenzimeve korente rezultoi 91% dhe 99% e shpenzimeve kapitale krahasuar me planin e rishikuar.

Programi **"Mbështetje diplomatike jashtë shtetit"**, zë vendin kryesor në realizimin e shpenzimeve për MEPJ me një vlerë prej 2.3 miliardë LEK.

Në përmbushje të objektivave të këtij programi gjatë vitit 2025, janë realizuar aktivitetet si mëposhtë:

- ✓ *350 punonjës të trajtuar me "Mbështetje e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese", me kosto faktike 1.8 miliardë LEK;*
- ✓ *53 "Kuota ndërkombëtare" të paguara ku vendi ynë është palë, si detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA; UNIDO; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO; OSBE, etj, me kosto faktike 229 milionë LEK;*
- ✓ *290 "Familjar të diplomatëve të trajtuar sipas ligjit", me kosto faktike 71 milionë LEK.*

Programi **"Aktiviteti diplomatik dhe konsullor"**, ka për qëllim zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës. Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 299.6 milionë LEK, ku përmendim:

- ✓ *24 akte ligjore dhe nënligjore të hartuara në kuadër të intensifikimit të punës, përpjekjeve dhe koordinimit ndërinstitucional në procesin e përmbushjes së detyrimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE me kosto faktike 204 milionë LEK;*
- ✓ *260 takime të zhvilluara dypalëshe dhe shumëpalëshe, në kuadër të zhvillimit dhe forcimit të marrëdhënieve me partnerë strategjik, vendet e rajonit, me kosto faktike 59.6 milionë LEK;*
- ✓ *157 aktivitete promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike publike dhe diasporës, me kosto faktike 12 milionë LEK.*

Për sa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2025 ishte 193.2% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.60 miliardë LEK) (98.8% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.11/2025. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2025, duke rritur ndjeshëm shpenzimet me financim të brendshëm. Janë paguar disa projekte për blerje paisjesh për përfaqësitë diplomatike, dhe pagesa në kuadër të projekteve të asistencës teknike. Janë mbyllur 2 projekte investimi me vlerë 0.57 miliardë LEK:

- ✓ *Blerje Seli Diplomatike me vlerë 520 milionë LEK;*
- ✓ *Automjete të blera për misionet diplomatike me vlerë 50 milionë LEK*.

8.3.13 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2025 për Institucionet e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë, paraqiten si më poshtë:

Tabela 43 Realizimi i buxhetit 2025 për Institucionet e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2025		Plani i rishikuar 2025		Fakti 2025		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korente	Investime	Korente	Investime	Korente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Inspektoriati i Larte i Drejtesise	302,900	51,700	228,200	35,919	224,400	23,417	74%	45%	98%	65%
Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	286,000	2,000	289,950	2,000	277,353	890	97%	45%	96%	45%
Gjithsej sipas natyrës	**588,900**	**53,700**	**518,150**	**37,919**	**501,753**	**24,308**	**85%**	**45%**	**97%**	**64%**
Totali	**642,600**		**556,069**		**526,061**		**82%**		**95%**	

- ✓ *Janë shqyrtuar 97 çështje nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për vitin 2025 apo 45 % me shume së një vit më parë, shoqëruar me kosto faktike 277.3 milionë LEK;*
- ✓ *Janë trajtuar në total 1635 ankesa nga zyra e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë apo 315 ankesa më shumë në krahasim me vitin 2024 si dhe kanë përfunduar 7 inspektime tematike, me kosto faktike 224.4mln LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike**, me fondet e realizuara për investime (në total për 2 institucione) prej 0.24 miliardë LEK në vitin 2025, është realizuar ndërtim ambientesh dhe blerje pajisje kompjuterike.

*Informacion më i detajuar analitik sa i takon realizimit të shpenzimeve buxhetore në nivel programi/produkti për ministritë e linjës, gjendet në **Anekset 2.0 shoqëruese** të këtij Raporti.*